



**BINARD BILOTA**

**SHPATA  
SKANDERBEKUT  
NDË DIBRËT POSHTË**

UNIVERSITETI SHTETËROR I TIRANËS  
INSTITUTI I HISTORISË DHE I GJUHESISE

BINARD BILOTA

BOTONIT KËM KASTRI  
SHPATA SKANDERBEKUT  
TITOLI KOMUNITAR  
SHPATA SKANDERBEKUT

# SHPATA SKANDERBEKUT NDË DIBRËT POSHTË

Redaktuar, pajisur me shënimë dhe me hyrje nga

P. EMANUIL JORDANI

CITTÀ di CHIERI  
CONSIGLIERE COMUNALE  
*Vincenzo Cucchi*

00-000-00000 00000-00000 00000-00000

SHPATA SKANDERBEKUT  
TIRANE, 1967

SHPYTA SKAÑDERRERKUT  
NDE DIBËT PÖRTE

NEVOLI GRAVE

SHPYTA SKAÑDERRERKUT  
NDE DIBËT PÖRTE

SHPYTA SKAÑDERRERKUT  
NDE DIBËT PÖRTE

P. BINARD BILOTA

Njësirës Cnezi  
CONSEIL COMMUNALE  
COUNCIL OF CHIEFS

Tirazhi: 4000 kopje

Formati: 60 x 88/16

Stash: 2204-65

Shtypur në NISH të Shtypshkronjavet «MIHAL DURI» — Tiranë



P. BINARD BILOTA

## PARATHENIE

Qëndresa e lavdishme e popullit shqiptar kundër pushtuesit turk në shekullin XV dhe figura e heroit tonë legjendar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut kanë qenë vazhdimisht burim fryshtimi, si për luftërat e pandërprera për liri të shqiptarëve gjatë këtyre pesë shekujve të fundit, ashtu dhe për krijuimtarinë gojore të popullit tonë e për letërsinë artistike.

Tema e luftës heroike të shqiptarëve të prirë prej Skënderbeut, që gjeti jehonë edhe në letërsinë e përbotshme, është vënë në bazë të një radhe veprash nga më të mirat të letërsisë sonë. Një vend qendror kjo temë zuri në letërsinë arbëreshe të shek. XIX, në të cilën u krijuau një traditë e tërë e evokimit të «Motit të Madh» përmes veprave të Jeronim De Radës, Gavril Darës (të Riut) e të një sërisht poetëve të tjierë arbëreshë.

Sot lexuesve u vihet në dorë një vepër tjetër, poema epike «Shpata e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» (Shpata e Skënderbeut në Dibrën e Poshtme) e Binard Bilotës. Vepra, e përgatitur për shtyp prej Emanuil Jordanit, batohet për herë të parë me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut.

Binard Bilita është një figurë e shënuar dhe aktive në fushën e përpjekjeve për zgjimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare tek arbëreshët, në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare. I brumosur me një krenari të lirëshme për gjakun shqiptar që i rrithet në dej, me dashuri për gjuhën shqipe, që ai e quan «hyjnore», e me nderim ndaj çdo tradite jisnike të trashëguar prej popullit të tij të lashtë, Bilita u dallua si mbledhës i folklorit e si studjues i traditës arbëreshe, si lëvrues i gjuhës dhe i letërsisë arbëreshe.

Patriot e demokrat, ai gjithë jetën ka punuar për ato ideale të larta që fryshtuan tërë atë plejadë të ndritur arbëreshësh, në krye të së cilës qëndron Jeronim De Rada.

Binard Bilita ka zhvilluar një Shqipëri të lirë, që të shkëlqente me lavdinë e shekullit XV. Tek rikrijimi i lavdisë së atij shekulli me anë të veprave artistike, Bilita, si rilindësit tanë dhe gjithë arbëreshët, shihte mjetin më të mirë për të ngritur lart

krenerinë kombëtare të bashkatdhatarëve, për të ndezur tek ta flakën e atdhedashurisë dhe tëurrejtjes ndaj pushtuesit turk, për t'i nxitur që të përtérin nën heroizmin e Skënderbeut. Është për këtë arësy që ai përmes veprës së gjatë «Shpata Skandërbekut ndë Dibrët Poshtë», fryt i një pune të madhe të fryshtuar nga ndjenja atdhetare, i këndon me aqë dashuri e zjarr epokës dhe figurës heroike të Skënderbeut.

Poema e Bilotës, arti poetik i të cililit meritoi admirimin e De Radës, mbeti e pabotuar, si me gjallje të poetit, ashtu edhe shumë vjet pas vdekjes së tij, se duhej të vinin këto ditë të ndritura që të botohej në atdheun e rilindur, në Shqipërinë socialiste.

Vepra është përgatitur për botim nga studjuesi i zellshëm arbëresh Emanuil Jordani, i cili njihet ndër ne në mënyrë të veçantë si hartues i «Fjalorit të arbëreshvet t'Italianë» (Bari 1963). Me punën që ka bërë përgatitjen për botim të poemës së Binard Bilotës, të cilën e ka ruajtur vjete me radhë, duke dhënë një shembull të larië të kujdesit ndaj vlerave letrare të lëna dorëshkrim prej autorësh arbëreshë që s'kanë mundur t'i batojnë, ai sjell një kontribut të ri në lëmin e studimeve arbëreshe dhe i bën një shërbim të madh çështjes së pasurimit të letërsisë sonë. Emanuil Jordani ka bërë redaktimin e veprës, e ka pajisur me hyrje e me shenimet përkatëse. Po prej tij është hartuar dhe fjalorhi përkatesë.

Poemës, që bотohet sipas versionit të saj të fundit në të folmen arbëreshe, i janë bërë disa shkurttime prej Emanuil Jordanit e, në ndonjë rast, prej Sektorit të historisë së letërsisë shqipe, për t'i dhënë asaj karakter më organik si në idetë ashtu dhe në shijellimin e saj poetik.

Botimi i veprës në Tiranë është bërë nën kujdesin e Sektorit të historisë së letërsisë shqipe të Institutit të historisë e të gjuhësisë.

«Shpata Skandërbekut ndë Dibrët Poshtë» do t'i shërbujejë popularizimit të mëtejshëm të figurës së heroit tonë legjendar dhe pasurimit të letërsisë sonë me një vepër që paraqet interes letrar e gjuhësor e që zgjeron rrëthin e temës së Skënderbeut në letërsinë arbëreshe.

#### INSTITUTI I HISTORISË DHE I GJUHËSISË

Do të kthejmë tashmë së hënë. Në vitin 1843 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1866 u bë përfundim i shkollave latine. Në vitin 1873 u bë përfundim i shkollave turke. Në vitin 1880 u bë përfundim i shkollave greke. Në vitin 1884 u bë përfundim i shkollave frëngjisht. Në vitin 1886 u bë përfundim i shkollave italiane. Në vitin 1888 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1890 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1892 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1894 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1896 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1898 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1900 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1902 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1904 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1906 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1908 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1910 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1912 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1914 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1916 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1918 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1920 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1922 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1924 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1926 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1928 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1930 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1932 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1934 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1936 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1938 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1940 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1942 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1944 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1946 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1948 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1950 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1952 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1954 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1956 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1958 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1960 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1962 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1964 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1966 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1968 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1970 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1972 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1974 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1976 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1978 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1980 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1982 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1984 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1986 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1988 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1990 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1992 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1994 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1996 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 1998 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2000 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2002 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2004 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2006 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2008 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2010 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2012 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2014 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2016 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2018 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2020 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2022 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2024 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2026 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2028 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2030 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2032 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2034 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2036 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2038 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2040 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2042 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2044 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2046 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2048 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2050 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2052 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2054 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2056 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2058 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2060 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2062 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2064 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2066 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2068 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2070 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2072 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2074 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2076 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2078 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2080 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2082 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2084 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2086 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2088 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2090 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2092 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2094 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2096 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 2098 u bë përfundim i shkollave shqipe. Në vitin 20100 u bë përfundim i shkollave shqipe.

#### BINARD BILOTA DHE POEMA E TËJ

#### «SHPATA SKANDERBEKUT NDË DIBRËT POSHTË»

Njëri ndër njerzit më të famshëm arbëreshë te fusha e diturisë dhe e atdhetarisë është, pa dyshim, papà Binard Bilotë. Ai u lind në Frasnité mbë 29 të nëndorit të vitit 1843, nga Emanuil Bilotë e nga Ngjiska Martire, prindë shumë të nderruar. Studjoi në Shën Mítë Koronë, te Kulexhi i Shën Adrianit, që ka qënë për shumë vjet vendi ku u kanë plazmuar mendjet më të ndriçime t'Arbëreshvet t'Kalabrisë. N'atë kulexh Bilotë studjoi pa paguar, qysh prej të dyjtit vit i hyrjes së tij n'atë vend, pse ishte studjues shumë i mençëm. I dorëzuar prift i ritit bizantin, te vitit 1866, mori edhë diplomën si mësonjës i shkollavet fillore edhë dhà mësim ndër shkollat e Frasnités deri në vitin 1873, kur i erdhë pas në famullinë e Frasnités papa Mëhil Belushit.

Bilotë merrej jo vetëm me pedagogjinë, me filosofinë, me theologjinë, por edhë me gjuhësinë e me letërsitë klasike e moderne; por dashuri më të madhe ka pasur për gjuhën arbëreshe, të cilën ai e quante «hyjnore». Në gjuhën italiane ka shkruajtur

\* ) Gjuha e studimit hyrës të shkruar prej Emanuil Jordanit u la e parprekur; u ndje e nevojshme vetëm që, për të ndihmuar lexuesin tonë, në ndonjë rast, të jepeshin shpjegimet përkatëse.



P. EMANUIL JORDANI

shumë vepra filologjike mbi gjuhën arbëreshe, edhë i batoi që nga viti 1893 deri në vitin 1915. Atò vepra janë:

- 1) *Circa i Pelasgi* (Rreth Pelazgëvet) Castrovillari, 1893.
- 2) *L'anno presso i Pelasgi Albani* (Viti ndaj Pelazgëvet Arbëreshë) — Catanzaro, 1898.
- 3) *Gli Enti Sacri della Bibbia* (Të qenat të shëjta e Bibljes), pjesë e parë — Castrovillari, 1897.
- 4) *Të qenat të shëjta e Bibljes* (e dyjta pjesë) — Castrovillari, 1899.
- 5) *Nota compendiosa circa l'Eden* (Shënim i shkurtër rreth Edenit) — Cosenza, 1911.
- 6) *Le mie opinioni archeologiche e Preistoriche* (Mendimet e mia arkeologjike dhe parahistorike) — Castrovillari, 1911.
- 7) *Archeologia di Romolo e Roma* (Arkeologjia e Romolit edhë e Romës) — Castr. 1913.
- 8) *Studio filologico e preistorico circa Dardano di Corinto* (Studim filologjik e parahistorik rreth Dardanit të Korintit) — Castrovillari, 1915.
- 9) *Studio filologico circa gli Eroi preistorici* (Studim filologjik rreth heronjve parahistorikë) — Castrovillari, 1915 etj.

Të parat vepra që Bilota batoi në gjuhën arbëreshe janë këtë:

- 1) *Vjershe të përlipëm* (të hidhëruar) — (Versi Lugubri) — Castrovillari, 1894.
- 2) *Nder të mirvet e sharje të liqvet* (Stima agli ottimi e blamico ai tristi) — Castrovillari, 1898, etj.

Mbë 9 të gushtit 1898 Akademia kombëtare italiane e Diturisë, së Letërsisë edhë t'Artëvet, me seli në Firenzë, nderoi Bilotën me diplomë si anëtar i përmotshëm (membro effettivo). Diploma të tilla i qenë dhenu atij edhë nga Akademia «Leonardo Da Vinci», me seli në Tortonë; edhë nga Akademia ndërkombëtare Partenopé, në Napoli. Ai ka qenë edhë anëtar i Komitetit paralevizor i Kongresit gjuhësor arbëresh, në Kurlanë, ku mori pjesë në muajin e tetorit 1895, bashkë me De Radhën, Argondicën, Kamodekën, Ribekun, Loreqin e të tjerrë. N'atë mbledhje dijetarësh arbëreshë Bilota paraqiti, me një fjalim arbërisht, alfabetin e gjuhës arbëreshe, që ai përdorte nér shkrimet e tij, ishte alfabeti që Bilota përdori edhë në veprën «Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë». Në një poezi arbëreshe, që ai lexoit n'atë Kongres, i thonte pjesëmarrësvet: «Veni kujdes ndë të studjuerit, ndë të folurit e ndë të shkruerit të kësaj Gjuhje, se t'paraqitni të famëshme ndë mes të gjuhëvet të Botës, tue nxeh-tësuer<sup>1</sup> dijetarët të huej t'ë duen mirë atë gjuhë».

1) duke nxitur, duke ndezur.

Për sa i përket artit poetik të Bilotës, dua të shënonj këtu gjykimin e Jeronim De Radhës, i cili, tue i kushtuar atij një kopje të konferencës së tij «Mbi vjetërsinë e gjuhës Arbëreshe», i shprehet me këtë fjalë: «Mikut e vjershtarit të vërtetë, krye-priftit Bilotë, me një «BRAVO» nga zëmra».

Rrjeshtova më lart veprat që Bilota batoi në gjuhën italjane edhë të paktat në gjuhën arbëreshe; por atò të shkruara në gjuhën arbëreshe të pabotuara janë më shumë edhë më të vlefshme. Atò qenë të gjitha të ruajtura nga i nipi Gustin Jordani, ati im, i cili m'i dorëzoi mua, pse Bilota i kishte thënë: «Deri që të mos të dalë një prift nga familja jonë, që t'i kuptionjë ata shkrimë, mosnjeri ka t'i ngasë».<sup>2</sup>

Bilota filloj veprimtarinë e tij vjershtarake-letrare arbëreshe nga muaji i nëndorit të vitit 1870, me veprën «MARKURI I DORSIT», kjo punë satirike përmbleth më se 1500 vargje shtatë rrokjesh, ku Auktori dënon rreptësitë e nji shoqatje e udhëhequr nga një sundimtar i vendit; kjo veprë q'çshë e para më radhë kro-nologjike (1870), na trëgon ndjenjat e këtij shkrimtari, i cili, tue qenë një njeri i drejtë, nuk duronte aspak padrejtësitë e njerëzvet kundër vëllezërvet, vecanërisht kundër të varfërvet e të përunjtëvet. Kjo karakteristikë stili dhe mendje, që nuk duron rreptësi e zgjedha, vazhdon nëpër gjithë shkrimet e tij, edhë nér ata fetare. Mund thomi kështu se Bilota ishte vërtet një përiagësues i fisit shqipiar, me të cilin ai shpërndante<sup>3</sup> edhë vuajtjet, ose psimet. Novela ose përrallza shumë e bukur, me titull «TRIDHIXHINI» (I trembëdhjeti), që përfshin afro 2000 vargje tetë rrokjesh, nuk ka datë, por nga alfabeti që atjë përdoret, duket e vitit 1870. Kjo veprë lexohet me një marrëfrymje, për argumentin edhë për rrjedhjen e vargjëvet. Auktori i jiptë asaj shumë rëndësi: Varfëria e nji familje e madhe zhdukët me anën e ndëlgimit<sup>4</sup>) edhë të fatmirësish të më të voglit ndër 13 vellezërit.

Te viti 1874 filloj poemën epike: «SHPATA SKANDER-BEKUT NDE DIBRËT POSHTË». Tre redaktime të pambaruara janë të vitaveit 1874, 1878, 1888; redaktimi i prasëm i mbaruar është i vitit 1890. Gjithë këta redaktime na dëftojnë se Auktori i epëte shumë rëndësi kësaj vëpërje 12 kangelesh, me më se 10.000 vargje gjashtë e shtatë rrokjesh. I paraqet atyre 12 kangeleve edhë një «kangjel të vetëm», në të cilin rrëfyen një dyluftim që Skanderbeu pati me një tartar vigan në Adrianopol; ai kangjel është i përbërë prej 56 strofash, gjashtë vargjesh, gjashtë

2) anjeri të mos i preke

3) ndante

4) me anën e zgjuarsisë

edhë shtatë rrokjesh, edhë i përket redaktimit të vitit 1874. Alfabeti që përdoret në ktë redaktim është pak i ndryshëm nga si që përdoret në redaktimin e prasëm të veprës «Shpata Skandérbekut ndë Dibrët Poshtë». Edhë gërmat janë shumë të qarta.

Gjat vitit 1888 Bilota mbaroi së mbledhuri gjashtë milë fjalë të foimes të Frasnités, në një «FJALOR» afro 200 fajesh. Më 18 të korrikut të vitit 1891 mbaroi «MONOGRAFINE E FRASNITES». Kjo vepër historike ndahet më 5 pjesë. E pesta është e pambaruar, pse rrëfimi qëndron<sup>5</sup> nér të prasmat ngjarje të shekullit XVIII. Kjo monografi përblyeth 332 strofa gjashtë vargjesh, d.m.th. afro 2000 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. I është paraqitur Monografisë një tingëllim që fillon kështu:

Mbë shesh të gjerë, gurisht e të dritësuer,  
Frasnita zbukuron ndër këmbë nji mali,  
degë t'Apenninit 'bukur e lulëzuer,  
ka ujë e verë e ajer si miali...

Me gjithë se kjo vepër nuk është shumë e dokumentuar, mbetet gjithmon një burim lajmësh të çemuara, pse këto janë të marrura nga tradita popullore, kuj<sup>6</sup> Arbëreshët qenë e janë gjithmon besnikë.

Ndofta për të plotësuar Monografinë, Bilota shkruajti vepër «ZAKONET E FRASNITES» ture e mbaruar mbë 23.10. 1894. Në këtë vepër rrëfen zakonet, traditat, lozjet, të kremitjat, që zhvillohen në Frasnité gjat 12 monjevet të vitit. Ajd vepër përblyan 570 terçina, d.m.th. 1710 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Vlera e saj është e madhe, pse na trëgon dashurinë e popullit arbëresh për zakonet atdhetare, tue na prierrë<sup>7</sup> prapë nér burimet e tyre, ose në Shqipërinë e Skandérbeut. N'atë të njëjtë dorëshkrim Bilota shton edhë: «SHKULQINË (krushqinë), MARTESEN, TË LERIT (lindjen) dhe PAGZIMIN», me datën 26 maj 1894. Këto pjesë të shtuara përblyedhin 232 strofa, d.m.th. 1329 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Vlera historike, folkloristike, psikologjike e poetike të ksaj vepërje është shumë e rëndësishme, pse Auktori përkruan besnikërisht lajmet, tue ndërhyjtur thellësisht ndër ndjenjat popullore e tue na paraqitur jetën e thjeshtë, të nderuar edhë punëtore, që populli arbëresh jetonte deri në shekullin XIX. Bilota ankohet ndër vargjet e prasme se këta zakone venë tue u harruar, me modernizimin e shoqërisë njerëzore, pas njësimit të kombit Italian, edhe thot: «Po ç'ka tri-zeti (1860) gjindja u shkatarrua — sa nga zakon i mirë râ posht e u shua!»

5) tregimi ndërpitet

6) të cilës

7) duke na kthyer

Njera ndër veprat më të vëllimëshme është «E BUKURA E JETËS», të cilën ja kushton, si shënje nderimi e miqësije, «Kalognderit<sup>8</sup> e të famshmit poet e filolog arbëresh Jeronim De Radhës», tue ju kushtuar edhë ai si një nxënës shumë i devotshëm. Kjo vepër është një novelë arbëreshe, e mbaruar mbë 22 shkurt 1895, që përblyeth 440 tingëllime, d.m.th. 6160 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Atjë rrëfyhet se një trim (Pjuhurini), bir mbreti, me një kal të fatostë,<sup>9</sup> pëstaj, që tue gjurmuar, gjeti tri motrat e tij, të vjedhura nga Dielli, nga Era e nga Orku,<sup>10</sup> vjeth edhë të Bokurën e Jetës, të cilën e vë kurorë me shumë madhështi.

Njatër novelë Bilota e mbaroi mbë 16.2.1896, tue e titulluar «E BUKURA HAREZË» (La Bella Letizia), e cila përblyeth afro 2000 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Atjë rrëfyhet historia e një mbreti, që dërgon një kalor ti gjënje të Bokurën e dheut, pse ai mbret do t'e martonjë. Kalori, pas shumë kërkimeve adventurore, gjën edhë vjeth të Bokurën; por kjo, kur arrën përparrë Mbretit, shpreh dëshirën të martonjë kalorin e dashur edhë të aksém,<sup>11</sup> në vend të mbretit të keq e të përtuashëm, i cili pëstaj është i vrarë me vaj të zier e me ujët e Pisës! Në këtë përrallëz Auktori dënon krenarinë e mbretërvet, tue lartësuar thjeshtësinë e të shtypurvet.

Mbë 4 të prillit 1903 Bilota filloi «MINOSIN» një vepër mitike, e formuar nga 28 kangele, që kalojnë 8000 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Njatër redaktim të ksaj vepërje, me disa shtesa e mbaroi mbë 3.11.1909, e cila përblyeth 37 kangele me 8664 vargje njëmbëdhjetë rrokjesh. Por Auktori i ndryshon titullin, ture e quajtur «SKENA TË TMERSHME E TE GEZUESHME TË JETËS MBATANË VARRIT» (Scene orrende e deliziose della vita d'oltre tomba). Në këtë vepër Bilota, tue u frymëzuar nga Komedia Hyjnore e Dantit, është i ftuar nga Zara (Fata)<sup>12</sup> e vetë, edhë shkon nér tri mbretëritë e së jatës jetë, ku xë shërbise<sup>13</sup> të panjohura, njeh shumë njerëz të Historisë së moçme, edhë sheh disa bashkëfshatarë Frasnjetë, tue folur me ta. Një redaktim të trejtë të MINOSIT, shumë të përpunuuar, e fillon mbë 18.4.1918, por e lë të pambaruar te kangjeli i XVIII, në fund të cilit shënon datën: 8 theristi (gershor) 1918; 8 ditë para se të vdiste.

8) Kalorësit të nderit

9) magjik

10) qëni mitologjike, që i ngjan kuçedrës ose lubisë

11) të shpejtë, të shkathët

12) Zana

13) zë shërbime, funksione

Mbë 30.9.1903 mbaroi -PISEN- (Ferrin), një poemë 10 kantigjesh, që përblye 3276 vargje njëmbëdhjetë rrrokjesh. Kjo vepër duket se është vijimi i MINOSIT, pse fillon me këtë fjalë: «U lodha, fata ime, më tue vrerë<sup>14</sup> — të mjerit të ngalesur lik e zi<sup>15</sup> — Hapmë më dier të vrenj, se të mund xë-më drejt si gjella e dijtë e piksur ë-<sup>16</sup>. Ndë Pisët Auktori dënon jo vetëm krimineltë e vjetërsisë, por edhë bashkëkohasit e tij të liq. -JETËN E SHËN MERISE-, që përmban 7 kantigje me 1720 vargje pesë rrrokjesh, e mbaroi mbë 18 të majit të vitit 1896. Mbë 31 maj 1896 mbaroi edhë -TË VDEKURIT-, në të cilën vepër rrëfen ngjarje të jashtëzakonëshme e të përmbinatyrrëshme edhë çfarë të vdekurish. 5 kantigjet e veprës përbajnë 2000 vargje njëmbëdhjetë rrrokjesh. -MONOGRAFINE E SHËN NILIT-, kallogjer i shëjtë basiljan nga Rusana (Rossano) edhë themelues i Monastirit të Grotaferratës, e shkruajti në rasjen 900 vjetorit të vdekjes së tij. Vepra grumbullon 122 strofa gjashtë vargjesh njëmbëdhjetë rrrokjesh. Drama komike -DON KISHOTI-, 3500 vargjesh shtatë edhe tetë rrrokjesh është e komponuar gjatë vitit 1908. Atjë auktori rrëfen veprimet e njëi bashkëfshatar utopist e të qmendur, edhë të shokvet të tij. Më 26.6.1916 mbaron njatër vepër të titulluar -JETA E SHËN MERISE-, e cila është e formuar nga 127 tingëllime. Të tjerët 200 tingëllime, të titulluar -SHEJTRAVET SHËRBYER KA UNË MBE QISHE- sjellin datën e 21.12.1917. Këtyre veprave ka me u shtuar shumica e përrallavet edhë të legjendavet, të kalimeravet, të ndodhivat, të fjalavet t'urta, edhë të ligjiratavet, që Bilota ka shkruar qysh prej vitit 1870 deri në vitin 1918. Këta komponime përbledhin më se 20.000 vargje të ndryshme, bashkë me disa fjalime në prozë. Mbë 15.12.1905 mbaroi edhë veprën satirike -VEPRA TË TURPËSHME NJERZHISH TË PADENJE- (Turpi gesta di persone indegne), që e kishte filluar mbë 15 të shtatorit t'atij viti. Në fund të veprës Auktori shkruan këtë shënim: «Më dhispëlqen<sup>17</sup> se pat' zhyeja pendën, tue rrëfyer veprat e turpëshme njerzhish të padenjë për poemë e për Histori; por i shkrova se të jenë të dënuar prej gjindjes së ardhëshme».

Në këtë veprimitari vjershtarake Bilota thomse ka mbledhur afro të tërë traditën historike, përrallore e folkloristike të popullit arbëresh të Frasnitës, edhë pjesë të Arbëreshvet të Kalabrisë. Përandaj meritat e tija ndaj gjakut Arbëresh të shper-

14) duke parë

15) të fajësuar keq e mos më keq

16) si është bërsë jeta e dytë

17) më vjen keq

ndarë edhë ndaj Shqipërisë qenë e janë të mëdha; edhë ëmri i tij do të jetë i përkujtuar dhë i lavdëruar nga të gjithë Arbëreshët edhë nga Mëmëdheu i dashur dhë i paharruar.

\* \* \*

E madhe ka qenë edhë ndjenja e tij patriotike për Shqipërinë, pse idea kombëtare për një Shqipëri të lirë, të madhe dhe të lavdishme gjeti te Bilota një mbrojtës të singertë, të bindur edhë plotë entuziazëm. Frymëzimi patriotik na dëftohet nër të gjitha veprat e tija vjershtarake, ashtu që dashuria e gjuhës edhë e kombit shqiptar bashkëshkirene e njësohen në një ideal. Përandaj nuk mund harronj të vë në dukje veprimtarinë e vencantë dhe rolin që ai pati në lëvizjen patriotike për lirinë e Atdheut, bashkë me të tjerët Arbëreshë, që patën për krye De Radhën. Bilota e kishte të gjaku tij Shqiptarizmin, pse ndihej arbëresh i vërtetë, edhë ishte i bindur se Populli arbëresh kishte rrënje të thella në historinë e njerëzimit, se ishte një popull i fortë, i nderuar, fisnik, i mençem edhë heroik; se gjuha arbëreshe ishte një gjuhë hyjnore, e përandaj shumë e lavdishme midis të t'jeravet gjuhë. Ai luftoi qysh prej rinisë së tij me shkrime, me fjalë e me punë, për të përhapur këta ideale, ndë mes t'arbëreshvet edhë në botën e jashtme. Fliste arbërisht mbë kishë edhë jashtë, shkruante arbërisht gjithëmon, edhë natën, e porosiste dhe këshillonte arbëreshët të flisin arbërisht. Por unë thom se mjaftojnë veprat e tija vjershtarake (të cilat kalojnë 200.000 vargje) edhë filologjike të botuara në gjuhën italjane, për të na treguar neve dashurinë e tij të madhe për gjuhën e përgjakun arbëresh!

Argumendet<sup>18</sup> e ndryshme që ka trajtuar nër veprat e tija, e që unë i kam radhitur më parë, flasin e provojnë haptazi se Bilota ishte i kapur nga këta ideale dhe, gjaja se koha e jetesës së tij do t'ishte e shkurtër, shkruajti gjithëmon, pa u lodhur, të gjitha ndjenjat e tija, tue i shprehur në gjuhën arbëreshe, për me e lartësuar, e lavdëruar, e nderuar edhë e përhapur në botë!

Por çë i lypsej dashuria e gjuhës ndë qoftë se Atdheu vuante në robëri nën pushtimin turk edhë rendte rrëzik t'ishte i zhdukur nga fqinjtë e tij d.m.th. nga Grekët e nga Sllavët? Përandaj Bilota luftoi me shkrimet e tij të zjarrët pér çlirimin e Shqipërisë, dhe bashkëkohasit Arbëreshë, tue njohur fuqinë e shkrimevet të tij, e bashkuar si pjesëmarrës të ciltër nër mbledhjet e tyre e nër kongreset patriotike. Në kongresin e Kurëlanës (Corigliano Calabro) 28.9.1895. ku ai mirrte pjesë, në mbarim të fjalimit tij

18) temat

arbërisht, plotë entuzjazëm, lexonte edhë një poezi të gjatë, për të lartësuar edhë të mbrojtur gjuhën arbëreshe, që fillonte kështu:

O që dritë me hjé  
ë kjo për në Arbëreshë!  
Dritëson me dritë të ré  
kjo ditë, që mbjethët na deshë,  
këtë Kurëlanë, katund nga mot nderuer,  
se t'thomi c'ësht me bënë,  
të ngrëjmi gjuhën tënë,  
c'ësht gjuhë më e dritësuer!

Mori pjesë edhë në Kongresin e Ungrës (Lungro), 20.9.1897, ku, tue folur arbërisht, propozoi punimin e një fjalori arbëresh, që ai pëstaj përpiloj, si thashë në radhitjen e veprave të tija, tue mbledhur më se 6.000 fjalë. Në rastin e hapjes së katedrës së gjuhës arbëreshe në Napul (1900), Bilotë shkruajti disa tingëllime, për të shprehur gjëzimin e math që i mbushte zëmrën, pse për të parzën herë gjuha arbëreshe mësohej në një universitet italjan. Tek viti 1902 e shohim si anëtar i Komisionit Kombëtar Arbëresh, i mbledhur në Napul më 13 të prillit, për me organizuar lirinë e Shqipërisë, e cila atyrëve i dukej shumë e afërme. Shchim edhë emrin e Bilotës, te viti 1904, në Shoqatën e Këshillit Arbëresh t'italisë, me seli në Romë, e cila kishte për qëllim koordinimin e aspiratavet të Kombit Shqiptar, i cili luftonte për territorin e tij kombëtar. Në një tjatër mbledhje Arbëreshësh, të 29.9.1906, Bilotë mbajti një fjalim të gjatë në vargje arbëreshë, tue filluar kështu:

Shokë, gjithë zotra hadhjarë<sup>19</sup> edhë bulerë,<sup>20</sup>  
babarem<sup>21</sup> të ju rrëfyenj  
harezën, që më velen<sup>22</sup> e thell ndienj,  
te ju shoh gjithë mbjethët të tretën herë,  
se t'e folmi njeri jetri që kem' bëmi,<sup>23</sup>  
e si të qellemi<sup>24</sup> gjithë, të shomi  
të dritësuer gjakun tënë e gjuhën tënë...

Mori pjesë edhë në Kongresin ndërkombëtar Lindor të Romës, ku lartësoi gjuhën arbëreshe, tue zbuluar prejardhjen e asaj

19) fisnikë

20) bujarë

21) turbullohen nga emocioni

22) më kënaq, më deh

23) q'do të bëjmë

24) si të sillemi, si të veprojmë

gjuhje nga Pelazgët, tue vënë në dukje historinë e lavdishme të popullit arbëresh e tue ftuar pjesëmarrësit të studjonin atë gjuhë e të luftonin edhë për lirinë e Atdheut shqiptar. Mbëllinte fjalimin me një kangjel drejtuar autonomisë, që fillonte me kjo fjalë:

Arbëreshë Maometanë e të kërshterë,  
gjithë nji gjuhje e gjithë gjiri,  
ehjmi<sup>25</sup> thikët e tënës nderë,  
ndë duem' kemi Autonomi!  
Vetë me ehjtë<sup>26</sup> na mund e kemi  
si ka Turku<sup>27</sup>, zëmër qenil...

Shkrimet e tij mbi luftën për lirinë e Shqipërisë janë shumë, aq sa nuk mund përmenden të gjithë. Një studim i veçantë e i plotë do të vënte më në dritë, edhë në këtë fushë, figurën e tij madhështore.

Shkrimet e Bilotës janë të fryshtuar nga mendime shoqërore e njerezore. Ai përkujdeset për drejtësinë shoqërore e lufton me punë edhë me shkrime kundër shfrytëzimit të njeriut prej njeriut. Në të gjitha veprat letrare na shohim se Bilotë hidhet me ashpërsi të madhe kundër të padrejtëvet e mbron të varfërit edhë të shfrytëzuarit, tue mbrojtur kështu drejtësinë edhë lirinë e njeriut edhë të kombevet. Por disa vepra mbrojnë vëcanërisht drejtësinë shoqërore, si për shembull: «E bukura e jetës», «Minosi», «Vepra të turpëshme njerezish të padenjë», «Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» etj, ashtu që na mund thomi se Bilotë, si Arbëresh i drejtë e paqedashës, ka qenë një njeri që ka lufthuar gjat gjithë jetesës së tij, për drejtësi, paqe e liri, tue dhënë një kontribut të math për mbrojtjen e të drejtavet edhe përparimin e Popullit Arbëresh e Shqiptar.

E vetmja e metë e Bilotës mund kishte qënë se nuk botoi veprat e tija; por ku i kishte mjetet ai për t'i botuar?... I varfëri si ishte, ai nuk e pati atë mundësi. Por na e défton ai vetë me shumë mospëlqim, ndë një poezi kushtuar vehtes së tij, mbë 4.3.1911:

Për helmin e sëmundes, biltë e mi<sup>28</sup>  
si të nëmur shkojen gjellen ktu mbi dhë,  
s'kanë kush t'mi paltonjë më me gjadhi<sup>29</sup>,  
të buthtohen<sup>30</sup> ndë jetë me dritë të réi...

25) të mprehim

26) me lehun e shpatave

27) prej turkut

28) -biltë- janë veprat e tij letrare

29) me gjëzim

30) të déftohen, të çfagen

Por na urojmë edhë besojmë se ndonje ditë ato vepra «do të dëftohen ndë jetë me dritë të rë», të nderojnë ashtu emrin e tij edhë të pasurojnë letërsinë arbëreshe edhë shqiptare.

Në qoftë se kish' të përshkruhej e tërë jeta, edhë kish' të flitej mbi gjithë veprimtarinë e këtij arbëreshi të ciltër, unë besoj se do të mbushëshin shumë vëllime! Përandaj, tue shkurtuar, thom vetëm se Binard Bilota pas nji jetje me përpjekje e me mundime, në të cilën veproi e luftoi hantazi pér mbrojtjen e Atdheut shqiptar dhe të Besës, vdiq në Frasnitétë mbë 16 të qershorit të vitit 1918. Gjat shërbesës së varrimit të tij, mori pjesë i tërë populli i Frasnitétës edhë të fshatravet fqinj, tue i treguar ashtu shpirtit tij të lumen të prasmej ndjenjë të vehtes edhë të mirënjohjes së tyre.

#### FRASNITA.

Mbi Frasnitén na flet gjat Bilota, pse është vendi i lindjes së tij, aq në «Monografinë» sa në «Zakonet e Frasnités».

Shumë i bukur është përshkrimi i atij katundi në fillim të Zakonevet të Frasnités:

Zëmi t'Frasnité e thomi<sup>31</sup> që t'i ngjet,  
Thomi ku zbukuron, thomi ku nxin,  
thomi si vera e dimri ja kërsët:

.....  
Frasnita ka vorë<sup>32</sup> Pulinin ká,  
me bredhra e bar që shéron ka smundë e kollë.  
Pulini, ku gjithë dimrin bën rréká<sup>33</sup>  
bora, çloset vet me ardhur vera,  
ndën ujra t'ftohtë Frasnité, që bukë të há.  
Frasnita, si do e bëgatë ësht, ka pakë dhera  
me mbjelë e bënur bukë, gurishtel ësht,  
me shurë të bardhë ka ana saj më e gjera.  
Mbë shesh ë vénë Frasnita: nd'anet posht  
dhera bukje, ullinj, lis ká e shén Llin  
me vreshtha ç'bëjen veren aq të shëndoshtë!  
Thonë se ka bregu posht ka një saline<sup>34</sup>  
pak thelli bot' e bardha, ç'kur shkon  
kavsha holë atej sulet e lëpín!

31) fillojmë të flasim pér Frasnitén

32) nga veriu

33) shndrohet në rrëke

34) burim kripe, kripore

Gjithë ajret zënë Frasnité: e dhistanon<sup>35</sup>  
punendi ngrohtë, që nd'verë edhë livisen  
e ullinjvet që kanë lidhjen lulet shtëllon!  
Ndë dimer eger ajri vrundullisen!

Vorea më frin e keqe e dica herë  
si fjeta shpivet qaramidhet nisen!

Ndon' herë kjo frin e nxërrartur dhe ndë verë  
e me të ngritten frimë karpon çarmaren<sup>36</sup>  
e shkatarron dhe rrushët, 'çkanë' bëhen verë!  
Shkunden ullinj e lisë e çdo i mbarraren<sup>37</sup>;  
Ndë verë si ajri nëmes ndër né frin,  
se gjithë karpon ndë det na zdarrangaren!<sup>38</sup>  
S'i sosen se ndë dimer keq na ngrin,  
se s'mund na 'dalmi ahjimaz të shurbemi  
e kush s'ka bukë pér të lik shumë gjillin

Frasnita u themelua në vitin 1491; nga Arbëreshët që iknin nga Arbëria e jugut, por besohet se ishin me ta edhë Arbëreshë prej veriut, pse folmja e Frasnités ka edhë disa karakteristika gege, si edhë disa mbiemra janë të Shqipërisë të veriut. Në vitin 1534 erdhën në Frasnité edhë Arbëreshë nga Morea, prej qyteteve të Koronës, të Modonës edhë të Naupljes, të cilët u quan «Bulérë Koronenj», edhë u shpërndajtin afrë nëpër gjithë katundet arbëreshë të Kalabrisë edhë të Siqelisë. Arbëreshët u vendosën nga lindja e katundit lëtë (italjan), i quajtur: Kazal i Shén Pjetrit, dhe pastaj: Frasnité; atà u vunë nën kujdesinë shpirtërore të kallogjerëve Basiljanë, që banonin monastirin e Shén Pjetrit, 300 metra afér katundit. Por nuk shkoi as një shekull e «Lëtinjtë» u bënë Arbëreshë! Arbëreshët e Frasnité ishin shumë të varfër, si edhë vëllezërit e tjerë, por, pse kishin qënë ushtarë të Skanderbeut, ishin guximtarë edhë të rreptë; përandaj zotëronin mbi lëtinjtë.

Në vitin 1738 Frasnita u bë e pavarur nga kallogjerët Basiljanë, dhe priftërinjtë arbëreshë të ritit bizantin ndërtuan Qishén e madhe, të kushtuar Shén Mërisë Gushtit. Në shekullin XVIII Frasnita kishte më shumë se 20 priftërinj, Bilota i némoron të gjithë ndër shkrimet e tij. Ndër ata némeron edhë Ded Belushin, peshkop e rektor i kolegit të Shén Adrianit edhë të vëllaun e tij Mehil Belushin. Nga Frasnita ishte edhë Viçenx

35) trazon

36) frytlin prish

37) çdo gjë që e pengon

38) turren, i flak era né det

Dorsa, leterar arbëresh shumë i njojur; kapitan Frashini, që luftoi me Gjeneral Damisin e me të tjerë vullnetarë Arbëreshë ndër luftat për lirinë e Italisë nga Borbonët. Emret arbëreshë a grekë të familavet në Frasnitë janë këta: Barbati, Mashi, Blajota, Skuraqi, Skutari, Plaku, Kuça, Luçi, Toçi, Perroni, Bafa, Tosku, Gega, Frashini, Kidhikmi, Shpata, Pisarri, Bellici, Dorsa, Ferrari Gropa, Braili, Pelakani, Zakaria, Xukari, Kamodheka, Papadhà, Lo Preti, Dimarku, Rödhotà, Lauriti, Marqanoi, Mauri, Polikastri. Xakari etj...

Frasnjotët, si gjithë Arbëreshët, kanë qënë gjithëmonë liridashës, përandaj kanë luftuar kundër gjithë tiranët e tiranivet, kështu edhë kundër Franxesvet të Napoleonit, në vitin 1808, të cilët kishin ardhur si lirimtarë e pastaj u dëftuan si pushtonjës. Ata thërrisnin Arbëreshët «hajdutë», pse luftonin për lirinë.

Frasnjotët, si të gjithë Arbëreshët, janë punëtorë të palodhshëm, si prindët e tyre, të cilët ndërruan pyjet e djerrat në dhera bukje, ullinjsh e vreshtash. Frasnita numëron bashkë me fshatin Ejaninë afro 3.000 banorë. Toka është e përpunuar dhe prodhon shumë verë, vaj, grurë, barishtë për kavshat (dhen dhi, lopë) dhe dru prej pyjevet të malit Pulin (2271 metra).

Frasnita është edhë një qendër kulturor arbëresh, pse atje ká shumë studjues të gjuhës së edhë të traditës arbëreshe. Këta mbajnë lart ndjenjat atdhetare, tue zhvilluar edhë marrëdhënjet kulturore me Shqipërinë, Atdheun e prejardhjes së tyre.

\* \* \*

#### VREJTJE E SHËNIME MBI «SHPATËN E SKANDERBEKUT NDË DIBRËT POSHTE».

Pse Bilota e ka shkruajtur? Pse i ka dhënë aq rëndësi? Mjaf-tonte këndimi i të dy tingëllimevet, që Auktori paraqit Poemës, në fillim të veprës, për të kuptuar qëllimin e rëndësinë e saj. Por arësyja ose shkaku që ka shtyjtur Bilotën t'ë shkruante «Shpatën e Skanderbekut ndë Dibrët Poshët» ka qënë edhë zgjimi kombëtar, që ndezte n'atë kohë Arbëreshët e Shqiptarët, të cilët luftonin për lirinë e Atdheut. Figura e Skanderbeut do të entuziazmonte patjetër vëllezërit Arbëreshë dhe Shqiptarë, të përtërirrin gjestat (veprimet) heroike të tijat kundër pushtimit turk, që mbante akoma, pas 400 vjetsh, Shqipërinë në robëri. Bilota lexoi edhë jetën e Skanderbeut t'ë shkruar nga Marin Barleti edhë atë të shkruar nga Papadhopulo Vreto, këtë vepra i kam

gjetur në Bibliotekën e Bilotës. Prej këtij leximi Ai ka marrur frymëzimin, entuziazmin edhë të shtymen të këndonte dhë të lartësonte Skanderbeun edhë Shpatën e tij. Bilotë zgjodhi pëstaj luftimin e parë kundër Turqvet, që u zhvillua në Dibrën e Poshtme, si argument qëndror të Poemës, pse ai luftim i ashpër edhe i përgjakshëm ka qënë prova e parë e zjarrit e Ushtrisë shqiptare edhë e Popullit shqiptar, të përbashkuar nën udhëheqjen e Skanderbeut.

Eshtë vërtetë se Bilotë rrëfyen vetëm të parin luftim të Skanderbeut kundër Turqvet, por është edhë vërtetë se në atë luftim janë aq shumë e të ndryshme ngjarjet, skenat e vetat që marrin pjesë, sa kjo poemë na dëftohet, thomse, si një pamje e njëshme e të gjithë luftës épique, që Heroi kombëtar ka luftuar bashkë me të tërë popullin Arbëresh gjat 25 vjetvet të historisë së tij të lavdishme. Në qoftë se Bilotë kishte pasur mundësi për të botuar «Shpatën e Skanderbekut ndë Dibrët Poshët» qysh kur e kishte shkruar (1890), patjetër e kishte dhënë edhë Al, si De Radha e të tjerët shkrimitarë Atdhetarë, një kontribut të math për çlirim e Atdheut.

#### ELEMENTI PATRIOTIK NË «SHPATËN E SKANDERBEKUT NDË DIBRËT POSHTE»

E tërë «Kendimeza» (Poema) është një himn patriotik, pse në ato lartësohen Besa, Guximi edhe Heroizmi Arbëresh. Atje mbrohet liria e Kombit Arbëresh edhë lartësohen lufta e shënjtë, në të cilën populli arbëresh përballon sulmuesit turq, që kishin pushtuar Arbërinë e që e mbanin në obskurantizem dhe në shfrytësim.

Patriotizmi në Poemën na tregohet te fuqia edhe tek urtësia e Skanderbeut, i cili mundi të bashkonte kërçet dhe popullin arbëresh, tue i njesuar brejt veftes së tij e tue shtenur themelët e Kombit Shqiptar. A nuk ka qënë figura e Skanderbeut edhë lufta e tij épique në shekullin XV, që i ka dhënë fillim lëvizjes së Rilindjes kombëtare të shekullit XIX? Përandaj ky veprim bashkimi e njesije na tregohet cé nga fillimi i veprës, ku Bilota, në kampjelin e parë dhe ndër të parat strofa përhruan entuziazmin e Popullit dhe gjëzinin e natyrës, t'ushtrisë edhë të Vashavet arbëreshe, të cilat «Trimavet këndojen — vatur t'i nderojen — nën Skanderbekun — krye cé shkëlqenej — mbi sa burra ahier — jeta me drithë vrenej...» Dhe ja, pastaj, si në kampjelin e dyjtë (str. 107-111) shpreh patriotizmin, në fjalimin që Skanderbeu i drejtonte ushtarëvet: — Liqja, o gjiri, — është ka ana jo-

nët... Ndomos se janë shumë — Turqit së kanë që bëjen — me k'ruejen nderen — e dinë si luftojen... — U gë shokë i pata — zëmren 'tire mata'. Me këto fjalë Skandërbeu shokvet gjiri -Shkrepitin ndë gjit — i zgjonej e fuqitë!.

Entuzjazmi i ushtarëvet ishte aq i math, sa në kangjelin e parë (str. 8-9) këndohet se: «Enda i haj të strosëshin — si ka Turqit ndodhëshin. — Dojtë vén t'i timosjen — ndër malet e Asisë...» Në strofen 24-32 Skandërbeu shton entuzjazmin e ushtrivet, kur flet mbi «ditën e Arbërisë», që gjithë populli priste, pas së parës ndërrhyrje turke në Atdheun: «Gjegjni, prematjotë —, e ndreqi të strosemi — Turqet, si lliunra, — se t'i fanarosemi, — t'i shprishmi, t'i llargomi — që kanë t'i kallomi. — Jemi ndë ditë të lusur — e që me mua dojet!... kur mua ndë dhët turk-shkronjet e taj dirgojet, — diovasja e s'fjisja — e lutja 'mos 'vdisja, — si vëllezërit e mi, — prana'bë'të shijet — kur të piqej dhera — si ju mund shtijet — Turkum ka bazuli — mbi ku dja-lli e uli! — Gjithë puthmi kët herë, — që ka t'na nderonjë —... dishëruem kët ditë — që ka t'na mburonjë — Besen, hjenë e gjellen — që të mirat pjellen!...» etj.

Patriotizmi i ushtarëvet vërtetohet në veprim me entuzjazmin që ata dëftojnë në luftën e parë kundër Turqve, që fizojnë kangjelin e trejtë; atë bëjnë vepra trimërije, tue vrarëllon në kangjelin e rrëmbej (str. 164), sa: «Sheshi merjes duket — aq ushiarë e krerë turq (str. 164), sa: «Sheshi merjes duket — copa ku rëkohet — e qahet ndër lucat — me gjak, ku lingohet...» E pëstaj, edhë kur Turqit në kangjelin e gjashtë (str. 35-36) janë gati po të fitojnë, për shumicën e ushtrisë së tyrc, edhë thërrresin me harë: «Gavnjiem!... — Për leshi i rrëmbej — gavnjinë Arbëreshvet — që ndihu njera ni...», Arbëreshët, pa u tronditur, nuk bjerin guximin, por (str. 40): «Arbëreshi thoj me tru —: u këtjetej ju pres... — ndë trakulatë ju dua — t'ë shihni ju me mua!...». Dhe kur u përsërit lufta (str. 78-79): «Si suvalë e madhe — këtu Arbëreshët sulshin — si ulqit ndër dhentë — ndëper Turqit ngulshin — eger e vrisjen — e shponjen e prisjen — si kush rrungon ferra — o kueren ndër copat — e varra gjak mbjojen — e dherat e gropat — e ajrin me rëkime — me thirrma e ksime... Me këtë entuzjazëm luftonin Arbëreshët, deri në kangjelin e tetë, në të cilin mbarohet lufta, e fituar nga luantë e Skandërbeut, ose nga të Biftë e Shqipjes! Turqit të vrarë qenë 22.000 (Kangj. 9, str. 120) e 2.000 të rrëmbyer robër (Kangj. 9 str. 109) dhe shumë të plagosur; të tjerët morën ikje të parregulltë. Për kundra të plagosurit Arbëreshë kanë qenë 400 (Kangj. 9, str. 128) dhe të vrarit 120! (Kangj. 9 str. 172).

Bilota ishte një njeri mendimtar, kuj i pëlqente thjeshtësia e Natyrës edhë e Popullit; përandaj, si psikolog i çquar, mendonte mbi Natyrën, mbi fenomenet e saj edhë vështronte e shënonë jetesën e popullit arbëresh. E kështu, si ndër të gjitha veprat e tija, edhë në «Shpatën e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» regjistroi një pjesë të madhe të folklorit arbëresh, aq sa unë nuk mund t'i shënonj këtë të gjithë pëershkrimet folkloristike; mjaf-tojnë disa. Poema fillon me skena të marrura nga natyra (Kangj. 1, str. 3): «Zoqzit ndëper degat — èmblih këndojen — me mallin që i velnej — zëmren; e kallzojen — te gjithë shokë mbjedhëshin — e bashkë mirë ndihëshin»... Dhe (në str. 5-7): «Qeneqezit e dele — shkallisjen ka vadhelet — e mënjanavet, veshur — e me lule ndërruer — si nata me ilez — vejen tue këcier — e bâ-bé bëjen — me golë që s'këndjen»... «Kuelt e Skanderbekut — dhe ingëlljen e bëjen — djallin, sa mënxi the — kalorit mund i mbajen. — Dojtë të skapërdhiksjen — ka enda i qindrisnej... Dhe (në str. 68): (Kalit Skanderbekut)... «S'j'arrënej — vore, që keqe fryn — ka malet e hapet — kadb e boret shtin —, e dhritë skandalisen — e rrushët xhakmisen.» Në kangjelin e V, str. 95-122, Bilota na paraqil një skenë folkloristike magjije, ku rrëfyhet se shpirti i Kalifit Ali, nga një mal magjepsen (merr syshi) Skanderbeun. Në kangjelin e tetë (str. 82-93) rrëfyhet një zakon, që akoma mbijeton, si magjia, në mes të popullit të Frasnitës, dhe që beson se shpirtrat e të vrarëvet, larg nga shtëpia e tyre, i çfaqen gjérivet me shëngje<sup>39</sup> e me zhurma, se t'i kallzojnë vdekjen e tyre të papritur. Në kangjelin e nëndërt (str. 14-18) kambanat e Krujës, të Dibrës edhë të gjithë Qishëvet t'Arbërisë, që bien me harë vetë, pas fitores, na kujtojnë rasodinë arbëreshe, e cila rrëfyen se kambanat e Shqipërisë kumbuan mbë vehte për vdekje kur vdiq Skanderbeu: «E llargu ndau — ndau — të Dibres këmboret — mbaharë u ndiejtin...»

I bukur është pëershkrimi i darkës shokërore të Skandërbeut me ushtarët e tij pas luftës (kangjel i nëndërt, str. 49-180): «Te Turqit ikjen, — Arbëreshët gjithë harë, — me gaset e gavnjisë — pranë gjithësëj — të ndreqtin, mbë tries — u ultin; me t'u — shqijen që ju vu — përpara e përtlipjen, — me verat nëndë vjec. — Mish demash e kaponjësh — ndërë taluret vec — gjithë hajen, të gëzuer — Tënzon tue bekuer...»

Gjat darkës rrëfyhen edhë ngjarjet e luftës, shëndërrohen urime edhë i jipet Besa Skandërbeut se të gjithë do të luftojnë për të reshtur Turqit nga Shqipëria. Shumë herë Bilota në kë-

<sup>39</sup> me shenja

të Poemë përmendon vallet arbërtshë, tue i përshkruar në kängjelin e parë, në të nëndëtin, në të dhjetëtin e në të dymbëdhjetëtin, si bëhen në Frasniti edhë ndër katundet arbëreshë. Por më i bukur përshkrim shikohet në kängjelin e dhjetë, ku Nderushi, fatos arbëresh (str. 60-82): «Enderrnej të gjëndeje — Krojë ka shpila Xhudhitës — e kët atjë vrenej — te sheshi të luenej — ndonjë valle vashash — hadhjare e hjembëdhë — çë bashkë gjithë këndoja — me sa hje ka — gola më e ëmbel...». Në kängjelin e dhjetë (str. 18-48) Nderushi i drejtton në Krujë Judhitës, nusës së tij, këngat lirike natësore, tue ja kënduar te qithara, bashkë me shokët ushtarë, ashtu si i këndoja edhë në Frasniti të rinxjtë arbëreshë nusevet të tyre natën: «E kuqez e e bardhë — si molla ti jé — të mirit e ëmbel — e molles ti kë — hjemadhe e mes — hollë, o e bukurez mollë!...»

Këta «vjersha malli» vazhdojnë edhë në kängjelin e XII (str. 103, 1-9): «Trima e vasha ndër qill vënë — hjet e vashës time mall — esht e bukur si do thonë, — vasha ime hjezë e gjallë. — Balla saj e bardhë si molla — zbukuronë nend këshën, — e kallzonë trutë e holla, — c'i nderojen vetëhenë...». Në kängjelin XI, pas shërbësës së varrimit të të vdekurvet arbëreshë, ushtarrët qajnë e vajtojnë shokët e tyre, që kanë ratur në lustë, përmbrojtjen e Atdheut. Shumë të bukur janë vajtimet (që nga strofa 109-115).

Pas vajtimevet (nga str. 117-215), Skandérbeu urdhëron të përsëriten lodrat rrëth varrevet, si në një kohë bënin Pelazgët, «çë Omeri këndon». Këto lodra më kohën e Bilotës akoma bëhëshin në Frasniti edhë ndër të gjithë katundet arbëreshë t'ITALISË, e Ai i përshkruan në veprën e tij «Zakonet e Frasnites». Në kängjelin XII (str. 107-177), pas shpërndarjes e plaçkavet, të rrëmbyera Turqvet, bëhet ndërryra triunfale e Skandérbeut edhe t'ushtrisë arbëreshe në Krujë, e cila na përmendon ndërryren që bëhet akoma në Frasniti, gjat tri ditvet të Pashkëvet, e që Bilota përshkruan nër «Zakonet e Frasnites».

#### GJUHA DHE GRAMATIKA NË VEPER.

Bilota, si nér të gjitha veprat e tija letrare, edhë në «Shpaten e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» përdor folmen e pastërt të Frasnites, e cila i afrohet shumë gjuhës shqipe të sotshme, përsa i përkret gramatikës, fonetikës dhe sintaksës. Por këtë dua të shënonj vetëm disa ndryshime ose karakteristika, që dallojnë Bilotën edhë folmen e Frasnites nga shqipja.

Shpesh herë ë-ja pazane, kur nuk është e theksuar, aq në rasat gjindore, dhanore, kallëzore edhë rrjedhore të njëjës, sa

në vijë a në fund të fjalës, shqiptohet «e» e shkurtër, p.sh. Fjales, fjalen, në vend të fjalës fjalën; zemer, këmboret, këndoja, ujet ose ujt, në vend të zémër, këmborët, këndoja, ujet etj. Përkundrazi «ë»-ja pazane shqiptohet kur është e theksuar, a kur formon një rrrokje, p.sh. është, bëra, përsita, vërvitem, ëmbel, tervitem etj.

Një karakteristikë gege e Bilotës është togu zanor ose diftongu uer, ueç, në vend të uar, uaç, p.sh. kënduer, muer, mërrueç, gëzueç, ne vend të kënduar, mërruaç, muar, (mori) gëzuac, etj.

Disa folja që mbarojnë me bashkëtingëllore në Bilotën, si edhë në Frasniti, në kohën e tanishme të mënyrës dëftore të vetës së parë, marrin shpesht -ënji, e cila shqiptohet -enji; p.sh. fol-enji, qepenji, ik-enji, fsheh-enji, dhez-enji, rrash-enji, vesh-enji etj. Disa folja të tjera, si në shqipen, nuk e marrin këtë shpesht, p.sh. dreth, marr, bier, tier, thërrres, prier, pres, siell, jap, dal djeg, njoh, thom etj.

Folja ka edhë të tjerë ndryshime, si në vetën e parë të shumsit, p.sh. bëmi, shomi, shkomi, marrmi, bjemi, yemi, etj. në vend të: bëjmë, shohim, shkojmë, marrim, blejmë, vemë etj.

Si edhë në vetën e trejtë të shumsit: bëjen, shohen, shkolen, marren, bjejen etj. në vend të: bëjnë, shohin, shkojnë, marrin, blejnë etj. Ashtu edhë në mënyrën dëftore të kohës së pakryer (imperfetto) ka ndryshim në vetën e tretë të njësits edhe në vetat e shumsit, p.sh.: shkonej, qanej, bënej, ecnej etj. në vend të shkonte, qante, bënte, ecte etj. Edhë shkojem (shkotim); skojet (shkojti), shkojen (shkojin) në vend të: shkonim, shkonit, shkonin.

Në mënyrën dëftore të kohës së pakryer të thjeshtë, disa folja marrin prapashtesën -ja, në vend të -va; p.sh. shkruajta ose shkruajta në vend të shkrova. Shumë herë në Bilotën si edhë në Frasniti nuk shqiptohet të-ja e mënyrës lidhore në vetën e parë të njësits e të shumsit e në vetën e tretë të shumsit, p.sh.: kam vete, kem vemi, kanë venë, në vend të: kam të vete, kem të vemi, kanë të venë. Përandaj unë në transkriptimin e tekstit të veprës kam venë një apostrof, kur Bilota nuk e shkruan të-jen; por edhë Ai shumë herë e vë apostrofin.

Për sa i përket alfabetit, bashkëtingëllorja «l» shqiptohet «lj»; të tjerat shqiptohen si në shqipen. Vetëm zanorja «y» e shqipes, si dihet, mungon në alfabetin arbëresh. Por nga ana tjetër hyn togu «hj» që shqiptohet si «x-ja» e alfabetit grek përpëra zanorevet e, i. p.sh. hje, hjidha, hjidhi, ahjak, ehjë etj.

Theksi që përdor Bilota është vetëm ai i rëndi (i fortë) (\*) (grave) p.sh. tha, là, nani, etj. Kur duhet theksi i mprehtë (') (acute) Bilota dyfishon zanoren, p.sh. gjili, shii, huu, heer, mooll

etj. Disa here dyfishon edhë bashkëtingëlloret kur këto atij i duken të forta, p.sh. dëmm, ggas, luffa, fjass, kanossii, pressmi, i liggu etj.

## LEKSIKU NË POEMË.

Leksiku i Bilotës nér të gjitha veprat poetike ësht ai i Frasnitës, por edhë i pasuruar nga fjalë arbëreshe të të tjera vjet katunde arbëreshe. Ai përdor edhë fjalë të Shën Mitrit, pse ka studjuar në kolegjin e Shën Adrianit edhë ka marrë fjalë nga shkrimet e De Radhës. Në qoftë se në «Shpatë e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» si edhë nér veprat e tjera ka ndonjë huazim, ky përdoret, qoftë përmungesën e fjalës në Arbërishten, qoftë përmërimën e vargut, qoftë përmënxitjen që Bilotë kishte nér të shkruarit. Për të lehtësuar kuptimin e leksikut nér tekstin e «Shpatës së Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» unë i kam prapaqitur. Veprës një fjalor të vogël, që mund quhet «fjalorthi i poemës», por përmënjë kuptim më të gjerë, lexuesi mund të përdorë «Fjalorin e Arbëreshvet t'italisë», që unë e kam botuar në vitin 1963.

## VARGJET E METRIKA NË POEMË.

Poema ësht e ndarë nér 12 kangleje e nér një tjetër kangel, që Bilotë e quan «Kangjel i vetëm», nér të cilin përshkruan një dyluftim që Skanderbeku pati në Adrianopol me një tartar të fortë, parë se të këthehej në Shqipëri. Kangjelet janë të përbërë prej strofash gjashtë vargjesh; vargu ësht i përbërë prej gjashtë rrokjesh dhe ndonjë herë prej shtatë rrokjesh. I pari dhe i treti varg të strofës nuk rimojnë, i dyti rimon me të katërtin dhe i pesti me të gjashtin. Rrall ndonjë herë rimat e këtyre vargjeve nuk janë plotësisht të kryera, por janë vetëm tingëlluese (associanti).

## TEKSTI DHE PËRMBAJTJA E POEMËS.

Si thashë nér Bibliografinë e Bilotës, teksti i «Shpatës së Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» përfshin afrë 10.000 vargje nér 13 kangleje. Por unë kam bërë një ekstrakt të vargjevet më të mirë, përmëtë botuar, dhe kam lënur vargjet të cilët i jepin një prolikositë të padobishëm argumenteve të ngjarjeve. E kështu vargjet të botuara janë afrë 8000. Tekstini original e kam tran-

skriptuar në alfabetin shqip modern. Kangjelet i kam paraqitur pastaj një përbajtje të shkurtër nér prozë, nér të cilën kam regjistruar edhë përbajtjen e vargjevet që nuk u kanë botuar.

## VLERA POETIKE DHE LETRARE E POEMËS.

Bilotë nér «Shpatë e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë», si edhë nér veprat e tjera, nuk na dëftohet nér të gjitha vargjet shumë i frymëzuar si një poet i madh; por vlera e veprës themelohet mbi ndjenjat e tij të thjeshta edhë ndër shprehjet popullore, të cilat po pëlqejnë edhë entuziazmojnë popullin. Figurat retorike, me gjithë se nuk janë të gjitha të shprehura nér një stil të lartë poetik, kanë po një gjallëri të madhe, pse janë të marrura nga realiteti i natyrës dhe nga jetesa e përditëshme e Popullit Arbëresh.

Kultura letrare klasike e moderne, përvoja e madhe e jetës, leksiku i kërkuar, gramatika e pastërt e folmes të Frasnitës dhe fantazia e pakufishme, sipo shihet nér cdo faqe të Poemës edhë të tjera vjet vepra të pabotuara, e shtojnë Bilotën nér radhën e poetëvet të kulturuar arbëreshë të shekullit tij.

Këta shënimë të shkurtër jepin një mendim të përgjithshëm mbi «Shpatë e Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» edhë mbi Binard Bilotën poet, por këndimi i kangjelet, edhë shënimet gjat tekstit do t'i jepin lexuesit dhe kritikëvet një njojje më të saktë të Veprës edhë t'Auktorit të saj; ashtu që edhë ata mund shprehin gjykimin e tyre të kërkuar mbi Veprën dhe mbi Auktorin e saj.

## DORËSHKRIMI I «SHPATËS SË SKANDERBEKUT NDE DIBRËT POSHTË» dhe i «KANGJELIT TË VETËM».

Si thashë nér Bibliografinë e Bilotës, «Shpata Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» ka 4 redaktime; unë kam zgjedhur të prasmin, pse ësht më i përpunuari edhë më i plotësuari. Ka edhë ndryshime midis këtyre redaktimeve, por ata nuk janë shumë të rëndësishme. Ky dorëshkrim përmban vejet 12 kanglejet, pa Kangjelin e vetëm, dhe ësht i vitit 1890, pse në fund të kangjelit IX Bilotë shënon datën 3.9.1890. As në fillim, as në fund të dorëshkrimit shënon të tjera data. Karta e dorëshkrimit ësht me vije katrore; fletat janë 21 cm. të gjera dhe 27 cm. të gjata. Teksti arbërisht ësht nga e majta, dhe përkthimi nér gjuhën italiane nga e djathta. Gërmat ose shkronjat janë shumë të qarta, si edhë grafia. Përkthimi nér gjuhën italiane, që fillon nga kangjeli

I parë, vazhdon deri në strofën 133 të kängjelit VII, pastaj fillon një tjatër herë në fillim të kängjelit IX deri në mbarim të dorëshkrimit, ose në kängjelin XII. Përkthimi në italishten i strofat vjet të papërkthyera mund lexohet në redaktimin e dytë të veprës të vitit 1888; ashtu që mund thomi se të gjithë 12 kängjlet e poemës janë të përkthyer në gjuhën italjane. Por botimi i përkthimit besova se nuk ishte i nevojshëm, pse mjaftojnë shënimet gjat tekstit edhe «Fjalorhi» që kam shtuar tekstit. Në kohën e ardhshme mund botohet edhe përkthimi në italishten.

«Kängjeli i vetëm» i përket redaktimit të veprës të vitit 1874, i cili redaktim ka këtë titull në faqen e parë: «Shpata Skanderbekut e shkruejtur ka Binard Bilotë Frasnjot ndë të paren e vjeshtit të vitit 1874.» Faqja e dytë është e pashkruar. Në faqen e tretë, parë se të fillonjë «Kängjeli i vetëm», lexohet: «Skanderbeku çë lefon me Tartarin mbrënda Adrianopull të Turqisë Kängjeli i vetëm.» Karta e këtij redaktimi është e bardhë, por e trashë. Fleta është 15 cm. e gjerë dhe 20 cm. e gjatë. Shkrimi është shumë i bukur dhe i qartë. Auktori ka shënuar vijat me plumç (laps). «Kängjeli i vetëm» përfshin 56 strofa gjashtë vargjesh, dhe gjashtë-shtatë rrokjesh, por nuk janë të numëruara nga Auktori, si edhë nuk janë të numëruara 20 faqet nér të cilat është i përbajtur Kängjeli i vetëm. Kängjeli i vetëm dhe 12 kängjlet të redaktimit të «Shpatës së Skanderbekut ndë Dibrët Poshtë» të vitit 1874 nuk janë të përkthyer në gjuhën italjane.

Në Veprën e botuar riprodhohen disa faqe të fotokopjuara të të dy redaktimevet, d.m.th.: të «Kängjelit të vetëm» të vitit 1874, dhe të 12 kängjelevet të vitit 1890.

Faqet e dorëshkrimit të veprës të vitit 1890 nuk janë të numëruara, por të gjitha janë 364. Faqja pas mbarimit të kängjelit të dyjtë është e pashkruar si edhë ajo pas mbarimit të kängjelit të katërt.

Dy tingëllimet që Bilotë deshi t'i paraqitëshin veprës i ka shkruejtur mbi disa fleta të veçanta. Të parit nuk i vë datë. Të dyjtit i vë datën «14 majit 1890».

#### P. EMANUIL JORDANI

• vijori si bota është e mënyrë, kemi disqitë, j'ezgjitet p=ë  
nështë s<sup>t</sup>  
u, o, ë, r, s, mënyrë, p=ë  
u, o, ë, r, s, mënyrë, p=ë  
• bota është e mënyrë, mënyrë, i mënyrë (t) (t=ë)  
sila) si a  
u, o, ë, r, s, mënyrë (t) (t=ë)

#### ALFABETI I POEMËS

Në fund të shekullit XIX alfabeti i Gjuhës sonë nuk ishte akoma i njësuar, përandaj edhë Bilotë përdori ndryshe alfabetëtë në të shkruarit Arbërishten, tue marrur gërmat nga latinish-tja. Unë do të shkruaj pas çdo gërmje të alfabetit, që Bilotë përdori në «Shpatën e Skandërbekut ndë Dibret Poshtë», gërmën përgjegjse t'alfabetit shqip modern, të cilin e kam përdorur edhë në transkriptimin e tekstit original.

a=a

b=b

c=c përpresa apostrofit; në fund të rrokjes; k përpresa a, o, u; përpresa bashkëtingëllores; përpresa c, ch të forta e ndan me një vijëz dhe e shqipton ç.

ch=k përpresa e, ë, i; në fund të rrokjes e të fjalës edhë përpresa bashkëtingëllores.

ci=c përpresa a, e, ë, o, u.

d=d

dh=dh

e=e

ë=ë

f=f

g=g përpresa a, o, u; xh përpresa i.

gg=g përpresa a, o, u; përpresa bashkëtingëllores dhe në fund të rrokjes dhe të fjalës.

gh=g përpresa a, e, ë, o, u.

gi=xh përpresa a, e, ë, o, u.

gj=gj përpresa i; përpresa bashkëtingëllores; në fund të rrokjes dhe të fjalës.

gji=gj përpresa a, e, ë, o, u.

h=h

hj=x greke përpresa i.

hji=x greke përpresa a, e, ë, o, u.

i=i

j=j

k=q pérpara i; shpesh herë pérpara e, ē; nē fund tē rrrokjes e  
 tē fjalës.  
 ki=q pérpara a, e, ē, o, u.  
 kj=q pérpara a, e, ē, i, o, u.  
 l=ll  
 lj=lj (1) pérpara i; pérpara bashkëtingëllores; nē fund tē rrrokjes  
 e tē fjalës.  
 lji=lj (1) pérpara a, e, ē, o, u.  
 m=m  
 n=n  
 nj=nj pérpara i; pérpara bashkëtingëllores; nē fund tē rrrokjes  
 e tē fjalës.  
 nji=nj pérpara a, e, ē, o, u.  
 o=o  
 p=p  
 q=k  
 r=r  
 rr=rr  
 s=s  
 sh=sh  
 sz=z  
 szg=zh  
 t=t  
 th=th  
 u=u  
 v=v  
 x=ks  
 z=c, x.  
 zz=x, c.

**Shënim:** Arbërishtja nuk e ka zanoren y, por ka tē thjeshtën i.

### TINGELLIM I

Bëra kët kangjelime se t'kallzonja  
 trutë e zëmren time tē fëshehtë...  
 S'munda u tē mbahsha' mos' thonja  
 çë ndienja e më zinej ndër zëmrët<sup>1</sup>,  
 M'i gjava u kanarit, kur shkruenja,  
 çë dha<sup>2</sup> si ndien ja zdreth e së rri qet,  
 i çeltë ka malli, kur zë lëng rrënja  
 e bari ngjallet tē nxjerë lule e fjetë.  
 E kështu më këndova Skandërbén<sup>3</sup>,  
 çë gjithë tē lashtit burra Arbreshë shkon  
 e s'janë, nè<sup>4</sup> pas atij si Ai më qenë.  
 Gjella e urtë<sup>5</sup> e e dashme e tij lulëzon  
 nga mot e gjithë sitë Ai me hjenë  
 mbi tē i têlq se burra dreq i bën.

Binard Bilota.

Tingëllim që ka tē paraqitet veprës epike:  
 -Shpata Skanderbekut ndë Dibret Poshtë-

- 
- 1) në zemrë
  - 2) mu, ashtu, pikërisht
  - 3) Skënderbeun
  - 4) as
  - 5) jetë e ditur

## TINGELLIM II

Kangjelimes time  
Mbi Shpaten e Skanderbekut.

Ti, Kangjelime Arbreshë, dil e shi<sup>6</sup> jetë,  
e ju buthtu, gjithë njerezvet me si.  
Mos u hëlmë ndë gjegjsh ti ndonjari  
çë shan tij, bilen time, si s'të nget.  
Mos u përgjegj gjuhëgalprit, çë të pret  
me të egra gërshërë, se s'ë njari  
me zëmer e me tru e me urtesi,  
po kavshë e dhjerë e lënë ka gjithë e shkretë.  
Mos m'u helmë ti fare, se ti kë  
me tij muà<sup>7</sup>, çë t'piksa e sa vëlen  
të di e më ndjet lulja me më hjé.  
Si ujet hjimez vete e prapë së vjen,  
shkasen gjuhëgalprat pa kujtim mbi dhë,  
te rron e zbukuron ti e pëlqen.

Binard Bilotë. 14' majit 1890.

## SHPATA SKANDERBEKUT

E shkruer ka

BINARD BILOTA

FRASNJOT

NDE TE PARËN E VJESHTIT<sup>8</sup>

TE VITIT 1874

6) shih

7) muà (\*muà\* — theksi është vënë mbi a-në, për metrikën)

8) e shtatorit

## SHPATA E SKËNDERBEKUT

ДОНОК СЈАНИД  
ТОГИСАЛТ  
\*ТИГИРИ И МИНАТ-ИГ ЛАИ  
ИГИ ТИГИТ БИ

## SKANDERBEKU ÇE LEFTON MF TARTARIN MBRENDA ADRIANOPULL TE TURQISE

### KANGJEL I VETEM

#### Përbajtja e KËNGËS SË VETME \*

Një ditë ju paraqit ushtrisë turke në Adrianopoje një tartar vigan, i cili pyeti turqit nëse kishte në mes të tyre një ushtar të guximshëm, që mund të luftonte me të. Asnjë ushtar turk s'u tregua i gatshëm, përvèç Skënderbeut, i cili kur e mori vesh, i tha Sulltan Muratit se do të luftonte ai me tartarin. Sultani ja pranoi dëshirën Skënderbeut. Tartari, i ftuar nga Skënderbeu i ra këtij me shpatë, por Skënderbeu ja priti duke i dhënë në të njëjtën kohë, një të shtyrë në gjoks me grusht. Humbi fuqinë Tartari, duke dalë nga sheshi i luftës. Si u përsërit luftimi, Tartari kërkoi të qëllonte një herë tjetër Skënderbeun me shpatë, por ky ja largoi goditjen dhe e vrau duke ja shpuar fytin me shpatën e vet.

Shumë gjësim patën turqit dhe e mbushën Skënderbeun me lule; edhe Sultani e nderoi më shumë, duke e hypur mbi qerrën e tij kur do të kthehej në Pallat.

1. Ju fuqì, më shpihi  
të sosni të këndoni  
Trinin Albëresh.  
Ju si m'u gell thoni  
me Tartarin çë vù  
përposh pra çë u zù

\*) Për të lehtësuar punën e lexuesit tonë në të kuptuarit e veprës, përbledhjet në krye të çdo këngë, të shkruara prej Emanuil Jordanit, u vunë në shqipen e sotme letrare. Po ashtu u vunë në shqipen e sotme edhe shënimet në fund të fases.

2. Ish Tartari një burr  
i lartë e i bushter:  
këtij i bëjen çcrë<sup>9</sup>  
gjithë Turqit — Një jushter  
s'ish ndër ta me të  
të dil t'e shi një e një.
3. E shihej i panderë  
mbreti<sup>10</sup> Amurat,  
çë ndonjë të shtinej  
t'e shih me të, gjat  
taksnej t'e nderonej...  
nengu këshfu e gjënej.
4. Ish Tartari me trëmbur,  
se ish mot e mot,  
aq çë ja popnej,  
çë si qen pa zot,  
vej shokë tue kërkuer  
me t'e shi<sup>11</sup> me duer.
5. E jushtrit<sup>12</sup> e Turqise  
i trëmbëshin!!! Ata jushter  
çë shtijen mbatanë dën  
drithmen, se të bushter  
gjithë dheu i kish xënë  
shumë qiqe tue bënë!!!
6. E turpja po të vrit  
rrrij mbretin Amurat:  
Thoj: popoh! gjindja ime,  
çë mundi me at' shpatë  
e vù<sup>13</sup> përposh çë disha,  
s'më ë si dojtë kisha!
7. S'gjendet 'më jarë<sup>14</sup>  
nani vetem një,  
çë stenet 'e shorë<sup>15</sup>  
me l'huejin!... me të  
çë kaq frimë suell  
ka dhethi<sup>16</sup> çë e puell.

8. O jushtrit e mil...  
Ku vatë?... po sa thoj  
me gjuhë e të shërtuer.  
Buzë ndëpër buzë shkoi  
të rrënet e ati' të huej  
jushtri e edhë çë duej<sup>17</sup>
9. Këshfu Skanderbeku  
erth çë më t'e xú...  
ki, çë nderoi Turqit  
ka do i qelli e u zú<sup>18</sup>  
me gjuhat e huej<sup>19</sup>,  
me Tartarin të duej...  
Sanënga e xú rrangarti  
si erë ka zot i mbret;  
e, zot, i tha: u jam  
çë dua të dal i vetë  
me t'velë atë t'e sho<sup>20</sup>:  
Jam u jushtri çë do.
10. Me Tartarin m'e shoh  
ndë se daflsh, o zot.  
Mprejt këtu zëmra,  
si maj ndonjater mot,  
ju cel mbëharë  
e i tha: ec, trim me hjé.
11. Ec, bir, çë të Asjes  
më dhë më se kisha:  
ndë pak mot nderë  
më bëre si të tisha  
ai it at, çë u (ni) të jam,  
se më se bir të kam;
12. së m'e nxier ka koca  
njari se më nderon  
ti sot mbi kët' huej:  
përpëra tij së rron  
më kë frimë-math,  
i bushter e i math.
13. Ec e pash nderë  
mbi të. U të ndronj  
ndrishe e më se taksa  
me valin. U bënji

9) i trembeshin

10) Bilita përdor të dy trajtai, si «mpreti» edhe «mbreti»

11) shihe

12) ushtarët

13) e vuri

14) të më japs

15) që mund të luftojë

16) nga dheu

17) që donte

18) dhe luftoi

19) me gjuhët e huaja, me popujt e huaj

20) ta shoh, të luftoj

- më nderë tij me hjé  
çë m'mbjove ma haré.
15. E, i bushtri gjithë-herashi,  
Skanderbeku u vesh  
këtuna<sup>21</sup> me shpaten:  
kështu vate m'shesh<sup>22</sup>  
te Tartari nd'at'ditë  
jushtrin rrrij e prit.
16. Gjithë Adrianopulli,  
kur xú se Albreshi vej<sup>23</sup>  
me Tartarin t'e shi<sup>24</sup>,  
rranga u hjoth e rrëmbei<sup>25</sup>  
gjithë lumin rrorrot  
si maj ndonjater mot.
17. U stros me mall e vate  
të vrenej atë ' zënë,  
çë si e zënë xhagandash  
ndë jetë' vej e thënë.  
E zotra e bulér  
e zonja nd'atë herë
18. shihëshin ka do ruhej  
rrolëmit rrorrot<sup>26</sup>  
piksur me gjindë Turqish.  
Mpreti i madhi zot  
të zo'men qerre lipi  
e bashkë me krerat hipi,
19. e ngjesni si ka lëmi  
kuelt, çë vanë si erë.  
Te pritej të shihej  
shurbesi jo më vrerë  
një<sup>27</sup> hjemadhi e ndëhet  
ndë vend çë ka të zëhet.
20. Si trim qeparis  
u buthtua me hjé:  
Gjithë Turqit' e vrejen  
u pruertin e vunë ré.  
Zëmrat ka sitë rucjen  
me mall, si t'e duejen:

21. E vëjen mbë kufi  
si të mund i dijen  
fân e asë ditje.  
Trimat shokët, çë i rrjen  
nën e çë ai qellnej,  
mbajen se gavnjenej.
22. Mbajen atë ditë  
për diten me më nderë,  
te burri Tartar bij,  
si i ardhur skundervjér<sup>28</sup>,  
ndomos se i bushter  
bënej për një ushter.
23. Ashtu mbanë Mbreti  
me krerat ' krahut 'ij<sup>29</sup>  
e më e shuma<sup>30</sup> pjesë  
e gjindjes çë e njij<sup>31</sup>,  
e më t'eshi' tërvit  
ka Tartari të ngit.
24. Kështu trimi ' hjeshem  
vej me zëmer-burr  
ka Tartari t'e shih:  
vej si nd'at'tamurr  
të dil me të të luenej,  
si me shokë çë dunej<sup>32</sup>.
25. E njo, tue ngarë, afrohej  
ka prit burri i math:  
ki prir sitë e vrëret  
si 'eger e frimë-math.  
Kur trimin përseksi  
krahët e tij shpjeksi
26. e shpaten për dòrezje  
zú me dorë e mbanëj:  
mjekës, ngau e shkau  
si gjakún t'i hanej.  
Kështu ndë mes të lëmit  
ngrënëj si vëllai 'dëmit.
27. Zgardhullonej sitë  
e i prir si të kanosej  
gjithve ka gjithë anat:  
ruenej si t'i strosej

21) këtu (me «na» eufonike)

22) në shesh

23) venë

24) shihte

25) shpajt u hodh dhe e rrëmbeu

26) rrëth lëmit

27) ja (arrin)

28) skundërvier («vjer» për të rimuar me «nderë»)

29) të tij

30) e shumta

31) e njihet

32) të luante, sikur shkonte në tingullin e daulles, me shokët që dounte.

- trimit me aq hjé  
me zbrahem si t'i thé<sup>33</sup>:
28. Horrját! çë së mate  
veshlat e tua, parë  
këtu të më vinje?  
Ti, kuj s'u mbulluzhár  
edhé mjekra me qime  
çë s'trëmbe hjesë' ime?
29. Ec, kori... Më ndjet keq  
të zë me tij të vëhem...  
bë' t'vinjë kush të nisi...  
Ndë se me tij zëhem  
të ndanj si guli  
e të lë' vrarë si dhi.
30. Kjo e folë trúsh<sup>34</sup>  
ka sitë i kallëzohej,  
sa ca Skanderbekun  
lipisjen, si t'i vrëhej  
gjella nd'atë herë  
çë vej të bënej nderë...
31. Trimi tërvit errù  
te i hueji ashtu rrrij  
ndë mest sa krera  
Turqia gjindësh kij<sup>35</sup>:  
Te fare i bënej çerë  
kështu zú nd'at'herë:
32. Tartar, mos të ndjésë<sup>36</sup>  
se s'ësht kush të vëhet  
me tij ndë ktë dhë?
33. U, çë s'të renj, të marr  
me shpaten ata krie,  
çë mban si pipë. Mbjatu  
ví zë<sup>37</sup> me mua e matu.
34. I hueji pruer e e vreti  
e bëri si doj' qeshnej  
mbi fjalat e trimit:  
E pér se i ndit'e gjegjnej,  
si trim çë s'ka tru  
e do përzënë me at' hú,

35. i foli e tha: me ec, kori!!...  
te jé të dalsh ka vea  
vjen me mua të hilqesh?  
Me nj'burr, e kuj hjea  
trëmben ata ndë pisët  
si pika çë djek lisët?
36. Ec, kori,... ruej të rroq<sup>38</sup>  
edhé më gjë mot...  
ruhu të mos ' shtihesh  
më s'llavur e çot...  
hap sitë' njojësh mirë  
me k'vëhe.. Me ec, bir...
37. Këtu Skanderbekut  
ju hiptin më e i thot:  
ki ë zgarrùn çë more  
kur fole si burr çot,  
më se frimë-math... Mbjatu  
një, ndë te bën, ze e matu  
e ruhu o të vrás...
38. Eshi... E i mati shpaten.  
Kështu i nxilosur  
Tartari lart ngjaten  
krahun e shpaten shkulen.  
E njo te të di sulen
39. eger, i hueji bëri  
një të keqe çerë,  
sa gjaku gjithve u mbi,  
si dekjen' kishen vrerë,  
çë mbi trimin ngrënëj  
draprin t'e rrungonej.
40. Gjindjes nditë keq<sup>39</sup>  
pér trimin aq hjemath,  
çë Fani nderoi.  
Fani, sa qelli i math,  
një shpatez i shënoi  
te krahu djathët e e rrëzoi
41. këtuna ndër burrat  
të dritnej me nderë.  
Tek Tartari i ngulnej  
shpaten me dl duer  
të ndanej, trimi shpaten  
prapë i pruer me qaten

33) t'i thotë

34) në mendje, me vehte

35) kishtë

36) të duket

37) po fillo

38) i vinte keq

42. e shpatës<sup>39</sup> 'krahut tij  
e i jé<sup>40</sup> një té shtimë  
me grushtin mbë sisë.  
I muer forë e frimë  
me grushtin çë i nguli  
fort si malë shuli.
43. U reks e u babár  
i hueji çë u pataks  
e duell ka shëngji tij.  
Turqia u haraks  
e qeshi, tek Albreshi  
zú vithëzit e i ngjeshi!.....
44. Me gas té math qeshjen  
gjithë Turqit, e qeshnej  
Mbreti nd'at'me qeshur  
vrer, te ja veshnej<sup>41</sup>  
Tartari çë runej  
ka mund'te pështonej.
45. Nd'at'vruitim gasesh,  
çë Turqit lëshojen  
ashtu grikë-haptra,  
sa qiell e dhé gjimojen,  
pra, çë tri herë rrortartur  
lémin, si i kakartur,
46. Tartari, qindroi,  
e, te më s'pritej,  
çerë-eger më u bë  
e dishë<sup>42</sup> té prëtërtej  
lufa nd'atë jushter  
me trimin e bushter,  
çë ashtu e tirmosi.
47. E, sa nënga u pruer,  
shpaten cë kish ngrëjtur  
i uli me dì duer,  
papá me trú t'e bënoj  
di copa e t'e lönej.
48. Trimë tèrvit ja pruer  
e ehjen dreq ja sùell  
te gërraci e arrëzen  
i preu e bën e vuell  
gjellen e tij: sa rá  
mbë truell rëndë si ká

39) me anën e gjerë té shpatës

40) I jep

41) ndërsa ikte

42) dhe deshi

et Taranderberu ciy

glef-lor me Tarlarin  
m Brynda Adriana  
put ty Turkiis

¶ Cangghielha

Iu fukii, my shpizhi  
Ty sosni ly cindoni  
Trimin Aglybreshi  
Iu si m'uked Doni  
Me Tarlarin ciy vuu  
Pyryosh jm ciy usuu  
Ish Tarlari gny burri  
Agliart e bushter  
Cytuij ibijen eer  
Aglaq Turkil-Gny juster  
Ish ordyr ta më ty  
Ty dith l'esci gnyegnij

Ngau te jolneia sli già;  
 Te mòreh magy ndeer  
 Byri trimi t' Alka-bresh  
 Jyse at dil edesh  
 Maajtur jiry ty diel  
 Ca ggħid; e vixi e desh  
 Jyv darsymin ty vrax.  
 Nader ecath, ci j' chest  
 Trimi, chett zimbernej  
 Nalogu, ci j' eżigħiss-nej.  
 o Epixxuera ty cluji  
 Carroġġieglei o

49. zu boten lēmit,  
 e vruitim u ndie  
 erret e keq, si kur  
 njé lis i prerē bie.  
 Tue vrerē atē tē rarē<sup>43</sup>  
 burri, ka trimi i vrarē,  
 qeshi gjithē Turqia  
 e therriti me gjithē golē.  
 Ndér fjalat cē thoj,  
 ndihej vetē kjo e folē:  
 Rroftit me shēndetē  
 i bushtri shumē eti!  
 50. Tē fala! mē me għiex  
 tē fortē, shokēt i thojen.  
 me kēto thirma harésh  
 malet rrukullojen  
 rrot atij tē vrari,  
 i mosnjariu i qarē...

E fērnuerā tē kētij  
kangjeli.

43) tē rēnō

## SHPATA SKANDERBEKUT NDË DIBRËT POSHTË<sup>44)</sup>

44) Ky është i pari luftim, që Skënderbeu me ushtrinë arbëreshe pati me ushtrinë turke. Si rrëfijnë historianët, Barleti e Antivariti, lufta u zhvillua më 29 qershor të vitit 1444, ndër sheshet e Dibrës së Poshtme. Por Antivariti thotë me saktësi, se lufta u zhvillua në Torvioll, katund i vogël, që gjendej ende në Dibrën e Poshtme, edhe se turqit ishin 25.000, në vend të 40.000-vet për të cilën bëjnë fjalë Barleti dho Bilota. Rrjeshtimi i ushtrisë arbëreshe, si e caktion Bilota, është pak i ndryshëm, sepse Barleti dhe Antivariti thonë që trupat e pritjes ishin nën urdhërin e Kont Uranës dhe të Marin Spanoit, edhe që 3000 ushtare kalorës ishin nën urdhërin e Hamzë Kastriotit, ndërsa Bilota përkundrazi, thotë se trupat e pritjes ishin nën Lekë Dushmanin e kërçë të tjerë, e se 3000 këmbësorë e kalorës të Ishchur ishin nën urdhërin e Moisi Golemit e të Pjetër Spanoit.

# SHPATA SKYMDERBEKUT MDGE DIBRËT POSHTË

Det e dëshirja që shpata e këndohet me poshtë. Ishte i dëshirë që tashmë  
vend e vullt që shpata e këndohet me poshtë. Nëpër 3000 kalorë e  
7000 këmbësorë. Skënderbeu e rreshton atë, duke urdhëruar Arianit Kom-  
nenin dhe Kont Uranin të luftojnë afér tij, i pari nga e majta  
e i dyti nga e djathta, në mes të radhitjes ushtarake. Pali e  
Kolë Dukagjini, vëllezër dhe zotër të brigjeve të Drinit, kanë  
urdhër nga Skënderbeu të luftojnë nga e djathta; Lekë Zaharia  
(i zoti i Danjës) — nga e majta. Stefan Cernoviçi, princ i Malit  
të Zi, do të formojë praparojën e djathtë të Skënderbeut; Lekë  
Dushmani me të tjerë zotërinj arbëreshë do të formojnë prapa-  
rojën e krahut të majtë të Skënderbeut. Moisi Golemi dhe  
Pjetër Spanoi, zot i Drivastit, fis i Theodhosit të Madh, do të  
fshihen te pylli me 3000 kalorë e këmbësorë që të sulmojnë  
ushtrinë turke nga prapa. Skënderbeu, me të nipin Hamzë  
Kastriotin, me të tjerë krerë arbëreshë dhe me Andre Topinë,  
do të përballojë ushtrinë turke në mes të së parës aradhë.

## KANGJELI I PARE

### Përbajtja e KËNGËS SË PARE

Që në mëngjez Skënderbeu në Dibrën e Poshtme kontro-  
llon ushtrinë e tij, e cila përbëhet nga 8000 ushtarë kalorës e  
7000 këmbësorë.

Skënderbeu e rreshton atë, duke urdhëruar Arianit Kom-  
nenin dhe Kont Uranin të luftojnë afér tij, i pari nga e majta  
e i dyti nga e djathta, në mes të radhitjes ushtarake. Pali e  
Kolë Dukagjini, vëllezër dhe zotër të brigjeve të Drinit, kanë  
urdhër nga Skënderbeu të luftojnë nga e djathta; Lekë Zaharia  
(i zoti i Danjës) — nga e majta. Stefan Cernoviçi, princ i Malit  
të Zi, do të formojë praparojën e djathtë të Skënderbeut; Lekë  
Dushmani me të tjerë zotërinj arbëreshë do të formojnë prapa-  
rojën e krahut të majtë të Skënderbeut. Moisi Golemi dhe  
Pjetër Spanoi, zot i Drivastit, fis i Theodhosit të Madh, do të  
fshihen te pylli me 3000 kalorë e këmbësorë që të sulmojnë  
ushtrinë turke nga prapa. Skënderbeu, me të nipin Hamzë  
Kastriotin, me të tjerë krerë arbëreshë dhe me Andre Topinë,  
do të përballojë ushtrinë turke në mes të së parës aradhë.

1. Dihej ditë e bardhë  
ndër sheshet e Dibrësë<sup>45</sup>:  
Të falnej Arbëreshët  
me diellin gjellë e hjesë,  
çë jeten zbururon  
e t'mirat i mburon.
2. Ajò llambardhosnej<sup>46</sup>  
me gas e me harë:  
e bukur të ngjallnej  
çëdo kish ki dhë!  
Të gjallit rrëfiejen  
harezen çë ndiejen.

45) Theksohet Dibrësë për të rimuar me të katiertin varg: hjesë

46) gëzonte

3. Zogxit ndëpër degat  
ëmbëllith këndoja  
me mallin, çë i velnej  
zëmren: e kallzojen  
te gjithë shokë mbjithshin  
e bashkë mirë ndihshin,
4. si vashat ndonjë valle  
me oreks nd'atë herë,  
edhë këtë zdridhjen  
graxetazit tue luë<sup>47</sup>,  
e trimavct këndoja,  
vatur t'i nderojen<sup>48</sup>
5. nënd Skanderbekun,  
krie, çë shkëlqenej  
mbi sa burra ahiera  
jeta me dritë vrenej.  
Qenqezit e dolet  
shkafisjen ka vadhelet<sup>49</sup>
6. e mënjanavet, veshur  
e me lule ndërruer,  
si nata me ilez,  
vejen tue këcier  
e ba-bé bëjen  
me golë çë skëndjen<sup>50</sup>.
7. Kuelt e Skanderbekut  
dhe ingëlljen e bëjen  
Djallin!... Samënxithe  
kalorit mund i mbajen!...  
Doj't' skaperdhisjen  
ka ënda i qindrisnej... .
8. Me ta edhë kalorit  
e axatrat ndë shesht  
'Dibres s'do' t'prisjen  
më me ehjat veshtë<sup>51</sup>:  
Ënda i haj të strosshin  
si ka Turqit ndothshin.

47) këngë dy vallesh grash (Shiko edhe «Fjalorin e Arbëreshvet t'Italise»)

48) të cilët kishin shkuar t'i nderonin

49) dilnin nga dyert e vathave

50) me zë që nuk ta ka ënda, që nuk të pëlqen

51) veshur

9. Doj't'vën t'i tirmosjen<sup>52</sup>  
ndër malet e Asisë...  
I mbanej e mirr mot,  
si bir i urtësisë  
të qellej nd'atë ditë,  
Skanderbeku i ngritet.
10. Mirr mot ' vej kuft<sup>53</sup>  
ku kish përlufosej:  
çë udhje me kalorit  
Turkut kish ' strosej:  
Ndë ç'vend shokët axatu  
kish ' shtinej pra o mbjatu.
11. Pra çë mbaru vreti  
e shkoi mirë sheshet  
ku lufa kish ' celej,  
bëri kriq e i veshet  
si pikë këcen kaluer  
kalit, e ndër duer
12. ndën shpaten. Me diellin  
kjo, si ill me bishtin<sup>54</sup>,  
të shkepnej, Zú e tha:  
.
24. Gjegini, prematjotë,  
e ndreqi të strosemi  
Turqvet, si lliunra  
se t'i fanarosemi,  
t'i shprishimi, t'i llargomi  
çë kanë t'i kallom.
25. Jemi ndë ditt'lusur  
e çë me mua dojet!...  
Kur mua ndë dhët turk  
shkronjet taj dirgojet,  
diovasja e s'fjisja  
e lutja ' mos'vdisja
26. si vëllezrit e mi,  
prana bët' ' shijet<sup>55</sup>,  
kur të piqej hera  
si ju mund shtijet  
Turkun ka bazuli,  
mbi ku djalli e uli...

52) donin të venin t'i sulmonin

53) ruante dhe mendonte

54) yll me bisht, kometië

55) pastaj do t'ju bëja të shihnit

27. Gjithë puthmi kët herë  
çë ka të na nderonjë!...  
Dishruem kët ditë,  
çë ka të na mburonjë  
Besen, hjëne e gjillën,  
çë të mirat pjellen!...
28. «Kem puthmi kët herë!»  
Gjithë zunë e thojen  
këtu e banderat  
krah-qifte<sup>56</sup> të luejen  
e thërrisjen: «kët herë  
kem' puthmi si nj' ndërë.»
29. Te kështu thojen,<sup>57</sup> gjithë  
krerat shkuljen shpaten  
e me dërti ja ndëjen  
Zotit. Më ngjaten  
Komneni e i thot:  
Zà m'e mirr, o zot.
30. Ti, më hjemadhi  
e 'bushtri ktij moti,  
mirre e si do prirme<sup>58</sup>  
nd'ëmrit Tënzoti,  
krahut dritë ' m'i bënë  
e ëmrin ' më nderonjë.
31. Mirre!... E Skanderbeku  
me harë t'i muer  
shpaten e ja puthi.  
Sânënga ja pruer  
e i tha: «Komnë, zà». Komneni pruer e tha:
32. Zot, na ndërë Kriqes  
e leftherizes tënë  
dom' bëmi: ka gjiritë  
pakzuer ka t'jetë thënë,  
se vrarë o kriepërë  
na duemi besë e ndërë.
33. Eh, na këto duemi  
dha si i qellmi shkruer  
ndër shpatat e nisanat,  
çë ndëmi tue luer  
me zëmer burri t'bushter  
gjithë shokë ndë k't ushter.
34. Këtij Skanderbeku  
tha: Arjanit, më-rrueç<sup>59</sup>:  
ndë krahut tim sot  
bën qiqe sa të dueç,  
e Turkun, çë kalosh  
na rrí, vë përposh.
35. Mbanë meje u të dua  
me trimat shokë klorë:  
me kta të paren herë  
na kem gavnjemi dorë  
Turqvet, çë janë  
ndë trakulatë mbatanë.
36. Sa kështu gjegj, putni  
shpanë, çë zoti i pruer,  
e mënjanë me kalin  
duell e kcej kaluer,  
e ngrëjturëz ndonj' anë  
si draper Dekje e mban.
37. I ditë Dukagjini  
Si Arjaniti duell,  
e shpaten me dërti  
Skanderbekut suell  
e i tha; thom çë tha  
Arjaniti e zà.
38. Ti kumandona, zot,  
e qellna si të dueç.  
Me tij mbami e vemi  
me chjat ka të thueç.  
Ka do t'agutiksenj  
kuelt ' skaperdhiksenj?
39. Zoti Dukagjinit  
dorarten shpatë i pruer,  
prana çë ja puthi.  
Ai Dukagjini e muer  
me mall e hje e e mban  
me kalin mënjanë
40. e gjegji Zotin-math,  
çë kështu merr e i thot:  
më-rrueç, o Dukagjin,  
ti Zoti Driniot:  
Dimilet shokë kalorë  
më qell e ze me forë

56) me krahë si të sqifterit

57) ndërsa kështu thosnin

58) kthema

41. Alin si ka e djathta  
e Dibres kur tē çelet  
lufa. Mbë-të-katra  
vér kuelt e me hèlet  
e tú shprish e shpo  
Turqit si më do.
42. Sa gjegji Drinjoti  
shpaten, çë ju pruer,  
me mall e haré puthi:  
kcej si pikë kaluer  
e antezit përsiti  
e tha: ju shokë, terviti
43. té bëmi nderë. Prana  
u nis e agotksi  
dreq ka e djathta Dibres.  
Kalin skaperdhiksi  
pér krei-gjithë: si era  
malit vej karrera
44. llajëza tij kalorë  
me trutë bënej qiqe  
pér hjenë e Katundit
- .....
46. Shokët e Skanderbeku  
i kishen po haré,  
e prisjen shumë qiqe  
ka ajò kuelsh llajé,  
çë mbë-të-katra haj  
udhen shnuer asaj.
47. Te rucjen giithë hunduer<sup>60</sup>,  
merr Leka Xakari  
e i tretë Skanderbekut  
i ndën me dërti  
shpaten e t'i thot:  
Zà, t'agotiksem, zot.
48. Dua tē bënj nderë...  
Bulari math me hjé  
shpaten Lekës muer.  
Ja puthen e ja jé<sup>61</sup>,  
tue thënë: Lekë i bushter,  
zite tënden ushter

<sup>60</sup>) tē çuditur, tē habitur  
<sup>61</sup>) ju jep

49. kalarish ka jatr' anë  
e Dibres, tē rrëmbemi  
Turqit anembanë  
t'i shprishmi, t'i biëmi<sup>62</sup>  
si i ngët me kto shpata,  
hèle e rrongë tē gjata.
50. Leka shpaten puthi,  
bëri kriq e u kriár  
udhes qënë buthtuer.
- .....
51. . . . . I katër  
këtuna malsjoti  
Stefan Cernoviqi  
me dërti ka zoti  
erth<sup>63</sup> e i vu ndër duer  
shpaten e ndërruer
52. me sqithra ari e çika  
rëgjendje ndë mérut:  
E, zot, i tha, axatrat  
me thikazit mbi hûtë<sup>64</sup>  
ka të triqimisenj,  
Turqit ' sparrangjisenj?
53. Buzë-mbë-gaz zoti,  
çë qeshnej ndonj'herë,  
çë rrij nxé me trutë<sup>65</sup>,  
pra çë i puthi, i pruer  
shpaten e qindisur  
e pér fare ' grisur,
54. e i tha: Ti, Malsjoti  
Cernoviq, më zdridhu  
me gjiritë axatra  
ka e djathta ime e hjidhu  
Turkut si stravatoi  
timbabet mbi ku çoi
55. dhelprep e magartur  
çë zoqzit i hënger:  
bjeri e caji cerën  
Atij, çë kto zëmer<sup>66</sup>  
na theren lka mot  
e shkelcn si botë.

<sup>62</sup>) t'u biem («t'i biëmi» — pér tē rimuar me «rrëmbimi»)  
<sup>63</sup>) erdhë  
<sup>64</sup>) mbi hunjtë («mbi hûtë» — pér tē rimuar me «mérut»)  
<sup>65</sup>) kur rrinte i zhystur në mendime  
<sup>66</sup>) këto zemra

56. Zitul... Cernoviql,  
pra çë parë-më-parë,  
shpaten e prierrë puthi,  
bëri kriq, tue ngarë  
udhes qënë shënuer  
ka zoti ' dritësuer.

57. Vej me llajenë e tij  
e gjitej një dushqë  
thikësh<sup>67</sup>, që shkëlgenej  
mbalë drunjivet. Njenjë  
ngit si e shtijturi  
ka ajret tue fritjur.

58. Këtu Lekë Dusmani  
i pestith me dërti  
shpaten zotit ndén  
e thot: kta gjiri  
axatra e kalorë  
ka të shtinjë me forë,

59. ti bie qenit turq?  
Shpaten zoti muer:  
me mall e harë ' puthi.

Mbjatu, te ja pruer,  
i tha: Dusmë, Turkut  
ngjudhirju si ulkut

60. ka jatri krah imi,  
pas Xakarisë.  
U mesarén' e lufës  
mbanj. Shokë gjiriz,  
dua t'jem ndrë t'paret,  
ç'i shkrehem ndë ballet

61. mixorvet, Dusmani  
bëri kriq e u kriar,  
pra çë shpaten puthi.  
Axatrat par-më-parë  
nisi pa të 'rrëjtur  
me banderat ngrëjtur.

62. Kalëria pas atire  
trollit bën e bij.  
Kështu ndrequr foli  
zoti shokvet tij:

63. Me mua, shokë kalorë,  
ksaj udhje rrangarmi  
të bushter, e me forë.

<sup>67</sup> dhe i ngjante një pylli thikësh

Turqit vem'e ngurmë,  
bë'ti ngjethet kurmi.  
64. Mosë Gollemi edhë  
del ndër krahë e i bie.

Ju dini sa vëlen  
ki jatri shok krie!  
Çë-djë u dushkua,  
se gjegjet bën mua.

65. Lefton zoti Pjeter  
me të!... Eh çë e qami!  
Ndëkt ditë<sup>68</sup> u mbanj  
se Turkut britë çami,  
e atë çë pështojen  
dridhur na kujtojen.

<sup>68</sup> mos të trembemi në këtë ditë.

## KANGJELI I DIJTE

### Përbajtja e KENGES SË DYTE

I keqi Ali Pasha, në krye të 40.000-vet ushtarë turq, që në mëngjëz herët, rrjeshton ushtrinë e tij përballë ushtrisë arbëreshe.

Këtu rrëfehet lindja e mrekullishme e Skënderbeut, trimëria e tij dhe luftërat e tij në Azi, kur ishte në Adrianopojë me Sultan Muratin, që e mbante si bir. (str. 1-27).

Rrjeshtimi i ushtrisë turke ishte ky: Uxuni, heroi turk në luftërat kundër Qiliqisë, me ushtarë kalorë do të mbante të djathtën e Dibrës; nga ana tjeter do të vihej Adhramani, heroi kundër Misisë; gjashtë orë larg nga rrjeshtimi ushtarët do të rrinte praparoja e Aliut, në krye Abuxhafarin, që kishte luftuar si i tërbuar kundër hungarezëve, duke u sjellë shtazërisht. Të tjerë gjeneralë turq ishin Manxurri, Buxku dhe Aqburri. (str. 28-37).

Muhamenti profet, kur pa se Skënderbeu ishte kthyer në Arbëri ta çlronte nga pushtimi turk, kishte dalë nga Ferri së bashku me Abubekrin, të vjehrrin dhe me gjithë shpirrat e atyre, që kishin qenë mbrojtësit e fesë së tij, për t'i frymëzuar, duke i nxitur ushtarët turq kundër arbëreshëvet. (str. 38-62). Muhamenti kishte shkuar edhe në Adrianopojë, duke nxitur Sultan Muratin edhe, duke e këshilluar të mblidhët gjithë kërët ushtarët me ushtritë e tyre, t'i hidhët kundër Arbërisë, e cila ishte rreziku më i madh përfenë muhamedancët dhe Perandorinë turke. (str. 63-72). Murati, i quajtur Feta, që do të thotë «pushtues ngadhnjimtar», dëgjoi këshillën e Muhamentit dhe mblohti një ushtri të madhe, në krye të së cilës vuri Ali Pashën. (str. 72-73). Arbëreshët, kur morën vesh se kjo ushtri e tmerrshme turqish po vinte në Arbëri, u trembën shumë e i lypën ndihmë Perëndisë, Shën Mërisë dhe Shën Kollit. Atëherë kishat e Arbërisë mbetën hapur ditë e natë edhe priftërinjtë këshillonin e porosinë besimtarët arbëreshë të luftonin me guxim, si arbëreshë

e të krishterë të vërtetë, përmbrojtjen e fesë dhe të Atdheut të tyre. (str. 77-97). Edhe Skënderbeu kalon katund më katund, duke i dhënë guxim popullit. Ndërkohë arbëreshët punonin, duke hapur gropë apo duke shkrirë shatet e plugjet për t'i shndërruar në shpata e thika; kush mësohej të luftonte, kush të shkonte me kalë a të përdorte shpatën. Të gjithë të rinjtë e shëndoshë shkonin të bashkoheshin me ushtrinë e Skënderbeut, i cili të gjatët i bënte kalorës dhe të trashët këmbësorë; të martuarit i linte ndër katunde për të mbrojtur pleqtë, gratë, të vegjelit dhe kafshët e buta nga të liqtë. Kur Ai e preqit kështu popullin dhe ushtrinë, u nis kundër turqve, mbi të cilët korbat fluturonin re-re qysh prej shumë ditësh, se mbi ta ndjenin «vdekjen, çë me mish-i ndëndnej si kulish». (str. 98-115).

1. I keqi Alli Pasha,  
krie pjak i bushter<sup>69</sup>,  
dizetmili shokë,  
të zgjedhuriz jushter,  
me ndriçur rrëcëdhoi<sup>70</sup>  
e ndreqi e rrëzzi.
2. me zakon<sup>71</sup> e pjeqvet  
ai nisi cilorë  
të lufes axatrat.  
Kush i jijen forë<sup>72</sup>  
ishen Manxurri,  
Buxku e Aqburri.
3. Ktq. krera më ndihshin  
ndër lufat t'egersuar;  
me zjarrin e thiken,  
si e keqja e shtëluar,  
katundevet i sulshin  
tharet e i ngulshin.
4. Të tre helmorë  
të Misjes asi moti  
njonë me një anet<sup>73</sup>  
përnjë me hix zoti,  
Arbreshët ' helmojen  
me dëmet çë bëjen.

69) i fuqishëm

70) me të gdhirë i bëri gati

71) me zakonin

72) i jipnë fuqit

73) arritën me një rresht

5. Alliu i kish haré  
e i mbanej po shtrejt,  
pér se me Skanderbén<sup>74</sup>  
një villjat shokë,  
nd' Asjet kín qenë<sup>75</sup>  
e bashkë qiqe bënë.  
6. Dhe pér se atà dijen  
gjaegjë<sup>76</sup> si mirr foren  
Albreshi, dreq prit<sup>77</sup>  
Allu të mirr doren,  
çë kish sinodhi  
Vashë hjenë Gavnji.  
7. Kjo s'e lëj ngëmshtit  
'bët'vej kalosh  
kuj doj vith liqen.  
Prit Alliu përposh  
Fatostin të vënej,  
kë Gavnjia ruenej!...  
8. Kjo si bir e doj.  
se çë te barku ëmes  
Voisavë gaidhjare,  
me mallin e zëmres  
saj ngjallti e veshi  
me shpán, c'ajò keshi<sup>78</sup>  
9. Me kët djali krahun  
e djathtë ndërruer  
bukur ka ajò Fatë,  
kur gati t'ish lerë,  
lahones ëmë si hjé,  
çë s'nxçnej ki dhé<sup>79</sup>,  
10. mbë t'ënderr u fjandas  
i lerë e t'e reksi;  
drithma e pataksi  
e gjin i harepsi  
kur dita dihej,  
herë çë kish ' lehej.

74) Skënderbeun

75) në Azi kishin qenë

76) ndonjë gjë

77) priste, shpresonte

78) kishte

79) që s'e kapte ky dhé

11. Mëma mpretëreshë,  
kur gjegjinej zënë fill  
Turqit rrimaksem,  
të losej si dillë...  
Qanej me hjidhi  
ture vënë kufti  
12. si rëndë i mëshojen  
gjirivet ' kërshtorë.  
Mandaj sa shërtonej  
ngaçik një të lerë<sup>80</sup>,  
çë'drit<sup>81</sup> me fuqi  
shumë e urtësi.  
13. I Larti, çë merr vesh  
këdo mirë i lipen,  
e, sikuforma ë posht,  
lart bën e hipen,  
Voisaven gajdhjare  
e zëmer lipisjare  
14. gjegji e nderoi;  
se at' grua me hjë  
ëmë bëri asi burri,  
çë vrer qe mbi dhë<sup>82</sup>,  
te<sup>83</sup> krahu s'i lodhej  
me shpaten ku ndodhej  
të mirr liqen, kuj  
së shtrëmburi ja muer,  
e i këndnej' ja mbanej  
si petk të kalluer;  
me të ai leftonej  
njera të mbjonej  
16. eten e liq's tij.  
Vdekje e pandëndur  
gjellash kështu dukej  
nd'ato lufa, tue ndëndur  
shpaten, çë të shkrepnej  
mbi armiqtë i shkrepnej,  
17. vrerin, çë mirosen.  
Kështu ' paren herë  
ka ana tire Turqit  
e vrénë<sup>84</sup> trim me ndërë,

80) një bir

81) që ndriste

82) i cili qe një çudi mbi dhë

83) ndërsa

84) e vunë re

- kur rrishin me nj' mbret  
ciliç,<sup>85)</sup> çë s'i mbet  
18. néné<sup>86)</sup>, se t'i dheksi  
të išh ngjerosk vëtë.  
Ahiera krahу tij  
dhe Turqvet shëndetë  
sa, pra çë përmistin  
Çiliçin e e rrëzbistin
19. papá ndë vendt tij,  
gjithë shokët e kënduen  
përpara Amuratit,  
çë si bir e ruen  
e si më të bushter.  
Mandaj me nj'ushter
20. pesëmlesh e nisi  
ahiera' paren herë.  
Këtuna si xú  
se trimi i bënej nderë,  
dishë papá t'e nisnej  
të vej t'i përmisnej
21. më ca zotra t'Asjes,  
çë s'dojen të rrijen  
al t'i ij ngjerosk<sup>87)</sup>:  
Vate e çë s'dijen  
xunë si sinodhi  
kish Faten Gavnji,
22. c'i vej vithe kalit  
kado bij mbë shpor.  
Me kët Asjotvet  
al rá me forë  
e vú gjithë përposh  
me Feten<sup>88)</sup> kalosh.
23. Ai kët edhë gjetk  
ahiera sheshroi  
nd'Asjet. E' bushtrin,  
çë trim dhén mbjoi  
me èmbrin e nderuer  
e bukurith ndërruer,
24. me sa kurora pati  
mbi zotra aqë e mpretra:  
'bushtrin Arbresh.

- Ka njera anë e jetra  
Allu me kalërinë  
prit' zëj si min  
25. ndë pjasët vërngutur,  
pra çë e nxilosnej  
me sá axatra shtinej  
mbëhundë ja strosnej  
mesaresë, çë mbanej!...  
Jò!... së ja gëxarnej
26. thanen gjithë siut,  
çë mbë rahj e ruenej  
ka ditë e kalërinë  
hapur i dirgonej,  
si pamë, si ndë thest  
t'e kallnej ndë mest.
27. Alliu s'ish njariu  
çë mbahej... Arbreshi  
nd' atë mot ngrënëj  
si burri, kë veshi  
Gavnja!... kush mundnej  
t'e tundnej e t'e shkundnej?
28. Ndramendi i fadhartur  
me tru t'e vëj përposh,  
të djathten e Dibres  
zëj me atë kalosh  
kuelvet, të qellur  
ka Uxuni mbjedhur
29. ka tò zënat jashtet  
ndë dhët Ungerisë,  
ku djallin ish e bënej  
për helm Krishtrisë!  
Diq atjë e kallonej  
e shpitë turpéronej.
30. Ka jatra anë e Dibres  
me kuelt Adhramanin  
shtjiti. Ai ndë Misjet  
bëri më baxhanin,  
te gjithë shkeli e xheshi  
e u qell keq si deshi.
31. Ki kaq i brerosur  
drithmen kish shtënë  
Arbreshvet çë llargu,  
se c'ish kin xënë.  
Ai çë fare i renej,  
se për fare i mbanej,

85) I Qiliqisë

86) néné

87) al t'i sundonte

88) «Feti» quhej Amurati i dytë, d.m.th. «Pushtonjës ngadhënjimtar»

32. ish vetë Skanderbeku:  
     kta krera shokë pasur  
     ndrë të zënati e Asjes<sup>89</sup>  
     e gjetë kish masur,  
     si edhë at' marrimarr  
     tërbim Abuxhafarr,  
 33. çë me kuel Alliu  
     sill krahxit t'i ruenej.  
     Nengu kët turk  
     ren, çë ka shkonej,  
     me ndër dhëmbë gjishtin,  
     sa mallkonej Krishtin,  
 34. e diq Ungerjotë,  
     kuj dhe me trù Turku  
     pahir shkulnej vashat  
     shpivet; e, si ulku  
     shtin delet përparran,  
     i nisnej të qara  
 35. ka prindzit e mjerë  
     me lotë e me hjidhi!...  
     Qajen me ta guret;  
     t'i kishen lipisi  
     gentë edhë, çë vrejen  
     at' helm e i leh' jen  
 36. kërrusuriz mënjanë!  
     E Bëna e turbuer<sup>90</sup>  
     qanej ndrë të zeza  
     at' gjind të meruer,  
     për aqë bila nisur  
     e aqë gjella shprishur  
 37. udhes allalarta  
     shtirë të trakulojen  
     ndë shtrat të Vdekjes  
     ç'i shtronej të lëjen  
     gjumthini e ëmbel  
     me të mirit ëngjel.  
 . . . . . Maumeti  
 63. j'arrú e zú e i folen  
     me të truvet gole<sup>91</sup>:  
 63. Ti zoti Amurat,  
     së vren Arbërinë,

89) ndër luftërat e Azisë

90) Natyra e turbulluar

91) me zërin e mendjes

- për ngenë çë ti i dhë,  
     te zhë me Misinë,  
     si të pështoi ka dora  
     e si të râ kurora  
 64. saj, çë ti mbaje?  
     Le të verë Misia:  
     Paqsoju prë nani...<sup>92</sup>  
     Ruej se Ungeria  
     së ngjalë çë zehet  
     kur ngrohet o ftohet  
 65. hera ditvet' mira.  
     Ngjudhirju Arbërisë,  
     me ushtrat, çë zënë<sup>93</sup>  
     kë kundra Misisë,  
     se t'i shkelnjesh liqen  
     si Ungerisë Kriqen.  
 66. Leji pér ni të venë,  
     se vjen çë ngenë kë  
     të bëç më tutjë  
     këto di qiqë<sup>94</sup>.  
     Mbjith e stros ushtritë  
     gjithë mbi Arbërit.  
 67. Frakosju sa më njize,  
     se ndë i dhëfsh mot  
     asaj, s'und e mbjethsh  
     për at' bushtrin zot,  
     çë aq me forë e qellen.  
     sa mund i jarë<sup>95</sup> gjellen.  
 68. Strosti gjithë krerat,  
     çë janë më të bushter  
     nd' Ungerit e Misjet.  
     Prëtriti nga ushtrit,  
     çë nganjë ka nënë  
     e rritja me të shtënë<sup>96</sup>.  
 69. Po t'errënjesh kështu  
     të këç at' kurorë,  
     çë ka kriet të râ,  
     mund pra ' jash dorë<sup>97</sup>  
     papá tek lë  
     për ngenë çë së ë.

92) pér tanë...

93) që ke nisur, filluar

94) qiqë («qiqë» — pér të rimuar me «kë»)

95) mund t'i japë

96) me të shtuar

97) pastaj mund t'i japësh dorë (mund të përsëritish luftën...)

70. Furnon pra ku zure ...  
 Hap sitë e me të shpisë  
 Pasharat mirë fole<sup>98</sup>,  
 e thirr proksonisë,  
 çë me lletra shkruer  
 ke t'nisnjesh, tue quer  
 71. krerat me mbjedhur,  
 të venë nënë Allin,  
 të shqiejen e 'therjen  
 si dele Arbërinë.  
 Amurati i ngrohur  
 ka kjo ' eger sofur,  
 72. ç'i bëri Maumeti,  
 pataksi e u triqimis:  
 Pra çë foli e ndreqi,  
 Alliu bën e u nis  
 me gjithë krerat zgjedhur  
 ka do ishen mbjedhur.  
 73. Ki udhes Arbërisë,  
 çë Turqvet ju zdroth,  
 ngit me trutë e liga,  
 çë kallzoi e hjoth  
 me shumë kanosi,  
 çë bëjen trëmbësi  
 74. veshvet arbëreshë,  
 si moti kur nxihet,  
 shkepten e gjimon  
 si ka mali e shtihet  
 me t'erret vrujtëm,  
 çë me ngjerthëllim  
 75. zë gjindjen e kavshen  
 e i shtinë të tirmosur  
 kalivevet babartur  
 si dirq, kuj strosur  
 qenë gjë qen të tharet  
 t'i reshtjen ka arat.  
 76. Si ajò gjind' e kavshë,  
 ka moti dhistanosur,  
 të pakzit Albreshë  
 së keq' kanosur  
 ka Turku, çë vinej  
 eger t'i binej,

77. pjesë e marmarosur  
 e pjesë të meruer,  
 ulet së pushojen  
 gjakun: tue rëkuer  
 ruejen si të dojen  
 vrerit' ja pështojen.  
 78. Qajen, vejen shpjeksur,  
 hin e dilnë gjirivet<sup>99</sup>  
 për fjalesh vapëzi.  
 Kështu gjithë shpivet,  
 çë kishen një vater  
 s'folej më jatër<sup>100</sup>,  
 79. se t'helmit, çë nxinej.  
 Shkuljen lesht e faqen<sup>101</sup>,  
 tue thënë; popo biermi  
 libertan<sup>102</sup> e paqen  
 97. Me ehja gjithë veshi,  
 për ndërë 'nga katundi<sup>103</sup>  
 gjiri; e me zotrat  
 krera mbani e tundi  
 gjithë, e i mirrni vesh  
 'bushtrit zot Arbresh.  
 98. Ki nga horë ndëhej  
 ahiera me vapëzi  
 fjalesh<sup>104</sup> e të puthej  
 me zotrat gjiri,  
 për gjuhen e Besen,  
 çë «mirseyjen» e presen,  
 99. të xënë si kanë 'qellen<sup>101</sup>  
 nd'atë herë të helmuer  
 ka Turqet kanosi.  
 100. Mandaj nga katundi<sup>105</sup>,  
 ka zoti 'rricidhuer,  
 gjindja gjithë shihej  
 ture combatuer:  
 Kush stisnej, kush bënej  
 gropë o thellonej

98) bisedoje

99) hynin dhe dilnin nga gjirite

100) nuk flitej për tjetër gjë

101) shkulnin flokët e faqet

102) lirinë

103) për ndër të qdo katundi

104) me ngushëllim fjalesh

105) në qdo katundi

101. katundit rro-rrot:  
kush ehnej o dirlonej  
pér hele e thikë shatat  
e pjoret: kush mësonej  
kueil të shurbejen  
te lufa si dejen<sup>106</sup>.
102. Kush të shpatalisnej  
xëj e t'vej kaluer:  
kush më mirë stenej  
të msonej, tue msuer  
jipej e dërtonej  
antet si dojen.
103. Gjithë cambatojen  
burra e pjeq si ishen.
- Pjeqzit pra, çë foljen<sup>107</sup>  
kështu e hapjen gofen  
ndër shpizit' thojen  
bilvet të shëndoshët:
- Ecni e bëna nderë,  
Bil, te Dibra poshtë:  
Luftoni si Arbreshë  
me zëmrat me lesh.
105. Me ehja, bil, veshi!...  
bë'tju njohë Turku  
njerez të nderuer ...  
i bini si nji ulku.  
Të ritë burra Arbreshë  
të leshtit mirrjen vesh<sup>108</sup>,
106. e, lënë shpinë, vejen  
me bukë e me turcessë  
ka Skanderbeku i mbjith  
e vëj gjithë mbë pjesë  
të antevet, çë bëncj  
e këto fjale i thonej:
108. «Liqja, o Gjiri,  
ësht ka ana jonë!...  
Me né ë kjo hjë<sup>109</sup>,  
çë nderë e gjellë na jé.

106) dojen dinin (<dejen> pér të rimuar me <shurbejen>)

107) pieqtë pastaj, që dinin të flisnin

108) të rinjtë arbëreshë dëgjonin pieqtë

109) ky hir, d.m.th. feja e shenjtë

96. Le misa co që deot  
Ciondoan jeten mis.  
Grona te Chorhies.  
Gjind uit e fumus...  
Mosfora te këlymohi.  
Nde bunt ja ngrotni!
97. Me qya gjith bishi  
Për ndes qya Colondi  
Gjira, e me shtet  
Lesa mbani e tundi  
Gjith, e imirri uab  
Buchtir rot Arbush.
98. Chi riga hoos nichij  
Mhysa me vapza  
Trofush e te pathy  
Me shtet gjira  
Përgjuchen e Beven.  
Cu moshesin e presen
99. Te ieror si caan Helen  
Ndot heurt te hilqem  
Ca Turhet canossa.  
Ai fore misur  
Shtetit mbala bixen  
Shorbasat eje dojen
100. Mandorj qya Colondi  
Ca robi moshes,  
Gjindia gjith shukq  
Lura zambatuer.  
Cush siunq, cush beriq  
Gjope o Thedonq
- Om dalla man di qua obietto  
tante miracolante la nostra!  
N'è nulla il volto cor cristiana gente,  
tra le braci sola voi piove nulla  
si conturbate nella nuova amica  
inverrate il cintore del calore!  
Dato mani alle spade tutti e d'arma  
vestiti, per l'oro di nostra patria,  
accorciati nell'obbedire a i vostri duci  
visti tutti e fedeli e moseti  
il corvo dell'Eroe oh nostra terra.
- In ogni luogo e cittad alla croce  
sono lor confortando col ordinando  
alla difesa comune i loro signori  
ubriacati gli uomini capitani  
che fucilano altri e impiccati,
- onde intender sua morte e suo volto  
in quell'ora si grava contristata  
dalle feroci minacce. Ed è dicondo,  
i due volti n'adornissano il cielo.
- Quindi in ogni città dal fronte Core  
ristato, a favor della difesa  
forse con l'ulme e le bieche. Chi v'attende  
la muore a suffocare chi colla mano  
e profondar le fosse.

109. Harepsi, shokë! Kemi  
hjé kto ehjé ' rrotarmi  
ndrë zbulitë e Dibres,  
te vem'kriet 'i marrmi  
Turkut, çë mixiren  
vú kur tē miren
110. dish'vith dhethit ténë,  
e Besë e leftheri  
na cënoj e shkeli.  
Gëzonie, shokë gjiri,  
se na liqen kemi,  
çë bën e gavnjemi.
111. Ndomos se njón shumë  
Turqit s'kanë çë bëjen  
me k'ruejen nderen...  
e dinë si luftojen...  
u, çë shokë i pata,  
zëmren'tire mata.»
112. Këshitu Skanderbeku  
shokë-gjirivet thoj,  
kur me sin e urtë  
shi'kjo e folë t'doj,  
çë shkrepitin ndë gjit  
i zgjonej e fugitë.
113. I ndreqnej si duhej:  
trimat lert kalorë  
i bënej, e ngunjorat  
me sto' sahj e llorë  
axatra t'i bënej;  
të martuerit lënej
114. mbjedhur ndrë katundet  
t'i ruejen ka të ligjtë.  
Sa gjithësej ndreqi  
u zdroth si ka armiqtë,  
çë nd' Arbit vijen,
115. e kishen zënë e hijen,  
si korba me etë gjaku;  
si korbat ç'i rrotarjen  
nga dita ré-ré,  
se mbi ta vëndarjen
- vdekjen, çë me mish  
i ndöndnej si kulish.

imazhi i fëmijëve  
fëmijëve i Buxekut  
perditë e Shën Mihalit  
fëmijëve i mësimdhënësve  
fëmijëve i mësimdhënësve  
fëmijëve i mësimdhënësve

## KANGJELI I TREJTE

### Përbajtja e KENGES SË TRETE

Ushtria arbëreshe takohet me atë turke dhe nga të dy anët luftohet me vrull, kur Feja e krishtere me shumë engjëj përpigjet me Fenë turke e me gjithë shoqërinë e saj. (str. 1-2). Ato luftojnë simbolikisht të padukshme, sikur t'i ndalonte dikush; po kur Perëndia deshi të mbarohej lufta e Feve, e urdhëroi Fitoren të rendte me vrap dhe kjo dërgoi një stuhi me gjëmime e shkrepëtimë kundër turqve dhe Fesë së tyre, aq sa ushtria turke u tremb shumë duke u zmbapsur. Ndërkëq Skënderbeu e urdhëroi ushtrinë e tij të zmbrapsej e të fshihej në ndonjë pyll të afërt dhe të hante sillën me bukë e verë, duke pritur të mbaronte shakullima.

Përkundrazi Aliu i ftói turqit e trembur ta kthenin kokën nga ai dhe të dëgjonin porositë e tij. Me fjalë të marra nga Kurani, Aliu u thotë atyre të luftojnë me guxim e të vdesin, po të jetë nevoja, se pér ta është hapur Parajsa me lulet e me gjithë gëzimet që dëshëron zemra e njeriut. Këtu Feja turke vjen e mundur dhe e lidhur me pranga hckuri. Aliu vijon duke u thënë ushtarëve se po vjen një vajzë «çë shkilqen ndër vashat si një trendafili», e cila sjell me vëhte 500 kalorës të zgjedhur; prandaj ai vazhdon: «sa të mbaroni jë kjo monostrofë, kem' t'i sulimi Arbëreshvet t'i vrasmë e t'i shprishmi.» (str. 4-62,1). Ndërkëq Aliu shtyn përparrë Buxekun me këmbësorinë kundër Skënderbeut, që, i dalur nga pylli me kalorësinë, e përballon me vrull, duke vrarë pa mëshirë turqit e mjerë. Shpatë e Skënderbeut u ngjye e para me gjak turk tek aradha e Buxekut, duke i prerë kryet Ahmetit, pastaj Kardamonit. (str. 62,1-92). Skënderbeu, i nipi Hamza dhe arbëreshët bëjnë kërdinë ndër turqit. Nik Peta vret Abulin; po kur Buxeku pa se kalorësia arbëreshe mbillte vdekjen kudo, shkoi tek Aliu, pér t'i kërkuar këshillë. Ai i tha të hidhite në luftë ushtarë të tjerë, derisa të arrinte kalorësia e fshehur e Abuxhafarrit, e kështu Aqburri e

Manxurri hyjnë në luftë nga të dy anët me këmbësorët e tyre, duke luftuar edhe në mes Buxeku me reshtin e tij. Atëherë Skënderbeu e ndau më tresh kalorësinë: nga e djathta dërgoi Kont Uranin, nga e majta Arianitin, dhe duke qëndruar në mes vetë me të nipin. Kont Urani ju sul radhës së Manxurrit, duke e shpërndarë e dërmuar; vrap pastaj Alibeminin që ish në krye, mbi një kalë arab, duke i prerë veshlat. Nderushi, i dhëndri i Kont Uranit, si rrëmbeu kalin e Alibeminit, i hypi dhe shkoi përparrë, duke shkelur dhe vrarë shumë turq. Kështu, arriti te i vjezzi, që gati sapo rrëthohej nga turqit e Solimanit. Atëherë Nderushi lëshoi një klithmë, sa mali i Dibrës kumboi, e turqit i zuri drithma; pastaj u sul në mes të tyre, cau rrëthimin, duke vrarë shumë prej tyre. Ndërkëq Kont Urani, duke shkuar përparrë me të dhëndrrin e duke u përpjekur me radhët e Muhtarit, i preu kryet Solimanit. Dallohen në luftë edhe Arianit Komneni me kalorësit katarjotë, që luftojnë kundër radhëve të Aqburrit e të Tullunit.

Sheshi i luftës duket si sheshi i Hidhërimit, plot me gjak, me klithma e të vrarë.

- 68. Ahiera  
shpatë Skanderbekut  
e para t'u ngjje  
te anti Buxekut,  
që i pari i ndehet  
i shtijturi të zëhet.
- 69. Atij u fanaros  
me gjiritë Arbreshë  
si lliun me ë mishë  
stroset ku janë desh.  
Këtu çë e hjas zdrith  
me shokët, gjellat vith  
si Vdekja e pa-ndëndur,
- 70. çë me ta rrungonej  
askandrësha e qeshnej  
sa më gjella rkonej  
nënd vozhetë e saj,  
çë pjet gjak e vaj
- 71. mbjonej at' zbuli,  
çë si Pisa nxinej,  
me lip e me helmi.  
Me këta ajó shtinej  
e ngurnej si ecet  
si ka karkalecet,

72. kur zjarri kollomesë gjellen i rrrafaren.  
Vdekja, drithem zjarri, këshütat burraren me shpán e fatosur<sup>110</sup> e Arbreshvet strosur
73. mbi ta si aqë qen. E qen dreq dukshin, se kuelt nënd atire më se qen sulshin, se shkeljen me këmbë e zëjen me dhëmbë.
74. Kali Skanderbekut, kuj Korb ja thojen, — se si korbi nxinej, e mbë karrerë shkonej gjithë kuelt e gjirivet — zdrith trëmbësi sivet
75. Turq, kuj kcnej e zëj kriet me grikë, Ahmetit, krie axât, keci e zú si fik kocen: te ja mbáj<sup>111</sup> si bar ç'kish ' haj,
76. tundu me nj' vërvilë Skanderbeku preu at' kocë ligash trú. Kali kriet s'lireu, po vjerrë si kromastar ndë grikët tue ngarë
77. e qellnej e trëmbsinë shprishnej ka ngulej<sup>112</sup> ndër shokët e Ahmetit: e kuj ngrah sulej at' kocë çë rrëjith gjak, si-hapët zdrith ndë ceret aq fort, sa dreq e cotjasnej. E furnon së vrari me shqelbet çë i pjasnej<sup>113</sup>.
78. Kalorin, cë si pikë vrit, ndëpër thikët

110) me shpatën e magjepsur

111) ndërsa ja mbante

112) tek ngulej, tek futej

113) që i jepte

79. qellnej: e kështu té di të math bëjen lëmashin e gjindjes, çë nënd atire lëjen gjellen e gjiritë, ç'i prisjen ndër shpitë.
80. Kalorit prematjotë ngëmshit s'e lëjen maj e me forë ashtu e hijet luejen: Bijen të shteku Turqvet, çë Buxeku
81. i shtinej mbë hundë, si suvalat era, gjithë njeri mbi jetrin ka zalli karrera, ture thier përpara ka e nderes karrara,
82. me shokët, Skanderbeku më tutjë skotisi Kardamón, cë mbanej, si mbalë timbes lisi, me llajenë e tij, çë kalërisë rrij
83. ndë ceret me forë. Si Skanderbeku errú mbë hundë tij grahu: Kali drithmen shtu llajesë me ndë grikët kocen: ndëpër thikët
84. ngrerë qirithin, çajti. Gjithë kalëria hiri pra e shprishi e shkeli. Kardamoni ahieri<sup>114</sup>, sa pà se s'kish çë bënej vdekjes ' ja pështonej,
85. mbë hundë Skanderbekut erth me shpán ngrëjtur e kështu zú t'folet: Ti edhë kë t'rëjtur ka vdekja ndë k't ditë si aqë timshit<sup>115</sup>.

114) atëherë

115) shokë të ml

86. Vrë! çë kë pérpara!  
Rüej Kardamonit,  
çë ca mot ndë Misjet  
luftoi e Siqirjònít  
dhjetë katunde i muer  
e pra ka jeta e nxuer.
87. Mbanj se dit't e tua  
janë e s'janë piksur,  
ni çë m'u pérpoqe!  
Ndë k't cingardhiksur  
fjalesh, Skanderbeku  
i tha: bir derku,
88. zë të shpatalismi  
pér nderen e bukur  
ke<sup>116</sup> ka çera jote  
u reshtenj si fjurut,  
e bë t'shohsh zi  
me tö egrit si.
93. . . . .  
e Skanderbén, çë shkoi  
tue humbur gjetk  
me Amesen, kë s'lëj  
të vetém të vej  
maj keq mos' kej<sup>117</sup>.
94. Shokvet ngarë pérpara  
j'arrú edhë ja shkoi:  
i hapi udhë gjetk  
ku Abulli s'doj' lëj  
Komnenin të ngatej  
e zëj me të e matej.
95. Sa t'e vrei Abulli  
buer sa kish zbrahem,  
e la shokët 'mbanej  
me at' madhin graham:  
U ngür, si i dhjerë,  
e vrarë qe pa nderë
96. ka bushtri Nik Petë,  
çë kalor j'arrú  
e fjamurin i muer  
nji shoku, çë si hù  
qellnej ratë e iknej  
sa udhen së shihnej<sup>118</sup>.

116) që, të cilën (rasa kallzore)

117) s'e linte vetém kurrë, që të mos i ndodhte ndonjë gjë e keqe

118) shihne

97. Buxeku kur vrei  
se llajtë, çë nisnej  
mbë hundë Skanderbekut  
së mbajen, se i shprishnej  
sa nënga t'i pérpiqshin  
e fjamuret i mirrshin,
98. ka Totaqirku Alli  
rrangarti për këshill...  
Doj' dij ndë kish' shtinej  
më gjind ka kush vill  
vdekjen gjithaparu  
e shkelnej gjithë mbaru.
99. Alliu, çë kalérinë  
prit' dil ndër anet<sup>119</sup>,  
si të kish qindruer,  
tha: shqip tëndin anet<sup>120</sup>;  
çë të ngasë varesen,  
mos rë se slurmë vdesen
100. pérpara ktij zjarri.  
Zjarr ë kjo kal' ri,  
pér né gjithë axatu.  
Kem' rrjm' me at' kusi  
t'e shuemi me gjak  
ndë ktë 'zezë llakë.
101. Mesarénë çë zure  
mbaj e shtij me graham.  
Aqburri e Manxurri  
bë t'zenë edhë me zbrahem  
ndër anat' luftojen,  
kalérinë të lodhjen.
102. Me tartarénë time  
prapë e prapë të ruenj.  
Ndë u lipsit ndihem  
e strosenj të luftonjë:  
i qellmi dhunë, njera  
të vinjë e bukur hera
103. e kalérise tënë<sup>121</sup>,  
çë shumë e preret<sup>122</sup> hin  
e shprishen e humben  
këta çë Arbérinë  
duen 'ngalljen. Pérpara,  
Buxék, ka karrara

119) anët (\*anet\*) — pér të rimuar)

120) ant, rresht (\*anet\*) — pér të rimuar)

121) tonë

122) e çlodhur

104. nderes, cë na hapet  
si tézuer ndér këmbë.  
Manxurr e Aqburr,  
ndér anat, si di gjembë<sup>123</sup>,  
shkrehni llajetë taj.  
Buxek, mesin mbaj.
105. Té tre këta mbjatu  
ka udha c'i qe dhënë,  
si një gjimës kulaci,  
llajetë, cë kin nënë<sup>124</sup>,  
ndëjtin se t'i shtjen,  
kalrisë se t'i bijen.
106. Sa vrei Skanderbeku  
si udhet dojt'mbajen<sup>125</sup>  
Turqit e trutë njohu  
Alliut, na kem'ndajem,  
tha, shokë, kalrinë  
tri pjesësh, ndë Gavnjinë
107. s'duem 'lëmi atire....  
Zitu, Kont Uran,  
ka e djaththa me kuelt,  
cë qellen baxhan.  
Ka jatra pra ngit,  
ti zoli Arjanit.
108. Amesë, na këi mes  
mbami. Shokë përpara...  
Hurrah ka zena jonë!...  
Përpara ka karrara  
ndores! Gjithë u shtunë...  
ndë vend' t'tire errunë.
109. Urani gjet ka e djaththa  
Manxurri gjak-madhin,  
cë, se mo Skanderbën<sup>126</sup>  
qe shok, bën të madhin  
mbi gjithë krerat trima,  
se, shokë me të, drithma
110. bën, e zù Çiliçin,  
cë Fetes ju zdroth.  
Ushtres parë Manxurrit  
si monastrof u hjoth,  
me kuelt e sparrangjisi,  
me shpatat pra e grisi.

111. Kështu u sul të dites<sup>127</sup>  
e, pas asaj, jatres.  
Allibemin vrau,  
cë fjit me golë kau.
112. Ndë Misjet, katundevet,  
si totari kaluer  
kalit arab, hinej:  
shkelnej tue mallkuer  
me golen cë ndërrnarnej  
e vrit kë i mbarrarnej.
113. Për se mbi kalt vej  
dish' bënej baxhanin,  
te ushtra t'i shprishej<sup>128</sup>,  
e priti Kont Uranin.  
I tha: me tij Arbresh  
ndë ktë'nderes shesh
114. dua t'e shò', të xëhet  
edhë ka shokët e tú  
kush ë Allibemini,  
cë drithmen Misjes shtú,  
për sa vrit e shkelnej  
e bënej cë i pëlgenej.
115. Mënjanë dalmi e e shomi,  
vi, tha Kont Urani.  
Shokë, u ni ju truenj  
gjithë kuelt mban:  
vreni Allibemini  
si lufton e rrini.
116. Mënjanë lufta u zù...  
Turku Kont Uranin  
xhirarnej e gënjençj.  
Si teri me allmanin,  
ki qellej e ruhej  
me shpaten si duhej.
117. Si pa se bir ngenë  
me Turkun, cë e ngjaten,  
grahu e kali e qelli  
mbi Turkun me shpaten,  
e veshlat i preu  
e kalin i rrëmbeu,

123) bubullimë (=gjembë — për të rimuar me «këmbë»)

124) nën

125) si njohu qëllimet e armikut

126) Skënderbeun

127) së dytës

128) ndërsa ushtria i humbiste

118. e ja là Nderushit,  
te shokzit thërrisjen:  
Eh vremë Allibemin<sup>129</sup>  
si lufton! Buhjisjen  
me kët thirrem copat,  
malet rrëzë e gropat,  
119. çë prapë gjithë përgjegjshin  
e rrëtjen trëmbësinë  
ndëpër Turqit 'mjerë,  
çë vrejen Gavnjinë,  
çë, (si lliuni deshvet),  
përzier Arbreshvet<sup>130</sup>,  
120. i vith gjellen trime.  
Nderushi, se të xheshnej  
Allibemín rarë,  
çë vdekjes i qeshnej,  
qindroi e u qikár  
mbi të. Ehj't me ar  
121. sa ja shkuli e muer,  
arabit kal këcej  
me një kapérxim  
e i tha: ish atoj<sup>131</sup>.  
Atej kem'ngasmi,  
Turqit se të vrasmë  
122. bashkö me Kont Urán<sup>132</sup>,  
prind bilash me hjé  
sa i hundohet Dielli  
e s'ecen tek i she<sup>133</sup>.  
Ti, ndë si al çë kisha  
e shumë mirë disha,  
123. se gjegjet bënj mua,  
qofsh e s'më gënjen  
sot e mirë më qellen,  
ti zonjë të mirë vren  
mbi tij një vashë, çë kurë  
të ká: ajò si amür  
124. i gjallë zbuluron  
ndër shoqet me hjé  
të shekullit çë ecen.

- Ajò elp të jé  
e bën e hâ sa do,  
për se mirë më do.  
130. Kështu të këndon  
Vasha, çë u dua,  
ndë<sup>134</sup> t'e meritonj  
ti bën nderë mua,  
tue thënë e tue vatë,  
kali, çë s'doj ratë,  
131. i thoj eh ngaçikë  
me kocen çë ulnej  
e gjegnej me veshët  
ngërlartur e s'ulnej.  
Tue ngarë errejen  
te Kont Urán çojen<sup>135</sup>  
zënë me Bajaxetin,  
Nderushi t'u shtu  
si kush do të vdesë  
nd'at'llajé e vú  
përposh shumë e shkeli  
me kalin e i çeli<sup>136</sup>  
133. ehjen çë vith gjellat,  
save mirë i erth<sup>137</sup>.  
Pra për krei shokvet  
nënd Urán u derth,  
si lumí çë siell qinë,  
ka Sullimani shtin  
ushtren e Buxukvet,  
me axatra e kalorë  
piksur, gjithë e veshët  
me hekur; me llorë  
'shëndoshta, kta rëgra,  
me çeret e egra,  
134. si qene të pjela,  
shtihshin tue thrritur  
me treqindet gjuhë,  
çë kurmin të mbijtur  
böjen, kuj së jesh  
dreq gjak arbresh<sup>138</sup>.

129) kemi vërejtur Allibeminin

130) që vërenin Fitoren përzier me Arbëreshët, si luani në mes të dëshvet

131) shko andej

132) Uranin

133) i sheh

134) në qoftë se

135) ndërsa gjejnë Kont Uranin

136) i goditi

137) erdhë

138) atij që nuk ishte prej gjaku të kulluar arbresh

136. Trima — shokët e Uranit  
me këta sa t'u'rrunë  
mbë hundë, u përleshtin  
e si qen u zunë,  
te kuelzit i ngrëhshin  
qirithin e zëhshin
137. bashkë me zotrat'tire,  
çë zdridhjen shpatë o hëll,  
çë prisjen e shpojen  
hekuret e thëll  
ndër kurmrat i hijen  
e gjellat i shkrimbjen<sup>139</sup>.
138. Nderushi dhe si i llav't,  
se t'nderonjë Xhudhitën,  
zdridhet e Buxukrat  
dhjetë e dhjetë mbiten  
ndë gjak'lire: thërrret,  
te shpaten kërsët:
139. «Meshëndetë neve  
e Zotit Arbëresh!»  
Më ju siell Djalli  
këtej kunder nesh? ...  
Një, si këmbalarta  
ju shtiemi te balta! ..
140. Zë boten, bir qeni ...  
Ti jatri tët çmë  
më së shë<sup>140</sup>. Ti jatri  
së hë bukë prëmë<sup>141</sup>...  
Tij jatrin, kuj ballen  
ndajta, kush ngjallen?
141. Te ngit, ture vrarë  
si gjëmba ka shkon,  
i crth ndëpër trutë  
Urani, çë lufton  
më prapë, te përpiqet  
e çsht po të hilqet
142. me Turkun Sulliman.  
Te kta krera zëhshin,  
Nderushi vrej ca Turq,  
çë kulaç vëhshin,  
si krej i bëri mb'si,  
të zëjen filaqi<sup>142</sup>

139) ua shkulnë, ua merrnin jetën

140) më nuk shëh

141) sonte në mbrëmje

142) rob

143. 'busharin Kont Urân,  
Këtu ju errjeta,  
e, si ka janë Dhimonë  
shtihet Shën Mihali  
t'i bjerë, u sul. Mali
144. Dibres rrukulloj  
e reksi me thirrmen,  
çë Nderushi shtu  
e mixorvet drithmen  
suell, te ju sul  
e ndëpër ta u ngul,  
si pikë çë shkrehet.
145. Nderushi përposh  
gjithë me shpaten vù:  
tue këc'er kalosh  
me nisen, çë i muer  
kreit, errú mbë herë  
çë Urani kriengula  
shtij Sollimán<sup>143</sup> pa-kocë;  
kë tundu si karçifull  
i preu e si marròc  
ju pjas tek i rá  
çë shurë e gurë kâ.
146. Me nisen marrë e tokun  
e kalit, çë mbän  
me nj'dorë, me jetren  
kulaçin turk càn  
bashkë me Kont Urân;  
prana Sollimán
147. xheshen e merr kalin  
me galùn ndërruer,  
sa si kali Diellit  
shkilqenej, tish ruer  
të jatit Xhudhitës,  
çë kish hjetë e dritës,
148. çë jeten zbuluron  
e veshën me të mira  
e gjellat lumbardhosë  
e bën të fanmira.  
Malli Vash's hjemadhe  
bënej kaq të madhe

143) shtynte Sollimanin

150. foren e Nderushit,  
çë si pikë shtëllohet  
jatres llegë mixorë,  
çë stroset të zëhet,  
ka Muktarri shtijturi.  
Abubekrri'mbijtur ...
164. Sheshi mérjes duket  
copa ku rëkohet  
e qahet ndër lucat  
me gjak, ku lingohet<sup>144</sup>  
njera çë Spiriu<sup>145</sup>,  
i jati mos njariu,
155. me të i darakopsen  
thellë ndë barkut natës,  
pa ilez e pa Hënë  
me vrerin e mëkatës,  
ku Mosnariut qëllon  
e s'ë kush e zgjon.

## KANGJELI I KATERT

### Përbajtja e KËNGËS SË KATERT

Perëndia mbi froni e diellit vështron poshtë drejt sheshit të luftës dhe sikur gjëzohet, se derdhet aq gjak turk nga arbëreshët. Ndërkaj Skënderbeu mëndon si të shpartallojë turqit, pastaj me Nik Petën i sulet aradhës së Alitamanit, i cili i kishte premtuar Aliut kryet e Skënderbeut. Aradha e Alitamanit përbëhej nga ushtarë persianë. Skënderbeu i shkel edhe i vret, ndërsa Alitamani shpëton e zhuket. Pastaj shkon kundër aradhë s'Aqibës, të fejuarit të Xoraidhës, e cila po vinte me 500 kalorës. Skënderbeu i preu kryet Aqibës, ushtarët e të cilët u shpartalluan pa lavdi. Skënderbeu i ndoqi dhei i vrua ata, «tue i shtruuar trollin për shrat», vret edhe Mustafanë. Muzaq i lulton kundër Feraqit. Kont Urani kryen veprime heroike kundër aradhës së Manxurrit. Arianiti vret e pret turq ndër aradhët e Aqburrit. Ndërkaj Aliu hidhërohet për shkak se kalorësia e Abuxhafarrit nuk po vjen ende, dhe këshillohet me Buxekun se ç'duhet bërë. Së bashku vendosin të grumbullojnë aradhët e t'i vërsulen kalorësisë arbëreshë. Të dy krerët shkojnë përpara dhe përpigen me Skënderbeun e me Hamzën, ky përballon Aliun dhe Skënderbeu Buxekun; por të dy krerët turq zbresin nga kuajt e shpëtojnë. Aradha e Aliut, përkundrazi, vërsulet kundër arbëreshëve me shumë egërsi, se hieja e Amxarrit (të vdekur) Irymëzon turqit të luftojnë fanaticisht. Nadir Abiqi, heroi i Sfetigradit, është i pari ndër luftëtarët turq; ai vret Kuqën, arbëresh nga Suliu, kushëri i Skënderbeut. Ky atëhere u zemërua keq, u bëri thirrje shokëve të tij, sa malet gjëmuani, edhe i hodhi kundër turqve; këta i priten me guxim të madh, duke u bërë ballë arbëreshëve, të cilët ishin shumë të lodhur, se kishin luftuar shumë. Shpëtimi i arbëreshëve në këtë kohë qe Lek Dushmani, që erdhë me kalorësinë e tij të clodhur, me të cilën u hodh në luftë. Skënderbeu ndërron kalin e tij të lodhur e lëshohet me vrull kundër turqve, pasi vret Nadir Abiqin shkon përpara me kalorësinë arbëreshë e, si zjarri që përhapet duke djegur barin e thatë, vret e shpërndan aradhët turke. (str. 1-141). Në këtë kohë në Krujë

144) lëngohet  
145) Asgjëja

arbëreshët lusnjn Perëndinë e shën Mérinë t'i jipie fitoren Arbërisë. (str. 142-157).

4. Këtu Skanderbeku  
Nik Pet's u pruer  
e tha: kta bil derku,  
ç'ikjen, më mbarrar<sup>146</sup>  
me kuelt, e i xhirar<sup>147</sup>
5. t'i zëmi filaqirë<sup>148</sup> ...  
Pengoji këmbë e duer,  
si dhë cë kan' theren,  
e bë't'jenë ruer  
te dushku këtjetëj.  
Ndramenti u atej,
6. ka uta Turq na presen,  
ngaz e sho<sup>149</sup> çë duen,  
mo këta shokët e mi,  
çë sot na nderuen.  
Grahn, biltë e malit,  
me mua, e I râ kalit,
7. ç'u skaperdhiks: e kellnej  
si era e gjithë shkonej  
si illi shkëndilavet,  
çë bishtiin i bëjen<sup>150</sup>  
kur lëshonet e bie  
o ngjet ka njeter krie
8. jetje. Sa t'erru  
ndata Turq, zu e shpoi,  
e me mish e gjak  
gjithë at'llakë mbjoi.  
Ka do ngit skotisnej  
e gjithë sparrangjisnej
9. si kashtat vorea,  
çë Irin e keq' e shtin  
çëdo i mbarraren  
e trollin pastru shin<sup>151</sup>.  
Pra ka Allitamani,  
çë shokvet thoj: ngani

146) më ndaloj.

147) i rrethoi

148) robër

149) shoh

150) vija e ndritur e komëtës

151) fshin

10. hurrah! kuelt'piermi...  
U shkreh. Ai thoj  
Alliut: ndë nuse  
të bukuren, çë njoi,  
me pesëqind kalorë,  
më dhëvsh t've kurorë,  
me ushiren time vete,  
shtie ka kali Arbreshin,  
e kocë e kal të siell.  
Alliu krunej veshin  
tue gjegjur t'i nxenej  
e takwsa ç'i bënej
11. Allitamani. Pra,  
se t'e nxir përpara,  
i tha: Të qoftë dhënë...  
Hurrah ka karrara  
nderes e luftë,  
të keç kë ti do.
12. Ai Turk pordhullar  
mbjatu me llajenë  
e shtu ka kalëria,  
çë trëmbnej me hjenë  
kë kundrela e ruenej,  
e ënda t'i shkonej
13. të doj me ehj' t'e shij<sup>152</sup>  
me të çërë mbë çërë.  
Si Allitamani erru,  
zù tirqit tue dhjerë,  
e prapa gjithve rrinej  
me drithmen çë e vrinej<sup>153</sup>.
14. Llajeza tij me trima  
persjotë prë ca herë  
mbajti e ca kalorë  
bëri të cënuer.
15. Këtu Skanderbeku  
tha: shokë, kta çërë-derku  
më na kem'duromi,  
udhet' na mbarrarren?  
Mbë shpor gjithë kuelvet  
biemi t'kakaren...  
Hurrah, vi, mbë shpor  
biemi shokë kalorë!...

152) ta shihë (të luftonte)

153) vriste

17. Mbë hundë Persjotvet<sup>154</sup>  
kuelt këcien qirin:  
me këmbet pérpara  
i shkallmuen gjin  
e i lëshojen thikët  
te i zëjen me grik't.
18. Llajeja gjithë qe shkelur  
me fjamuret, c'i ranë.  
Allitamani u buer  
nd'at'ditë!.. më s'e panë  
Turqit e Arbreshët  
të gjallë o' vrarë ndë shesht.
19. Prana Skanderbeku  
me shokë Trëmbësinë  
e Vdekjen e shpejtë,  
me vithe Gavnjinë<sup>155</sup>,  
c'e runej e ndërronej  
me hjezen, cë e bënej
20. si Marti eger<sup>156</sup>, ngau  
ka Aqiba, bir të mirish,  
cë shchura<sup>157</sup> la shpinë  
e prindit, nip lëtirish.  
I jati, pra cë e qajti  
e nämë e e shajti.
21. Trimi bir i iku,  
se t'i bënej shkatë,  
se s'dish t'e martonej  
me k'doj nd'at'villjat:  
Mandaj u përzie  
nd'at'Nisënë, e krie
22. Alliu mbjatu e bëri  
mbi një qind jushter,  
se kish hje t'i qellnej,  
si ish trim i bushter.  
Kur shokët sparrangjisëshin,  
se trëmbshin të hilqshin
23. me Arbëreshët kalorë,  
s'u rua e si horrjat  
me di ca shokë të tjerë  
dish'luenej at' shpatë,  
baxhanin të bënej,  
nusen të nderonej.

24. Këjo ish Xoraidha,  
mes-holla vashë me hjé:  
kjo me mall e losnej  
si e kuqe mollë, cë jé  
dukë grikës e hundes  
e sivet e ëndës.
25. Ish e mirë e e ëmbel  
vasha e këndimavet  
e gjithë katundit saj:  
ish malli gjithë trimavet  
ajò, c'edhë e dojen  
vashat e e shërtojen!
26. Të bukurit e saj  
te mos një kopile  
gjëndej: shkëlqenej  
si një trendafile  
mbi lulet e tjera,  
cë kanë hjé e era<sup>158</sup>.
72. Aqiba kët shërtonej  
se të trashigonej  
me gas gjellen' tij.  
Sa u dhà se prëqmonej  
i jati kët mall,  
cë mbë gji ju ngallë,
28. e i bukurith ju rrit,  
pérpara ja këndoi,  
tue rarë qitareles.  
Pra c'diu sa shkoi  
e prindin pa nxë<sup>159</sup>,  
të ratit la t'i thé<sup>160</sup>
29. dreq kë nuse doj.  
I jati fitinx<sup>161</sup>,  
sa gjegj të folë nusesh  
ka i biri, u mëri.  
S'e ruejti, s'dish t'i dij  
fare mallin e tij.
30. U kërrus i biri e u nguq  
e aq u helmua  
sa bëri bë të keq  
e tha: s'më shë mua  
më tata.<sup>162</sup> Pra shpinë

154) persjanëvet

155) me Fitoren në vithe të kallit

156) Hyjnja e luftës

157) fshehurazi

158) erë të këndshme

159) në vetvele

160) t'i thoshte

161) I ati I keq

162) nuk më sheh më mua ati

- lireu e jushirinë  
 31. té bënej vate e u shkrua.  
 Mbrëmanet pérpara  
 té nisurit këndoi  
 nuses te Qitara:  
 „Rri mirë, lule e mall,  
 u vete, o e mirë pa zall!...“
32. U vete, mall, rri mirë;  
 po, mall, mos më harrò:  
 u vete e mallin tim  
 kultomë, o vashë, kultò.  
 Rri mirë, o lule, u vete  
 e lë kët gjellë té shkrete.“
33. Té vdesë ai vete!...  
 Popo çë më tha!...  
 Xoraidha ture thënë,  
 dridhur shtratin là  
 e patakstë e vati <sup>163</sup>  
 ka finestra: e hapi  
 trimit mall t'i folnej.
34. Mbë vend më nëng e vrej <sup>164</sup>,  
 po, me sa bashkë këndonej,  
 gjegj ka shpia té vej.  
 Me helm një hijdhi  
 lëshoi e gjithë u mbë
35. vasha, çë me zëmer  
 mallin Aqib doj.  
 Mall, lëmë <sup>165</sup> pa shortë,  
 vajtonej e thoj....  
 S'kemi shortë e janë  
 di qen prind't e tanë.
36. Aqiba, pra ç'errù  
 ndë shpit shumë herë  
 qitaren puthi e, lënë,  
 tha: di u ndë më herë <sup>166</sup>  
 té ravsha, o proksuni,  
 e zëmres, çë më di...“
37. Rri mirë, e mirëmagat,  
 buhoi e kopica  
 mos fare té dënofshin.  
 Lénë, u nis me ca
- çë me té u shkruen  
 e ashtu bashkë kënduen.  
 38. Nuse e shpi lireu  
 me helm, si kur dij  
 se trim te Dibra poshtë  
 i vrarë kish' bij  
 ka shpata atij zoti  
 me' bushtrë atij moti.
39. Ki, sa Aqiben vreu,  
 çë si qen ndërsenej  
 ca çë me té mbajen,  
 e sì aq s'lirenej  
 nderen e shpatës t'iknej,  
 rranga sa mos' shihnej <sup>167</sup>
40. udhen, tha Muzaqit:  
 zitu ktej pérpara  
 e shprish e shkel me kuelt  
 e shpo e hap karrara,  
 ndramendi çë, me Amësen  
 ka ata Turq na presen,
41. u kalit bie mbë shpor  
 e vete. Si erë venej  
 ture vrundullisur  
 me shokzit çë qellnej,  
 . . . . .
42. Kështu errù ai Zot  
 43. te Turqit me Aqiben  
 krah-mbë-krah e prisjen  
 me ehjet e shkulura,  
 me nderë té vdisjen.  
 Kështu qentë vëhen  
 tue lehur tek shohen
44. derrin çë t'i qaset  
 i ngreshtruer, me dhëmbet  
 me gjak té ngërrnjasta:  
 e ka ata si i shtrëmbet  
 nget e eger ruen  
 e vetullat së luen.
45. Si ata qen derrin  
 Aqiba mbjedhur prit <sup>168</sup>,  
 me shokët Skanderbén <sup>169</sup>,

163) vate (-vati- për té rimuar me «hapi»)

164) vërejtj

165) u lindëm

166) në qotë se herë té tjera

167) shihte

168) priste

169) Skënderbeun

46. çë me Gavnjinë ngit<sup>170</sup>  
ka ai lart tue luer  
shpanë e kamaruer  
ka vdekja, çë e qellnej  
si shok të rrungonej  
nd'at'zbuli gjellat,  
kuj thanen i vénéj.  
Me ktò shoqë erru  
Skanderbeku e u zú
47. të paren me Aqiben,  
çë të keqin bënej.  
Të hilqshin, me ehjat  
Aqiba dij e luenej  
gjellen: e kish ngjatur  
më ca herë, ndë ratur
48. kalit s'ki<sup>171</sup> mbë shpor  
Skanderbeku. U ngrei  
këtu mbjatu Korbi:  
Aqibes ngrah këcej  
e e uli. Se t'i zëj  
kali kriet t'i haj
49. kocen si Ahmetit,  
çë ndë grik't mbanej  
edhë, zdroth ndonjanë:  
e, tek zëj t'i hanej<sup>172</sup>  
kriet Aqibes mjerë,  
kalori me të luer
50. shpatje at' kocë preu  
tundu e njipherje,  
si qinder këtjetëj  
i vate: një mërje  
zú<sup>173</sup> mbjatu shokët e tjerë  
kur ja vrenë t'i verë
51. rrëzë koces Ahmetit,  
çë me gjuhen jashië  
e sitë e hapët trëmbnej,  
me dhëmbet shgirrnastë.  
Ktij vreri mbë çerë  
gjithë shokët mbë karrerë

52. u shprishtin pa të mbarë,  
si zoqxit e çuer,  
kur ndonjë çérç e huej  
i ndëhet, o gjë duer,  
ndë folë, ku rrinë.  
Atire me Gavnjinë  
j'arrú Skanderbeku,  
trollin shtrat i shtroi.  
Buxeku me rrangón  
ruenej: me trú thoj:  
sa ka t'jetë e kemi  
kalërinë çë duëmi! ...
53. Ah qen! Po si thien  
mbi Mustafán' bushter!  
Kush më mban t'i strosem  
me gjithë timen ushter?  
Alliu s'do, se thot:  
na kem' i jami mot
54. Kalërisë të mbjidhet.  
Njëmos, me rrangonen  
çë kam, venja e e shtinja! ...  
Pa ru<sup>174</sup>! Si mbi tënë  
banderë' tijen ngrën,  
burrat tue na shtë! ...
55. Pa si<sup>175</sup> me Mustafán  
u përpoq e piqet!  
Amin<sup>176</sup>, Mustafaut  
ndih e shkel Krijet,  
çë kta Arbreshë ndëjen  
mbi Hënen t'i ngrëjen...  
56. Parfjet<sup>177</sup>, ndih! ... Ndihi!  
Ndihma çë i vlen?  
E vrau, një! ... E shkeli! ...  
Një si gjetk këcen  
mbi ushtren e Feraqit,  
çë mbë hundë Muzaqit  
lefton e bën qiqe...  
Hasan, hurrah! rrangár  
ka lefton Feraqi,  
at' liuën ec e mbarrar  
mos t'e zërë t'e mbitenj  
e ndë dét t'e nisenj.

170) ngiste, vraponte

171) s'i kishte rënë

172) hante

173) zuri

174) po ruaj, shiko

175) po si

176) Muhameti profet, i biri i Aminës

177) profet

59. Ndramendi si ka Alliu  
u vete prë këshill.  
E coi çë me vreqet  
ndér si vren si vill  
vdekjen Kont Urani  
ka Manxurr baxhani.
60. Antin e tij mbannej  
e shtinej me urtësi  
kundrela Arbëreshvet  
me t'eger kalëri.  
Ture vrerë<sup>178</sup> shërtonej  
kalërinë, çë donej
61. edhë ka Arjaniti,  
çë askandresha binej  
e shkelnej si vdekja,  
çë doj gjithë përpinej  
llajetë e Aqburrit,  
çë, me hjenë e burrit  
bushter, më t'i qellnej.  
Ehi shokë, kini liq!...  
S'keqi sot ngalostim  
me kta Arbëshë të liq...  
s'kemi më çë presmi,  
se gjithë të vdesmi,
62. ndë mënoftë kalëria...  
Njò si na rrotarjen  
korbat e stravatonjtë,  
të ulen mbë darsëm.  
Njò si këtje bëjen  
ca stravatonj e ngrëjen  
një trim shok të ulet,  
e murra si e xhiraren  
të hinjë mbë pjesë te darsmit<sup>179</sup>!  
Njo si gjetk marren  
njater pickandora  
ka këmbet e ka dora,
63. e e ngrëjen e e qelljen  
si djelit me thirma  
e vruitim pendash.  
Sot na humben drithma  
mdë ktë vdekje vrer,  
e zbrahmi inë ë dhjerë.
66. Kush më na ren e nxier  
shapken e ksulen?  
Një antith Arbreshësh,  
çë ndajtur tresh sulen,  
si kavshes tre ulq,  
nguren neve Turq ...
67. Çë thua, Buxek, çë erdhe?  
Ti çë këshill më jé?  
Mos gjë shokë tanshit  
kalorë ndér anet<sup>180</sup> pé?  
Me kta vroqe ruej  
e çë përsekzen thuej.
68. Je i ri e she<sup>181</sup> më mirë!...  
Ruej... Buxeku vrci  
e prapa ju fjandas  
si mjergull çë ngrëhej  
me buhuani e udhevët  
shkelur jashtë gurëvet,
69. çë copavet mburojen,  
si bari oger dheravet,  
e si të keqat shpivet  
e helmet të lerëvet<sup>182</sup>.  
E, prierrë Allut, i tha:  
Ruej aprapa, zà :
70. Ndë mjergull çë kulloten  
s'ë ajo këtjetej,  
po ëshi buhua udhesh  
shkelura, si atej  
Abuxhafarri kcen  
me kuelt, me k'vjen.
71. Ndë vërtet buhua  
udhesh ka këmbë shkelur,  
Abuxhafarri njoi<sup>183</sup>  
me kuelt' egjer<sup>184</sup>, mbjedhur  
ka luft' e Ungerisë.  
Kì bie Arbërisë!...
72. Ndramendi, Zoti Alli,  
u thonja të shtinjem  
llajetë më karrumbull,  
kështu të mund lodhnjëm  
këta qen Arbreshë,

178) vërejtur  
179) të të ngrënët

180) në anë  
181) sheh  
182) të të lindurvet  
183) arriti  
184) me kuajt e egër

73. pak mbë hundë nesh.  
 Këshilli më pëlgjen,  
 tha Alliu; ushtra ime  
 përpara je të ngasë<sup>185</sup>:  
 Ni bë'tshtien shertime  
 Arbreshët. E na kalorë  
 i thérresmi'dalë t'e shorë<sup>186</sup>
74. me ne Skanderbeku,  
 nde daftë. Të përpinqshin,  
 ranë mbë shpor kuelvet,  
 parë shokvet të hilqshin<sup>187</sup>.  
 Mbë hundë sa u-rrunë<sup>188</sup>,  
 me shpatat s'u zunë
75. mbjatu; se Pashau  
 kalin mbajti e uli  
 shpaten, çë te milli  
 rëgjëndi e ari nguli,  
 e kështuna me golein  
 pa vlemë folen:
76. Ti shoku inë i heret,  
 Skanderbek i bushter,  
 këtu mos të'ndjesë  
 se së çon jushiter,  
 kuj kënda të vëhen  
 me tij se t'e shohen
77. me shpaten ... Gënjehe  
 nd'ashtu të fjandasen ...  
 Njo erthim t'e shomi  
 na çë me tij Asjen  
 një mot yumë përposh,  
 t'i rrij Feta kalosh.
78. Thom dhe se zgarrove  
 udhen ti e it nip,  
 çë aq lik u qelltit  
 orzen<sup>189</sup>, çë ju hip  
 ndër tru të na lëjet,  
 pra me ne t'e zëjet ...
79. Pruerit krahët Fetit,  
 zotit Amurat,  
 prana çë ju rriti

185) le të ecë

186) ta shohë (të luftojë)

187) që të luftonin më parë se shokët

188) sa arritën

189) në atë orë

- e dish<sup>190</sup> mirë si tatë! ...  
 Dini se kur bëhet  
 mëkatja, së shkohet  
 pa qarë e së vlen  
 të ruejturit e tënë<sup>191</sup>.  
 Sanënga râ ndër veshë.  
 Fetit çë qe bënë  
 ka ju, ju vù nëmë  
 të ligë më se gjëmë.
80. 81. Mos më spordnis... Qëtu,  
 thai<sup>192</sup> zoti Skanderbek.  
 Çë erdhe të më thuec  
 ti jatri, shok Buxek?  
 Ndë ç'u tha ke t'thuec,  
 le të vë<sup>193</sup> e m'ruec.
82. Ti kocëngatrimashi<sup>194</sup>  
 e t'rremashi, Alli,  
 tek ti kish 'më thoje  
 aq, pse lé ti  
 të rrëfienje pse më vratë  
 vlezrit, me çë i dhâtë  
 për grikje? Ti Alli  
 thuej pse na muer  
 Prinqepinë e Tatës  
 Ai iji mbaratûr<sup>195</sup>,  
 sa, 'losët ka helmitë,  
 Tata mbilli sitë
83. 84. gjelles? Pse së mbet  
 si t'kish qindruer  
 me Taten, ndje Zot?  
 Po sa vdiq, muer  
 ai çë neve ngit  
 e ruejti të na vrit  
 prana! ... Tre vlezer  
 më vrau! ... Tri hjé  
 trimash ata ishen!  
 E ruenej nënd dhë  
 edhë mua të shtij<sup>196</sup>! ...  
 Këto tru ai kij! ...

190) deshi

191) e tanë, tonë (-tënë-) për të rimuar me «bënë»)

192) i tha

193) le të vejë, ashtu qoftë

194) i keq, ngatërrestar

195) Perandori juaj

196) të më shytinte edhë mua

86. Thuej! . . . s'ë vërtet?  
Thueje, ti çë e df;  
ti çë ndér veshë i vëje,  
si villezrit e mi.  
edhë mua të vrit,  
se shumë keq të ndit,  
87. për se qellsha mirë  
e gjithë më këndojen  
e trimashokët jushët  
aq mirë më dojen.  
Së ish këshilli it  
çë fufnej nga ditë  
88. Feten' më dirgonej  
te mund isha vrarë?  
Ju ndit se së dukshit<sup>197</sup> ! . . .
92. Jo fjalë më Tringlin  
e shpates marrmi vesh  
ndë ktë' nderes shesh.  
93. Vi, ndë ju e popen . . .  
mbjatu tha Buxeku.  
Amës, u e sho me kët,  
ktu tha Skanderbeku:  
me t'rremin Alli,  
çë ë pjak e she' ti.  
94. Këtu ranë mbë shpor  
me shpatat e shkëlura  
ka millet e rëgjendë,  
tek qenë ngûlura  
kur zunë të folet.  
me k'mbratzin golet,  
95. njera e jetra pjesë.  
Kcien kuelt; u ngrenë  
qirithin e zëhshin  
si qen cë u ndërslen;  
e, si kalorit, hilashin  
me ënden të vritshin.  
96. Shtien shkëndila shpatat,  
te piqen; buxárshin  
sa sund bëjen mjekrat  
si parë të xhavarshin.  
Këtu çë më gjellen  
së ruejen, se i sjellen
97. ku më s'keqi presen,  
vozhetë vixhtojen<sup>198</sup>  
si kuelzit të zënet  
me dhëmbet, çë mbjojen  
me gjak, e trucatat,  
çë, si kaloqatat,  
98. kërsisjen tek rrashin  
me t'keqe egersi,  
çë<sup>199</sup> djalit spamin darnej  
ndomos se kanë bri!  
Aq kuel sa kalorë,  
çë rrashin me ferë,  
bëjen borë kë i vren.  
Kuelt, çë luftojen  
eger nend atire,  
mbarrarjen të cënojen  
shpatat, çë si pika  
bëjen ajrin çika...  
100. Kur vrej se s'bridhej  
me Amesen, zoti Alli  
ka kali u strushlär  
e i tha<sup>200</sup>; ktù bën ti  
e rri sa më të dueç,  
ndë kë çë të thueç  
101. shokut! U skaqár<sup>201</sup>  
e kalin la të zëhej  
me kalin e Ameses.  
Ki për' bë të shtëlløhej  
ka Alliu<sup>202</sup>, çë njator kal  
hipnej' lart si mal,  
çë një kriat i ndënej  
rranga se të iknej,  
me shpaten kriet kalit  
parë' Alliut, çë s'iknej,  
preu<sup>203</sup>. Kët të bënej<sup>204</sup>  
shkoi mot sa s'jarrënej  
102. Alliut, çë trakuloi  
e erru shokvet tij,  
çë ndë mest e kalltin.

197) Ju duk se nuk do të zbuloheshin mendimet tuajà

198) goditjet me shpatat ata i jipnin njerën pas tjetrës  
199) ashtu që  
200) dhe i tha kalit  
201) u nda nga kali  
202) ky kur po hidhcj drejt Aliut  
203) të parit kalë t'Aliut, që s'ikte, i preu kryet  
204) Ndërsa bënte ashtu

- Kështu Dekjes, c'i bij,  
pështoi nd'atë herë  
Alliu, çë u kish dhièrë  
104. mbëhundë Ameses trim,  
çë runej t'e shtij <sup>205</sup>.  
Ashtu dish' bënej  
Buxeku edhë. Te shkij <sup>206</sup>  
ka kali, Amesa i shpoi  
një krah e ja cënoi.  
105. Te bëj t'e furnonej, <sup>207</sup>,  
anti Alliut u stros  
e ndë mest e kalli  
e prana u frakos  
Arbreshvet kalorë  
me egersi e forë  
106. si maj njera ni.  
Më nget' thom si qe  
çë me aq arkanxje  
Turqit zunë atjé  
aq tharet e luftojen.  
Këta ahiera sofnej  
107. Amxarri i Abdullit,  
ç'Arabin hunj frijti <sup>208</sup>,  
për se Maumetit  
me fjalë nderen nxitti. <sup>209</sup>  
Kuelt e Abuxhafarrit  
qellnej hjea' Amxarrit.  
108. Ki <sup>209</sup> sa, si ka vinej,  
përsekzi Alli Pashan,  
kriatin e Parfjetit,  
çë l'an e ditës qan <sup>210</sup>,  
e s'mundnej t'e ndreqnej  
si ndër tru e keshnej <sup>211</sup>,  
109. là prapë Abuxhafarrin  
me Varken <sup>212</sup> të vinej,  
e si pikë u shkreh  
ka anti Alliut <sup>213</sup> hinej

205) ta shtynte

206) ndërsa shkiste

207) ndërsa ishte gati ta vriste

208) i cili rrahu Arabin

209) Amxarri

210) qante

211) e kishte

212) tradhëtar arbëresh

213) tek rreshti i Aliut

- ndë luftë. Sa t'errù  
mbi të, muer e e zù  
110. me gjithë hjenë e tij <sup>214</sup>,  
e i veshi nga jushter  
me forë shumë e arkânxe,  
se t'qellej e bushter  
ndë çeret kalërisë,  
të bilvet' Arbërisë,  
111. çë bëjen si e keqja,  
çë gjellat shtëllon.  
Axatrat e Pashaut,  
ç'Amxarri sistën <sup>215</sup>,  
si ka kuelt shtihshin  
me mallin të vritshin,  
ksaj ushterje për krei  
shpaten më e lüenej  
Nadhir Abiqi; ai,  
ç'u pa vetë 'ngrënej  
shpaten Sfetigrath <sup>216</sup>  
përparrë zotit math <sup>217</sup>,  
112. pra çë ki tha: «ju doni,  
shokë, na t'i hapmi  
zotit Skanderbek  
katundin t'ja japmi,  
se taksen të na ruenj,  
njari' mos 'na dënonjë <sup>218</sup>  
113. udhvët ka mbjidhemë  
ndë paq't 'vatres tënë?»  
Nadhir Abiqi këtu,  
te përgjegjet, ngrën  
shpaten lart e thot:  
Me kët ndér duer, zot,  
114. na të bushter ruemi  
katundin Sfetigrath.  
Ndë Skanderbeku ësht,  
si u kanos, i math,  
përparrë ksaj e t'vinjë <sup>219</sup>  
këtuna të hinjë.

214) me hijen e tij

215) ndihmon

216) në Sfetigrad

217) përparrë Muratit

218) mos të na dëmtojë

219) le të vijë

116. Ki me këto fjalë  
zotit math pruer  
trutë çë do't'hapjen<sup>220</sup>  
dierit katundit ruer.  
Pra, se mirë u qell  
te zdirth shpatë o hell,  
117. atjë pér nder t'Turqisë,  
të patë dhënë një ushter  
të qellnej: e me kët  
ni si burr i bushter  
vrehet të luftonjë  
e ca kalorë të shtëllonjë,  
shokë të Skanderbekut,  
118. kuj me llajenë stroset  
si grerëzish bletë  
e ngarë o e çifosset.  
Me ndihmen e Amxarrit  
hapi griken varrit  
119. të përpinqej Kuqen,  
kuj barkun' gjerë preu,  
sa gjithë ato përmbrënda  
ju derthtin pér dheu,  
kur ka kali tij  
kriengulen të bij<sup>221</sup>.
120. Kuqja prégjiritej  
me shpinë e Kastriotvet,  
ndemos se leu llargu  
ndë Katund t'Sulljotvet.  
Kur Skanderbeku vreu  
se t'vrarë ja mire dheu,  
121. me rrangonë të madhe  
një të keqen thirri,  
sa malet gjimuen,  
e tha: shokë, Mirrmirri<sup>222</sup>  
një trim, cëjeta qan,  
më votë këtu mbanë  
122. me shpan e atij Turku,  
çë barkun i preu!...  
Virviti e mos më leni  
të bët'e marr u dheu.  
Hurrah! Gjithë mbë shpor  
bini, shokë kalorë...

220) që donin të hapnin  
221) binte  
222) Hyjnisa vjedhëse

123. Ranë, me kuelt u strostin...  
Me thundra e dhëmbë thiejen.  
Turqit së t'i rejen<sup>223</sup>  
e me ejjet i bijen.  
Llajé-llajé i hjithshin;  
se prisjen 'bët' lothshin.  
124. Anti Alliut kështu,  
ndë kish pasur mot,  
kish lodhur e prierrë prapë  
Arbresh't me gjithë zot,  
çë bashkë me kuelt ishen  
t'lohtë keq, se kishen  
125. shumë herë cambatuer  
kalorë e kuel si ishen:  
Po gjella tire i qe  
Dusmani, çë ja shprishen  
përpara sa t'errën  
me kuelt, çë kish nën  
të prëret, se ahiera  
të paren herë hinej  
ndë luftë. E Duzmani  
shkoi zotit<sup>224</sup> të hipnej  
njater kal të zi  
si Korbi, q'lë e rrë:  
126. 127. E mbi kalin e prëret  
i pari ndëpër Turqit  
me shokët e Dusmanit,  
si llun ndëpër ulqit  
u zdarrangar e vrit  
e trëmbnej me thirrit<sup>225</sup>,  
çë malet llargu e rrëzë  
bën e rrukullojen,  
e jip arkanje shokvet  
e forë ka luftojen<sup>226</sup>  
ka nj'anë me Manxurin,  
ka jatra me Aqburrin.  
128. 129. Tue ngarë e tue vrarë  
si pika ka shkonej,  
Nadhir Abiqi edhë  
ngallosi<sup>227</sup>: T'ja pështonej

223) nuk i ndienin  
224) i shkoi Skanderbeut  
225) me të thërriturit  
226) ku luftonin  
227) u përpooq me të edhe Nadhir Abiqi

130. këmbet s'i vlien  
e i preu tundu krien,  
korbat e stravatonjtë  
se t'ja cimbisjen  
kur të piqej hera,  
çë të esur prisjen  
mbi ta tue rrotartur  
ka pendat të mbajtur.
131. J'arrú Skanderbeku  
me kalin e e shkeli;  
shpaten te girlaci  
mbalë arrzes i çeli,  
kriet i tundoi,  
mbë truell e qandoi
132. e i tha: Nadhir Abiq,  
së prisje të shinje  
zi<sup>228</sup> ka duert time!..<sup>229</sup>  
S'prisje t'vinje  
thertur si kaciq  
ka u, Nadhir Abiq!..
133. Sa të kish vller,  
ndë se Sfetigrath  
s'kishe dalë të dukshe  
më i urtë e më i math  
ti, mbë herë çë doj<sup>230</sup>  
zoti saj'm'e lëj,
134. mos'shprishej shumë gjak  
tëjshit<sup>231</sup>; se dij<sup>232</sup>  
me mot e mot katundi  
nënd meje kish'bij!..  
Sa të kish vlerë,  
ndë si shokët e tjere
135. qëtu kishe ndënjur  
ahiera, e s'kishe dalë  
me shpaten e ngrëjtur  
e me të egra fjalë  
trutë ti t'i prirnje!  
Nani ndë shpit inje<sup>233</sup>

228) të shihje zi, të shikoje vdekjen  
229) nga duart e mia  
230) kur donte  
231) gjak prej tuajve  
232) se ai dinte që  
233) ishe

136. e s'zëje botë me dhëmabë  
këtu!.. Tek i thoj  
kështu Skanderbeku,  
koca çë tundoi,  
dha si kur ndienej  
si e gjuhë tundnej  
si gjë t'i përgjegjej.  
Pra çë kështu me grunjë  
e nxerrë zoti math  
i tha, si bar pa rrënje,  
çë s'pret t'mund ngjallet,  
e là të rrij me djallet<sup>234</sup>,  
e shokvet, te ju pruer,  
i tha: na kemi liq  
të vrasmi gjithë Turqit,  
si kët Nadhir Abiq:  
Po si më ju vjen dreq  
me ta jini t'keq.  
Hurrah, përpara, shokë!..  
Vritni pa lipisi  
këta bilt e nëmes,  
çë Djallin mbë gjë  
kanë kunder nesh!..  
Përpara, shokë Arbreshë!..
137. Këtu, si lëshohet  
qina ka mali e vjen  
me dëm të math, Turqvët  
u strostin gjithë si qen  
e vrisjen kë i mbarrar  
e lëjen prapë tue ngarë<sup>235</sup>.

234) të rrinte me djajtë  
235) duke shkuar përpara

## KANGJELI I PESTË

### Përbajtja e KËNGËS SË PESTË

Lufta vazhdon e ashpër. Kalorësia arbëreshë bën kërdinë ndër turqit. Ndërkaq shpirti i Amxarrit, i Saidit dhe i Abutallebit llojnë nga burgu Muhametin profet edhe shpirrat që luftuan dikur bashkë me të pér të përhapur fenë e tij, se engjelli i Perëndisë, rojtar i burgut, kishte shkuar në ndihmë të arbëreshëve të kalorësia e Dushmanit. Këto shpirtra, nga një mal i Dibrës, vërejnë sheshin e luftës dhe u krijohet një përshtypje e keqe kur e shohin atë të mbushur krejt me turq të vrarë dhe arbëreshë fitimtarë.

Muhameti, sytë e të cilat venë te Kont Urani dhe tek i dhëndrri Nderush, që me guxim e me heroizëm luftojnë në mes të turqve, tregon pér lindjen e mrekullishme të Nderushit, duke përshkruar bukurinë e Juditës, nuses së Nderushit.

Pastaj, duke ju kthyer shpirtrave shokë, u thotë: Pa humbur kohë ne duhet të hyjmë të gjithë në mes të ushtarëve dhe të kalorësisë turke, e cila, e udhëhequr nga Abuxhafarri, po vjen te fjuadhi nga tri anët e Dibrës së Poshtme; ti, Abubekerr, im vjeherr, fyr tek Uxuni e tek shokët e tij, ti Omar zër Adhramanin; unë do të fij tek radha e Abuxhafarrit; ti mëmë Aminë, me Kadixhën time shoqë, ec e sill xoraidhën, të cilën dëshira e shtyn drejt Aqibës, i vrasë nga Skënderbeu; ti, Ali (i katërti kalif), me sytë e keq magjeps Skënderbeun; ti, Zemërim, e ti, Urrejtje, ecni përparrë nesh e silluni mirë sot! (str. 69-82). Si tha kështu, Muhameti bashkë me ato shpirtra u hodh nga mali te sheshi i luftës, po të gjithë u panë nga Feja dhe engjelli i Nderit, të cilët i goditën me një rrufe, që nuk i cënoi se ishin shumë larg. (str. 83-86). Ndër ata shpirtra që veprojnë ndër luftëtarët, Aliu i kall sëmundjen Skënderbeut, që e ndjen tërë trupin si të këputur dhe forcat të humbura. I ndihmuar sëga i nipi zbret nga kali dhe mbështetet mbi një gur nën një lis, që u quajt pastaj «Lisi i Skënderbeut». Atëherë Skënderbeu u kujtua se kishte pranë një relike të shenjtë, që i kishte dhënë një murg

dhe e puthi duke ju lutur Shën Janit. Ky i jep urdhër Fitores dhe kjo, me rrezet e shpatës, verbon Aliun.

Skënderbeu me një të teshtitur të fortë shporr hundësh të marrurit sysht e, si falënderon Perëndinë, hyp mbi kalin dhe hyn në luftë, si një luan i liruar nga prangat. (str. 87-121). Po, tek ishte duke vrarë turq pa numër, arrin një lajmëtar i dërguar nga Kont Urani, i cili kishte parë që prej së largu po vinte kalorësia turke si re e zezë. Skënderbeu porosit lajmëtarin t'i thotë Kont Uranit, që të bënte si të bënte e pastaj të shkonte shpejt tek ishte Dukagjin, i fshehur nga e djathta e Dibrës me 2000 kalorës, dhe t'u sulej turqve nga një anë kur të shihte se Skënderbeu do të zmbrapsej me arbëreshët sikur të ishte trembur. Pastaj urdhëron kalorinë e tij të shkojë shpejt nga ana tjetër e Dibrës, ku është fshehur Kakarla me dymijë kalorës të tjerë; t'u sulet turqve, si dhe Dukagjin nga ana tjetër; të vrapijë pastaj drejt vendit ku gjendet Moisi Golimi, i fshehur me 3000 kalorës dhe disa këmbësorë; t'i urdhërojë të hidhet në luftë prapa turkut dhe t'ua presë ikjen kur të dalin kaloritë arbëreshë nga pylli. Lufta vazhdon. (str. 122-136).

122. Ka Turqit u lëshua<sup>236</sup>

e shpan damaskine  
i zdrith e sarua  
i vrit e skotisnej

123. si detit rrëmbitim  
qina, që ka malet

hjidhet; e si era  
shkunden portigalot  
e lulct, ai nxinej  
llajetë, kuj binej  
me shokzit gjiri,

124. Te si pikë me vrer  
ai vrit, një kurrijer,

si ka Kont Urani  
dirguer, më j'arrën.

I tha: kalorit Turq  
ka gjithë anat njónë...<sup>237</sup>  
Zot, si kem' bëmi?  
Kemi të dirgom

236) është fjala për Skënderbenë

237) kalorësit turq arrijnë nga të gjitha anët...

126. edhè na tatáré,  
kalorit tané tē dalen  
ndér anat tē piqen?  
Thuej!... Mbjatu fjalen  
tende marrmi vesh  
na gjirité Arbreshé.
127. Zoti mbajti kalin,  
zú mjekren me doré,  
e shtú sité ndér anat;  
sité çé bëjen boré  
até kuj ja prir  
eger. Mirë-mirë  
ruejti e përseksi  
kalorit, çé vërtet  
vijen me leng shumë,  
si suvalë mbi det:  
edhè Allin, çé vej  
pëprara e i dil, vrei;  
e i tha: Ti tatár,  
te Kont Urani ngit  
e thuej si u tē bënjë<sup>238</sup>.  
Pra mbé karrerë shkit  
ka e djathta, ku gjén  
Dukagjin, me nënë  
dimilet kalorë<sup>239</sup>  
ndér dushqet magartur.  
Ti thueji tē dalé  
kur, u, si i kakartur,  
asikuna tē ngurem  
e'lë, si i smurem,  
lufen me kta shokë.  
Tatár, ti anangasu  
e bën çé qe thënë.  
U s'të thom xathu,  
tē ngaç më karrera,  
se jé kalor. Si era  
ngjesh atjé f'terrénjesh.  
Ti kriati im kalor,  
ka jatri krah i Dibres  
zitu e thuej tē lërë  
dushqet Xakaria  
kur'shorë<sup>240</sup> se kalëria

238) të bëjnë si po bëj unë

239) Dukagjinin me 2000 kalorës nën atë

240) kur tē shohë

133. jonë mbë hundë Tûrques<sup>241</sup>  
pak mbanë. Pra rrangár  
ka Mosë Golemi,  
me axatrat u magár...  
thuej ndér krahët' i dalë  
kur njera e jetra shalë  
e balla turk cënohen  
ka helet, çé shpojen,  
e shpatat, çé ndajen,  
e kuelt, çé shkrefndojen  
të ratit, çé presen  
edhè tē mos' vdesen.  
Kriat m'u anangàs...  
Fort një spirunatë  
kalit kalli e ngau  
i bushtri kriat  
ka gjiegj se kish'vej,  
të nisnej kë duéj  
ndë luftë. Skanderbeku  
me Gavnjinë u shtu  
prana mbrej Turqit,  
si liun me ù  
mishi. Si pika vrit  
llajetë nd'atë ditë.

241) kalorësisë turke

Mësimdhënies shtetërore e Shqipërisë  
Fakulteti i Shkencave Politike  
Instituti i Studimeve Politike  
Buletin i studimeve politike  
Shkolla e Doktoraturës  
Rendimi i 18 korrik 2003  
Të gjithë të mbarësuar

## KANGJELI I GJASHTË

### Përbajtja e KENGËS SE GJASHTË

Aliu mbledh këmbësorët turq bashkë me kalorësinë e Abuhafarrit, që kish arriut atëhere ndër sheshet e Dibrës së Poshtme, e pasi i flet për dëmet që kishin pësuar turqit nga kalorësia arbëreshe, e urdhëron atë të luftojë me kalorësinë te mesi i rrjetimit; Uxunin të mbajë të djathtën e Dibrës e Adhramanin të mbajë anën tjetër. Prapa këtyre do të qëndrojë Aliu me këmbësorinë e tij, të cilët do të zhvishnin të vrarët e të plagosurit arbëreshë. (str. 1-24). Sulmi është shumë i vrullshëm nga ana e kalorësisë turke, po Skënderbeu u jep urdhër arbëreshëve të bënin sikur do të iknin, për të tjerhequr turqit në vendin ku ishte fshehur kalorësia arbëreshe. U mburrën turqit kur panë ikjen e arbëreshëve dhe besuan se fitorja ishte e tyrrja. Po kur arriten atje, Skënderbeu me të tijtë u ktheu ballin turqve, përti pritur me guxim. Lufta shpërthen e ashpër, meqenëse edhe Zemërimi e Urrejtja bashkë me Fetë luftojnë mbi krye të ushtarëve. Dallohen për guxim Kont Urani, Komneni, Nik Peta, Nderushi, Dushmani, Hamza e të tjerë. Edhe Skënderbeu përpinqet me Abuxhafarin, të cilat i pret kryet. Kusibani i qaset Abuxhafarit. Lufta vazhdonte kur arriti Xoraidha me pesëqind kalorësit turq. Buxeku, i plagosur nga Hamza, e lajmëron se Aqiba ishte vrarë nga Skënderbeu, dhe Xoraidha, para se të hyjë në luftë, shkon shumë e hidhëruar të shohë kufomën e të dashurit të saj.

1. Si krushqit kalorë  
jashtë katundit errëjen  
përparrë shpisë nuses  
të marren, e gëzojen  
me të 'rrënet shpinë  
e saj e gjitoninë,
2. që duhet me vashen,  
që llargu ka të verë;

- kalorit turq errunë  
tek Alliu ka-herë  
i doj: e haretë  
shprishtin ndër llajetë  
3. axate, që i lusjen  
me të ndihmes unë;  
se s'dojen më shkelur  
ka kuelt. Sa errunë  
gjithë krerat xhirartin  
Allin e kuelt mbajtin  
4. se të mirrjen vesh  
këshillin e Alliut,  
që ndë mes t'atire  
me harenë e miut,  
që maçes pështoi,  
rrij, e të thoj  
5. mbajtu atjë s'zù<sup>242</sup>,  
se kalorit vrei  
gjithë që vëjen ré  
nxërrartur atej  
ka Albreshët rrjh'jen  
e vdekjen shprishjen,  
6. si gjëmbat i Larti  
shtie të cënojen  
kavshat e njerzit  
8. Krei Abuxhafarr  
njohu ndër të paret  
çë grah'jen, Skanderbén  
ka t'veshurat e aret,  
ka ejjtë çë shkëlqejen  
e Dekjen më shtjen<sup>243</sup>;  
9. ka pendat 'Airunit  
çë kësulen i ndërrojen;  
ka kuturnet'verdhë,  
çë këmbet i mbathjen,  
e shokvet ja buthtoi  
me shpaten, e: njoj,  
tha, Burri, që do shtënë  
sot, 'mund pushonjë<sup>244</sup>  
Turqia. Ndë s'raftë

242) dhe nuk i foli shpejt

243) shtynin më shumë

244) të mund të pushojë

- sot, ka tē duronjē  
 Turqia shumē lip  
 tē tharet si krip  
 11. mbi zgarrezat shtenē.  
 Vi, ēmna udhen tēnē<sup>245</sup>,  
 ti zoti gjuhagjegjur  
 Alli. Ka t'jetē jona  
 ndera ehjvet sot,  
 ndē daftē Inzot!  
 12. Te kētu -ashtu qoftē-  
 thanē gjithē krerat' tjerē,  
 çē Allin xhirarjen  
 me kocen zbuluer,  
 e me shpatē shkulur  
 e ngrējtur mbē t'sulur,  
 13. Alliu zú tē folet:  
 -Shokē, eh kush e prit  
 helmin çē psuem  
 na sot!... Kur ngit  
 ushtra jonē ndreqr,  
 ka mixorit shehur  
 14. njē e keqe vrundullerē  
 udhet na kēputi;  
 pērpara na rruzharnēj  
 e te karrabuti  
 kētjetej gramisnej  
 çē do i mbarrisnej.  
 15. Mbēhundē kētij vreri  
 i hunduer qindrova  
 caherē prana shokēt  
 tē mē gjegjen mbjodha.  
 Te folnja, e vrundullera  
 qindroi, vremē karrera  
 16. kalērinē arbreshē'sultē<sup>246</sup>  
 neve axatra; e zú  
 e bēri çē mē dish  
 mbi nē e na shtū  
 po krera e po llajé  
 çē qellshin me hjé:  
 17. Ahmetin, Kardamōn<sup>247</sup>,  
 e Aqiben mē s'kanē  
 shokēt, mē s'shohen

245) po, jipna udhēn tonē, lerna tē shkojmā  
 246) tē sutur  
 247) Kardamonin

- Abullin, Llitamán<sup>248</sup>,  
 Usufin, Llibemin<sup>249</sup>,  
 Tullunin, Alladhin<sup>250</sup>,  
 18. e aqē e aqē tē tjerē,  
 çē sund némrohen<sup>251</sup>,  
 Thot sa dēme bēnē  
 fora me'shtellohen<sup>252</sup>  
 Arbreshēt çē somenatē<sup>253</sup>,  
 tue zdredhur atō shpatē  
 19. mbi trimat burra' tanē.  
 Amesa Buxekun  
 ndē krahut na lavosi  
 kur me Skanderbekun  
 tē dl vamē t'e shijem<sup>254</sup>  
 e s'mundtim t'e shtijem.  
 20. Atē kush e minden?  
 Atej mbatanē ruhen  
 dēmet çē na bēri,  
 e edhē na paguhēn,  
 ndē daftit Parfjeti  
 Amin Maumeti<sup>255</sup>.  
 21. Po zitu, Abuxhafarr,  
 e zē tē lufes mesin.  
 Uxun, zē tē djathen,  
 se tē hapmi thesin,  
 çē rrēmben ndē mest  
 Adhraman, me ngrest  
 22. ngjesh ka jatr'anē  
 e Dibres. Inzot  
 ndē krahut tēj<sup>256</sup> qoftē  
 e ju bekofte sot.  
 Grahmi!... Gavnjemi,  
 se kalorē jemi.  
 23. Ndramendi çē llajetē  
 axatu mbjeth e siell  
 aprapa tue xheshur

248) Llitamanin  
 249) Llibeminin  
 250) Alladhinin  
 251) qē nuk mund tē numurohen  
 252) me tē cilēn sulen  
 253) sot nē mēngjez  
 254) shihnim  
 255) Muhameti, i biri i Aminēs  
 256) pēr krah jush

- të vrarit<sup>257</sup> e kë viell  
gjellen, si ka Arbreshët  
strosi, e si deshtë
24. me kuelt e me shpatat  
e tire trucârni:  
Hurrah, kalor't e mi,  
suli t'i kakârmi.  
Gjithë të bushter jini  
ju: ecni, vi e e shini<sup>258</sup>.
25. Hurrah!! Gjithë Hurrah!!  
ture thirrur Turqit,  
shokët'Abuxhafarrit  
u strostin, si ulqit  
ka kavsha, ka jesh<sup>259</sup>  
Zoti-Math Arbresh.
26. çë humbijen e vdekjen  
zdrith e trëmbësinë,  
e gjithë vëj përposh  
si moti me Spirin.  
Eger ka e djathë  
Uxuni trush-athta
27. ashtu u stros Uranit,  
çë gjithë vëj përposh  
bashkë me Nderushin,  
arabit kal kalosh.  
Ka rröh Arjaniti  
llajetë e tij virviti
28. i keqi Adhraman.  
E Turqit të vejen  
të celur e'ngjallur  
ka djelit<sup>260</sup>, çë i qelljen  
Arbreshvet ndë ceret,  
dha si vrundulleret,
29. çë shpirrat e Eres  
shtijen të thartojen  
pagen e detit,  
e njerzit çë e shkojen  
tue vrerë ujë e qiell,  
priën t'i përciell

257) të vrarët  
258) po ecni dhe e shihni  
259) nga ishte  
260) djajtë

30. me grikën e erret,  
çë, parë hapët, vret<sup>261</sup>  
me drithmen e keqe,  
çë gjellat' pret<sup>262</sup>.  
Me kaq egërësi,  
forë e trëmbësi,
31. pas Nxerres e Mixires,  
çë si kukuvele  
përpëra i fjuturojen,  
me kocen si dele,  
e me brite'dredhur,  
tharti tue derdhur,
32. kalëria turkë<sup>263</sup> grahnej  
mbëhundë Arbëreshvet,  
çë Turqvet çajen  
buzë e bri si deshvet,  
e barkun i shkeljen  
e nisat i rëmbejen.
33. Kur Skanderbeku vrei  
këta për me afruer<sup>264</sup>,  
tha shokvet: ja veshmi  
asikuna. I pruer  
atej si kâ u zdroth  
mbi ta<sup>265</sup> e t'i hjoth  
vrerin. c'i skotisnej.
34. Edhë Kont Urani  
e Arjaniti krahët  
i pruertin e «ngani»<sup>266</sup>  
Turqvet me trû,  
i thojen, te, me ú,
35. korbat e stravatonjtë,  
më të math, ju presen<sup>267</sup>.  
Ndë ktë vrerë Turqit<sup>268</sup>  
zunë gjithë e thëresen,  
prë harë: Gavniem!..  
Për leshi i rrëmbejmë

261) e cila, haptazi, vret njerun

262) pret

263) turke

264) që po afroheshin

265) i ktheu shokët andej nga ishte sulur mbi ata

266) ejani

267) ku korbat dhe sqifterët me uri të madhe ju presia

268) në këtë pamje turqit

36. gavnjinë Arbreshvet,  
ç'i ndihu njera nii!..  
Skanderbekut thojen:  
Pritna, qen, rri.  
Rrina, qen kakat,  
t'e shomi me kto shpatë.
40. Mère èni<sup>269</sup>, pordhullarë,  
e grahni më me ngresë,  
Arbreshi thoj me trù;  
u këtjetëj ju pres.  
Ndë trakulatë ju dua  
t'e shihni ju me.mua.
41. E Turqit'j'arrëjen<sup>270</sup>  
më grah'jen e ngjeshjen.  
S'pandeh'jen se Arbreshët  
sikuna ja veshjen;  
e, si të kin gavnjier<sup>271</sup>  
ahiera pa luftuer,
42. të ratit e Gavnjisë,  
tue i bënë këmbë<sup>272</sup>, frijen  
me brirat te buza.  
Buhjisjen e vurrijirjen  
si kur të gjimonej  
qielli; e rrukullonej
43. mali si gjithë ulqit  
e jetës kish mbjedhur.  
Sa te llaka'ngushtë<sup>273</sup>  
ndër anat'gjelbëruer  
me lisë, fage e qarre,  
me fjetëgjerë e shparre,
44. errù Skanderbeku,  
kurrjeret, dirguer  
të nisjen kalérinë,  
çoi, e, jéshurbier,  
Zot, i thanë: njoj,  
dha si hera e doj,
45. kalëria<sup>274</sup>; e Golemi  
ë lestu të dalë,  
sa nënga të rrëmbemi

269) ejani, more

270) të ja arrin

271) sikur të kishin fituar

272) duke ndjekur këngën e Fitores

273) e ngushtë

274) pikërisht kur duhej arri ti kaloria

- ka njera e jetra shalë<sup>275</sup>  
e ka balla, t'i bjerë  
Turqvet skundervjerë,  
46. çë njonë me kaq arë  
e mëndash ndërruer.  
Kriat, èmë<sup>276</sup> kalin  
çë ë ka Qifti lerë  
ka Qifti çë luftoi  
nënd meje e shtëlloi  
ndër Turqit Persjot'<sup>277</sup>,  
çë Amurán ruejen<sup>278</sup>;  
thom: Zamsen e Jajen,  
çë dekjen kërkojen  
ka ditë e t'e gjénë  
ka u si e duején<sup>279</sup>.
47. Kriat, ti m'e potise?  
Eme, vi, t'i hipem.  
Vi, shokë, priermi çerë  
Mixorvet!... si u shtihem  
strosi e kush jini  
vëni ré e bini.
48. Hurrah, shokë, hurrah!..  
Me mua, shokë kalorë.  
Dalen shokët e tanë  
ka njera e jetra dorë  
e i kallmi ndë mest:  
si maçet ndë thest
49. këtire Turq biemi<sup>279</sup>  
Golemi prapa i zë  
e udhet i mbullin<sup>280</sup>.
50. Sa antet u'rrunë<sup>281</sup>  
si lumet mixore,  
kuel e burra zëhshin  
me egarsi e forë:  
Vëdekjen gëzojen  
e varret zbulojen

275) jipmë

276) persjanët

277) që ruanin Muratin

278) si e donin («duejen» — për të rimuar me «kërkojen»)

279) t'u biem

280) i mbyll

281) u arritën, u takuan

66. me ehjat, çë zdridhjen.  
Uxunit ka e djathta,  
ka Abubeqrri<sup>282</sup> shtijturi,  
me trú keq të athta,  
i bij Kont Urani,  
kuj Nderush titani
67. i jip luftë'madhe,  
për mallin e së biles,  
çë zëmren i muer  
me hjetë e trendafiles,  
çë t'e zbukurojen,  
sa gjithë sitë kallojen.
68. Kët vashë, se të kish  
me qiqet, Nderushi  
përparrë si pika  
shtihej, si i dalë trushi  
me kalin e vrit  
me ehjen, çë kërsit
69. askandresha mbaru  
e shtij<sup>283</sup> trëmbësinë  
si gjetek Skanderbeku,  
me shoqe Gavnjinë,  
bij Abuxhafarrit,  
çë humbjen e zjarrit
70. zdrith te mesi lufes,  
i ngrohur ka Amini,  
me gjithë antin'math,  
çë kish, e, «shokë, bini  
Arbreshvet», sa thoj;  
«Bini, Turq: shkoi
71. hera çë na shkeljen  
axatrat e qeshjen  
mbi në e e gëzojen.  
Bini... Një si xheshjen  
gjellat e si bien,  
te shpata jonë thien... .
72. Si suvalë e madhe  
këtu Arbreshët sulshin;  
si ulqit ndër dhentë,  
ndëpër Turqit ngulshin  
eger e vrisjen  
e shpojen e prisjen,

282) I vjehrri i Muhametit (profet)

283) dhe shtynte

79. si kush rrungon ferra  
o kùeren ndër copat;  
e varra gjak mbjojen  
e dherat e gropat  
e ajrin me rëkime  
me thirrma e ksime.
80. Këtuna Sipërbi<sup>284</sup>,  
çë mesarënë mbanëj<sup>285</sup>  
mböhundë Skanderbekut,  
se t'mund i skriarnej  
të pakzit kalorë,  
çë qellnej me forë,
81. ngau përparrë gjithve  
e shokvet kalorë,  
Majde! Ju ngalesenj<sup>286</sup>,  
i tha, e ngrëjti dorë,  
te Feta, ndë s'bëni  
na përposh të vëmi
90. këta pakez qen!  
Karrumbull m'i suli,  
t'i lodhmi, t'i ngurmi....
91. Si gjalpre m'i nguli  
anamesa; i zeni,  
i bini, mos i reni.
92. Këto fjalë llajetë  
e shpirtrat çë i mbajen,  
sa gjegjtin, sarua  
u strostin të cajen  
antet' Skanderbekut  
e lakun ndë xerkut
93. t'i shtijen.....
96. Këta<sup>287</sup>, si tre ulq<sup>288</sup>  
të pjela, foren turq<sup>289</sup>
97. prit' tin<sup>290</sup>... U përpotqin...  
i ranë... i gramistin  
ka kuelt e një pjesë

284) këtu Abuxhafarri krenar

285) që mbante mezin e luftës

286) ju padit, ju akuzoj (përparrë Muratit)

287) Eshtë fjalë për Dushmanin, Nik Petën e Hamzën, që luftojnë në  
krah të Skënderbeut.

288) si tri ulkonja

289) vrullin turk

290) pritën

- të dhjerë sparrangjistin.<sup>291</sup>  
 Kështu zoti errú  
 te Abuxhafarri e u zú.
98. Të di vixtojen  
 vozhetë... Me anqilet  
 ruhshin e ngjatjen  
 frimen e ndér ilet  
 fuqizen, çë kishen.<sup>292</sup>
- Me kta ahiera ishen
99. Amini e Gavnja  
 mbéhundë, çë e shijen<sup>293</sup>  
 burrusht e ngjethjen  
 antet, çë i shijen  
 të keq luftorë<sup>294</sup>  
 me jater jetje forë.
100. Këta' jetes jater  
 di burrat dritësojen  
 me hjezit e tire:  
 Si 'ta i figurojen<sup>295</sup>.  
 Shpatat bëjen dritë  
 si gjëmat' qellit.
104. Di krerat luftorë,  
 të veshur ka di hjetë,  
 te si gjele ruhshin  
 e rrashin; si dét<sup>296</sup>  
 i thartuer buhjisjen  
 shpatat, çë dón'vrisjen<sup>297</sup>,
105. e njera e jetra pjesë,  
 ç'in<sup>298</sup> me ta, ruejen  
 nganjë nderen'tire,  
 të kallnej të huejen  
 përposh. Po t'qeshjen  
 di pjesët tek jeshjen<sup>299</sup>.
106. Gavnja një, vërzilë  
 gjimoi Maumetit:  
 Koca Abuxhafarrit,  
 si koka piretit<sup>300</sup>,

291) që e shihnin  
 292) këta të botës tjetër, Amini dhe Fitorja, ndritain dy burrat me hi-  
 jet e tyre, merrnin tytyrén e tyre  
 293) si dét  
 294) që donin ta vrissin  
 295) që ishin  
 296) ndërsa ishin duke qeshur të dy palët  
 297) si pema e limonit fëmbël

- e prerë dish, u ndá  
 e si ka kall rá,  
 me haretë e Turqvet<sup>301</sup>,  
 rëndë si bredhi bie  
 i prerë, o si timba,  
 çë ka mali u shqie,  
 me ehjat<sup>302</sup> çë buhjistin  
 e bashkë u gramistin.
127. Mjezdita hjemadhe  
 ruenej nd'atë herë  
 si ka rrëthi Qiellit,  
 me gjithë hjetë e Diellit,  
 jo Turqit, jo Arbreshët,  
 çë egër luftojen.  
 Ka krahëzit e Turqvet  
 Xoraidhen rrij e ruenej;  
 Xoraidhen kopile  
 si dorë trendafilë<sup>303</sup>  
 e hjeshmeze e mirë.
128. Vasha limonore  
 përmall të Aqibës  
 vinej luftore,  
 trimin të gëzonej  
 e Dekjes' ja lëshonej
129. 130. ndër lufat e egra,
131. Vasha atena ngit<sup>304</sup>  
 me pesëqind kalorë:  
 E eci natë e ditë,  
 mallit të j'arrënej;  
 trimit, çë s'j'arrënej
132. mbatanë, ka kish ngarë,  
 si ill i perënduer  
 te sitë më s'e shohen ...  
 Vashë, ... priru ... s'é herë:  
 me heren çë shkoi,  
 illi it trakuloi,
133. e më s'e shë. S'gjegj  
 këto fjalë, ç'i thoj  
 ka degazit zogu,

298) dhe ra nga kall duke u sjellë hare turqve  
 299) me shpatat  
 300) si tulë trëndafilash  
 301) vente andej

- ç'ë vrei si luftoi  
 Aqiba e si vrit  
 me pakë shokxit <sup>302</sup>  
 134. Po ngit me kushrin,  
 çë doj si vëllá,  
 pér krei pesëqindvet,  
 çë shokë me të ká:  
 janë asish çë haj  
 me bukurinë e saj.  
 135. Me këta Aqibes sill  
 edhë turresët, çë muer  
 ka thesari t' jatit,  
 çë proksenitë i pruer  
 gjithve, çë dirgojen <sup>303</sup>  
 se nuse atë dojen.  
 136. S'dij më limonorja  
 çë të vith, të sill  
 trimit të mirosur  
 te luca gjak, si ill,  
 çë ka retë u lëshua  
 e ndë dét u shua.  
 137. Sill edhë ngrakuer  
 dhjetë mushka me mëndashta,  
 ç'ë nguqjen si shega,  
 ca e ca si kashta  
 verdhjen; gjithë të ler  
 ka të sajet duer.  
 138. Me këta, pas lufes,  
 prit malli bë't' ndërronej <sup>304</sup>,  
 e ndré katunde llargu  
 me të të gëzonej  
 gjellen e thartuer  
 ka shortja saj mallkuer.  
 139. Me këtë trú vasha,  
 llargu ka shpia saj,  
 vej t'errënej mallit,  
 çë zëj bota e i haj  
 ndë lucët gjakut tij,  
 ku ngritë pa kocë rrij. <sup>305</sup>  
 140. Mbi kalit vej e para  
 e bukur e mes-hollë:  
 Faqezit e kuqe

302) me shokët e pakët

303) gjithë atyreve që dërgonin

304) priste të kurorëzohej dashuria

- e t'ëmbla si mollë,  
 Suvila, çë e qellnej  
 pas mallit, ja çelnej <sup>305</sup>  
 141. me gasin e hjevet,  
 çë ëndat zgjojen  
 e truzit çikarjen  
 të bë't' shkarpalojen  
 të zënít <sup>306</sup> e mjerë,  
 çë dhjesen Shëjten Nderë <sup>307</sup>  
 142. Edhë Kadixhaha  
 Xoraidhen me hjenë  
 e saj zbukuronej,  
 si vashë sund jenë.  
 Mjezita e hunduer  
 sund ndëndej tue ruer  
 të bukuren, c'rrënej  
 ku shi' aqë gjak Turqish,  
 si kavshje të thertur  
 ka bil dushqish <sup>308</sup>.  
 Sa vreri i që dukur,  
 shtu lotë me sitë e bukur,  
 çë gjellat shërojen  
 e zëmrat' eggersuera.  
 Trimat shokë qajen  
 kur e helmuera  
 shtij lotë me ata si,  
 çë i mbajen me magji;  
 145. e tue shkuer, kirkohen  
 të gjëjen ndonj' nxinjall <sup>309</sup>,  
 çë t'i kallzonej fán <sup>310</sup>  
 e hundirnit mall <sup>311</sup>.  
 Tue vatë pra ja xunë <sup>312</sup>  
 sa te Buxeku errunë.  
 146. Kët lavostë ka Amesa,  
 gjén nën një spërvjér,  
 ku i lajen e i lidhjen  
 ca shokë ku ish prerë.

305) ja ndezte

306) të rënët në dashuri

307) të cilët zhyejnë (turpërojnë) Nderin e Shenjtë

308) nga njerëz të egërsuar

309) shenjë, gjurmë

310) fatin

311) e të dashurit të shtrenjtë

312) ja thanë, e lajmëruan

- Buxeku, çë t'e pá  
si do u qell e rá
147. Aqiba, ja rrëfiejti  
vashes ç'e zu fill.  
Sa gjegj ajò qindroi  
pa golë e pa këshill,  
pra çë me thirmë' fortë  
tha: «Mall, s'pami short»<sup>313</sup>.
148. I kushériu e shokët  
e mbajitin e e ultin  
mbi një bazul guri,  
çë nd'atë spërvier ngultin,  
ku vetë një thron ish,  
çë nën Buxeku kish.
149. Pra me nj' sinodhi,  
ç'i dha zot Buxeku,  
një pjesë vanë e çuen  
kë vran Skanderbeku,  
çë, ku lufa zinej,  
murra murra vrinej<sup>314</sup>.

ndi Turq Ben mëllimini kundër shkakut që gjuhët turqimëk kalojnë  
dhe ndë mburg ulqinom Shqipëri vendosat. Kërcipaqol shklopja e qëllimit  
turqimëkun këshiqes Sulejmanit ka qendur me vërtetësisht, mësimi këshiqëve e  
turqit. (str. 1-24, 29)

## KANGJELI I SHTATE

### Përbajtja e KËNGËS SË SHTATE

Duke vazhduar lufta me egërsi, Nderushi në një dyluftim vret Uxunin. (str. 1-27). Zemërimi dhe Urrejtja i nxitën turqit kundër arbëreshëve kur panë se Uxuni ra. Por Nderi dhe Dashuria e madhe i gremisin ata në fund të dheut, duke ua pastruar ajrin arbëreshëve. (str. 28-37). Ndërkaj arrijnë në ndihmë, nga e djathta, kalorësit arbëreshë drinotë të fshehur, me në krye Dukagjinin, i cili pret Hasanin. Këtu Turqit marrin vrull e luftojnë me dëshpërim, duke vrarë shumë arbëreshë drinotë, prandaj Kont Urani u dërgon atyre në ndihmë të dhëndrrin Nderush, i cili vrapon atje me 5 Groprat, vëllezër trima dhe me 10 kushérinjtë e tij. Si arritën nën hundë të radhës së Mehmetit, arbëreshët morën frymë e, duke u hedhur si luanë, zunë të vrissnin shumë turq. (str. 38-67). Edhe Perëndia, që me dylbi vështron sheshin e luftës, duket se nuk ka mëshirë për turqit, ndërsa Muhameti nuk ka më fuqi t'i ndihmojë ata. (str. 68-83). Pastaj Nderushi përpinqet me Mehmetin dhe i pret kryet, duke shuar vrullin e kalorësve turq. (str. 84-90). Ash-tu në mes të luftës Skënderbeu përpinqet me Kusibanin, me të cilin kishte qenë shok ndër luftërat e Sultanit kundër Evropës e kundër Azisë; pas shumë të sharash Skënderbeu i pret kryet Kusibanit. (str. 91-123). Në këtë kohë arriu në luftë Çernoviçi me një tjetër pjesë të këmbësorisë arbëreshë, të fshehur nga ana e djathë e rreshtimit arbëresh, ku lypsej më shumë ndihmë; në të njëjtën kohë arriti gjithashiu nga e majta Lek Zakaria me ushtarët kalorës në ndihmë të Komnenit, që luftonte karshi Adhramanit, heroit turk në luftërat kundër Misisë. (str. 124-142). Si u përpoq Xakaria me Adhramanin, e shau atë bashkë me Turqinë, se nuk donte të largohej nga Arbëria: «Na duemi sa më jini këtu' bë't xëni-se ki dhë i ini-e duemi tò na e lëni». (str. 147). Po kur ata po ziheshin, si ushtarët turq edhe arbëreshët u sulën në ndihmë të kre-rëve, duke luftuar në mes të tyre. Kur luftonin dy anët, Arlaniti u përpoq me Adhramanin edhe e vran, duke i shpuar krahërorin. Turqit, të zënë nga tmerri, po iknin kur arriti Xoraidha me pesë-

<sup>313</sup> nuk patëm short, nuk patëm fat

<sup>314</sup> vriste

qind kalorësit turq, e cila kishte vajtur të shihte më parë kufomën e Aqibës kryeprerë. Atëhere turgit morën guxim dhe nisen prapë luftën, duke përballuar me shumë ashpërsi arbëreshët. (str. 143-185).

38. Shokët e tanë njonë <sup>315</sup>  
çë siell Dukagjini,  
u gjegj këtu të thonë:  
Shokë, na eni e vrini <sup>316</sup>:  
*Një si mbëhundë nesh*  
bien kta Turqesh <sup>317</sup>.
39. Me ashtat ndër duer  
gjithë gjirit kalorë  
atej e këtej falshin  
tue marrë forë.  
Sa te lufa vrisjen  
shokvet i thërrisjen <sup>318</sup>:
40. Si një milë të mira,  
eni !!! Mirësevini,  
gjiritë e tanë' lusur !!!  
Eni, shokë, e vrini...
45. Të pritur e Tusur  
si këto qerre deti  
ka gjindja çë esur,  
Driniotë gjithë vijen  
ka gjiritë' e shijen
46. me aqë si lliunra <sup>319</sup>.  
Driniotë mbë karrerë  
grah' jen: llaftarisjen,  
ture vatë si erë,  
kuelzit çë ngrëjon  
kriethit e Ingëlljen.
47. E rrëjen si suvalë,  
tek lufa hijen:  
llajetë mixorë zunë  
mbjatu prapë e shtjen.  
I pari Dukagjini,  
ture thënë: bini,

315) arrijnë

316) ejani këtu me ne e vrini

317) «turqesh» — për të rimuar me «nesh»

318) luftëtarët arbëreshë duke vrarë turq, thërrisnin shokët

319) driniotët vinin atje ku gjiritë arbëreshe luftonin me aq turq si luanë

48. ka kali gramisi  
këmbalarta Asán,  
kuj ka herë Nderushi  
i kish vënë than <sup>320</sup>,  
t'e vrit, e t'errënej  
s'patë ngenë çë donej,
49. për se shumë llargu  
si ka ai luftonej,  
e si lliun ndër dhen  
mbë truell i shtëllonej  
me të keqe forë  
gjirizit kalorë,
50. çë ksaj gjellë birshin  
si ilez çë shkojen  
e venë ndrishe jetë <sup>321</sup>,  
dritë se t'i ndëjen.  
Shortja, çë na rrëmbën  
adhazmu e na lirën,
51. këtu Dukagjin  
dish' dritnej të vrit  
Asanin <sup>322</sup> e bushter,  
çë djallin, nd'atë ditë  
bënej ture u sulur,  
ehjen ture ngulur,
52. si nd'Ungenitë, kur  
Lladislaut muer  
një katund e ndëjtë,  
mbi muret e shkuer <sup>323</sup>,  
të Hënës di britë  
të gjilmojen sitë
53. Beses Ungerjote,  
Mehmeti, çë duell  
ndë këmbet Uxunit,  
sa ki râ mbë truell,  
të math helm patë  
kur Asán <sup>324</sup> prapët  
shtënë vreu'vrarë  
si ka Dukagjini:  
e shokvet kalorë  
tha: Ziti e më vrini <sup>325</sup>

320) thanën, qëllim

321) jetë tjetër

322) Fati deshi atëhere të ndriste Dukagjinin që të vriste Hasanin

323) e mundur

324) Hasanin

325) vrini

- me humbjen e shpatës  
at' birin e e mëkatës,  
55. çë na buer Asán,  
e njó na i xheshen  
ehjat e shtrëjta 326  
si Feta i veshen,  
se t'i kishen hjé  
pér qitet. Njenjé  
56. me mua nd'atë mes  
suli, shokë kalorë...  
Eni, mos më leni  
të vetem: me forë,  
shokë, eni e bini...  
Kujtoni kush jini!...
57. Gjithë anti këtij  
këtuna t'u sul:  
Si bëletë e eger,  
Arbreshvet ju ngul;  
e ture vrarë zú  
me etë gjaku e ú.  
58. Dukej' doj të haj  
gjithë jeten si zjarri.  
Mehmeti, me zëmren  
e tharet si qarri,  
shtinej e vrinej 327...  
trollin me gjak nxinej,  
59. ndë pjazmet Nderushit 328,  
çë tutjë luftonej  
ka njeter llajé  
çë doj të furnonej  
së nxjerri kajeta 329  
e shprishur si fjeta,  
60. çë era merr e bier 330.  
Te Nderushi bij  
kështù, Kont Urani,  
çë haré t'i kij 331,  
ka krahu më atej  
Mehmetin skomollei 332

61. të zdridhej si zjarri  
me Turqit kalorë,  
e'mos'i bënej cerë  
gjithë të madhes forë  
me grâhien Driniotë  
nën Dukagjin zot 333,  
62. e i tha Nderushit:  
Pa vrë si Mehmeti  
ka ana atej përpin  
gjiritë, si i Shkreti,  
çë vret' shihet vetë 334,  
se të zërë rrëcet.  
63. Rrangár, bir, e ndihu  
shokvet: bir, nga  
e qell kë do shokë.  
Sa këshù Urani tha,  
Nderushi gjithë haré  
u kriár njenjé  
64. me shokë pesë Groprat,  
vëllezër të bushter  
e dhjetë kushërinjtë  
e tij. Me kët ushter  
të viçkrez 335 kalorë  
atcna 336 muer forë  
65. ka Driniotë 337 hilqshin  
me antin e Mehmetit.  
Këtij i ranë ngrah  
si ujrat e detit  
njí mali ç'ë ndë mest  
kur era i jé ngrest  
apraka. Vdekjen  
ndëndjen mbi Turqit:  
tetë e tetë ja shtjen  
si kush rrungon dushqit.  
Driniotë hapjen sitë  
e griken, te gjiritë  
vrejen aq të bushter.  
66. Këtu Dukagjini  
tue vrarë, thërrit:

328) heronjtë turq

327) vriste

328) sipas mënyrës së Nderushit

329) së vrari

330) humb

331) i kishë

332) shikol

333) dhe të mos t'i trembej vrullit me të cilla luftonin driniotët nën Dukagjinin

334) si shpirti i Shkretisë, i cili vret pér të mbetur vetëm

335) të vogël

336) andej

337) driniotët

- kështu e ashtu bini  
 dhe ju, shokët e mi,  
 Turqia të shorë zi.  
 . . . . .
83. (Mehmeti)  
përpëra u shtu, urrah!
84. tue thënë gjithë shokvet.  
Errú, te <sup>338</sup> Nderushi,  
i veshur gjithë hekur,  
si breshri koqet rrushi  
shtie shuell shuell,  
hjith sa trima suell
85. Turqia nd'at'lugath...  
I tha: Trim, më njeh?  
Mehmeti ësht burri  
çë ti përpëra sheh;  
Ai çë nd'Ungerit  
nxuer Besses sitë:
86. Ai, çë me Uxún  
e lohtin e e cënuen,  
e bashkë po katunde  
muertin e shtëlluen  
për trolli shuarartur <sup>339</sup>  
kriqet tue çajtur.
87. Nderushi i tha: Ai jé?...  
Oh mirë se më vjen!  
Nani bëj t'e shohsh  
dha si Uxuni qen.  
Ndë ballet'ligat'tua  
më thua e vren mua <sup>340</sup>?...  
88. Hilqu, mut i dhier...  
mos bjermi më mot...  
Gjakun kam të t'pil...  
Tha. Prana si mort  
me kalin, çë kalosh  
këcej, i vù përposh <sup>341</sup>
89. kalin e tij të bardhë  
si bora e të shkëlgier  
me rëgjendet e galunt,  
me k'ish i ndërruer.

- Këtuna Nderushi  
kriet i zú te rrushi  
shapkes e me ehjen  
trungëzen <sup>342</sup> ja preu  
e Turqvet ja zdroth  
e tha: ~ju marrtë dheu!  
e zani kocen djalli,  
kuj bën e i shkoi malli  
të bënë më lik neve.  
Këtu gjithënjiherje  
llajeja tij u ngri,  
e zú fort një mërje:  
Ju mbi krahu e dora  
e e vù përposh fora  
92. Driniotvet. Te mesi  
kështu Kusibanit  
bij Skanderbeku  
më forë të Titanit.
109. Jo fjalë më <sup>343</sup> luftomi  
me shpatat kaluer,  
si burra të dritsuer.
110. Sa u tha kështu, u sultin  
të di me shpatë e kal.
118. Këtu ka <sup>344</sup> lufa zienej,  
e keq'sa sund thuhet,  
me di burrat' bushter,  
kuj ëmri s'i harrohet,  
aq sa u dritësua  
nd'at'mot ç'u perëndua;
119. vrer, çë së pandehej,  
erth e i dhistanoi...  
Një korb, i marrë prapa,  
vín <sup>345</sup> ka stravatoi...  
Korbi' mos t'ish zënë  
ka mixori e ngrënë,  
vëngutet ndë luftorit <sup>346</sup>,
120. çë, si të djallarosur,

338) ndërsa

339) dërmuan

340) në ballë të lexoj të ligat e tua dhe tì guxon të më vëresh mua?

341) që i kërcëu kalosh (kalit të Mehmetit) dhe e vuri përposh

342) rrëth

343) Në fillim Skënderbeu e Kusibani hahen me fjalë

344) ku

345) vinte

346) luftëtarët

- të rrishin me shpatat  
keq keq tue u strosur.  
Ki vrer Kusibán<sup>347</sup>  
rekxi e, te mbán  
121. një kaq tokun shpatës,  
çë zdridhej e nxérrartur,  
shpata Skanderbekut,  
si zjarr ka qielli ratur,  
e cënoi e këmbalarta  
ka kali e shtú te balta.
124. këtu çë t'trämbur ikjen  
shokët e Kusibanit,  
shtirë ka Skanderbeku  
ndë grikët' Arimanit<sup>348</sup>,  
ka e djathha arbreshë<sup>349</sup>,  
ku ndihem pakë jesh,  
125. errën Cernoviqi,  
si dëluth erje<sup>350</sup>,  
çë hjidhet ka mali  
i keq gjithënjherje.  
Sa kështu t'errù  
me shokët, mbjatu zú  
126. Turqit me kalojet:  
Gjithë ndër trú ja ruejen<sup>351</sup>.  
Anamesa kuelvet  
malësjot' luftojen:  
me ball' e buzë të çarë  
kalorë e kuel të vrarë  
127. shtijen atij trolli.  
  
Kështu si moti' zi  
me bresher e shi  
128. mesin turk babarjen,  
te ku Skanderbeku  
me shokëzit kalorë  
mixorvet te shteku  
ja ruenej e ndanej.  
Te zbrahmin turk çanej

129. zoti math me ndihmen  
e bilvet' Malit zi,  
ka Komneni u ndie:  
Njó Leka Xakari!  
Eni, shokë, e bini  
këtu mirë-se-vini!  
  
141. xakaria,  
si Arkëngjell kalor,  
qellnej gjithë shokët  
me të madhe forë.  
Përpara tue ngarë,  
me shpaten tue vrarë,  
142. ai erth e t'errù  
te<sup>352</sup> Adhramani' bushter  
me Omarrin ndë barkut<sup>353</sup>  
bënej prë një ushter  
i vetë si ka mbanej<sup>353</sup>  
e llajetë çanej  
Arbreshvet, kuj bij.  
Sa Xakaria errù  
mbëhundë Adhramanit,<sup>353</sup>  
kët të folë zú:  
«Turk, mos të' ndjesë  
se sot më ndëlesë  
çon ka shpata jonë!...  
Rrove njera ni,  
se me shumë shokë  
ktu luftove ti,  
mbëhundë Komnenit,  
çë me hjenë e qenit<sup>354</sup>,  
çë e shi' me ulqit,  
u qelle e s'të rej.  
Vrë si dhiten Turqit,  
shokët e tú atej  
ka janë dhjetë e di  
mbrej njerin nesh! Shi'  
e zgardhullò sitë!  
Shi' si t'i kakaren  
me ndihmen çë i solla<sup>355</sup>.

347) Kusibani

348) Hyjnia e asgjësimit, e prishjes

349) «arbreshë», — për të rimuar me «jesh»

350) furtunë me erë

351) i binia së kokë

352) ndërsa, kur

353) nga do shkonte

354) Komoeni kishte të pikturuar në flamurin e tij qenin

355) shiko si Komneni i tremb turqit me ndihmën që unë i solla

- Rú si sa mbarraren<sup>356</sup>  
pérpara atij bien  
me ndaré o preré krien!...
147. Na duemi sa më jini  
këtu'bët'xení  
se ki dhé ë ini  
e duemi të na e lëni,  
xénie ju e mbreti,  
çë të thuhet Feti.
148. Xénie e mos' ju sjellë  
më këtena djalli,  
se bëmi të ju shkonjë  
gjithve këtu malli,  
çë kini të mshoni  
neve e të kalloni
149. paqë e nderë neve  
te ki dhé çë ini.  
Ndë s'gjegjshi ju këtu  
'mos fare më të vini<sup>357</sup>,  
Majdhe! Pér kët qìell  
ju thajmi mbë diell
150. lëkuren e ju e shesmi  
o carihe e bëmi  
pér né e Malësjotë<sup>358</sup>.  
Mos na dhistanoni  
më, e turpë kini  
ngamot t'egjer' jini.
151. Po vi, ndë s'do vrarë,  
si pjakat e smura,  
ti, çë jé i bushter,  
si, tue u thënë u xura,  
ngrëj shpaten e bjér  
se të vdeç me nderë.»
152. Po sa i math bëhel...  
përgjegji Adhramani:  
s'u gjegj me të rrëfier  
të jeç më baxhani  
ti ndër gjithë Arbrëshët  
me shpaten e hele veshtë.
153. Kush jé? U s'të njoh,  
se fare më të pé<sup>359</sup>...

- Ndë t'folet më duke  
danjet Ndë ti jé  
asish, o i zoti  
tire, dha si coti  
s'të ngit mua të folje  
këtu. Kanositë  
çë bëre, kam besë  
se mund trëmbjen mitë  
e jo kuj ja bëre.  
Ziguan ténë nxore  
ti i Danjit zot? Kur  
u tha t'ishe i bushter?  
Si ti m'u madhësove  
do t'huac se një ushter  
Turgish sosnje vetë  
të ngurnjel... Vërtetë  
156. sund jetë çë më thë,  
ndë hin t'e kem besë.  
U mund thom se mbjova  
me qiqe shumë thesë,  
se shumë luftova  
e shumë burra shtëllova.  
157. Çë jé ti ndë faqet  
Mirrmirrit e Qirakut,  
Tutfutit e Shoshmirrit,  
Heheut e Saraku<sup>360</sup>,  
e nd' faqet aqë të tjerë,  
kuj u s'i bëra çërë  
158. ndë dhët' Ungerisë  
e nd' Asjet Mixore?  
Sa gjellë gjithaparu  
ndër lufat helmore  
u shuejta, ku i pé  
ti, muti ktij dhë<sup>361</sup>?  
159. Ngrëj shpaten t'e shomi,  
ti pjotë pordha thes!  
Bjer se kam mall  
të math u të vëdes  
me ehjen lënde! Bjer,  
ndomos se s'ë nderë  
160. pér mua, ndë se u  
ka duert e tua rafsha.

356) përpigen me të

357) në qoftë se nuk dëgjoni (atë që ju thashë) mos ejani më këtu

358) malazëzet

359) të pashë

360) mbiemra njerëzish të parëndësishëm në Frasnë

361) dheu («dhë» — pér të rimuar me «pé»)

- Nengu e mbanj shtrejt,  
një se ktu tē vravsha.  
Bjér, Danjot, bjér,  
ndomos se s'kam nderë....
163. Tha, e tē di u sultin  
si dī desh çē piqen.  
Kuelt e tire shtuera  
qirithin, te hilqen  
zotrat<sup>362</sup>, zéhshin  
e me grikë cénohshin.
166. tē rrihshin me mall  
tē vrisjen o t'in vrarë.  
Shpatat tringillisjen  
e dritjen si ar  
me zjarrin çē shtijen,  
te gjellat duen'nxijen.
167. Turq e Arbreshë ruejtin  
prē ca herë hunduer  
tē rrähurit e tire.  
Prana gjithë ndonjë herë  
di anashit çē ruejen  
krerat çē don'shuejen
168. gjellazit e arta  
ktej e atej u sultin  
tē ndih'jen krien'tire,  
kështu qe çē u shkultin  
di krerat tue kanosur  
gjindjes tire strosur,
169. çē s'i là t'e shijen<sup>363</sup>  
një e një si dishen.  
I thojen: Bil qeni,  
çē nderën çē ishem  
tē kishem na rrëmbiet,  
te së na liriet
170. më ca herë tē vetë  
na tē luftojem.  
Turq e Arbreshë këtu,  
ndomos se ashtu thojen  
krerat, nd'atë llakë  
rrihshin e me gjak

171. e mbjojen. Vëdekja  
kështu zu më mbaru  
tue rruzhartur: gjelles  
«skriaru, skriaru»  
t'i thoj e kalosh  
i keenej si pëtosh,  
çē gjakun e gjelles  
nduken kuj vë thán.
172. Te këshiu luftojen  
ka njera e jetra anë  
eger, Arjaniti  
Turqvet gjakun ngriti,  
te Adhramanit bushter,  
sa nënga ju përpqoq,  
tue zdredhur e qasur  
ka ai, një i tolq  
me shpaten ndë kraht,  
çē edhë ndë stomahjt  
i bëri vërë tē gjerë,  
sa gjella i pështoi
176. Te gjithë<sup>364</sup> sa më ishen  
ruejen tē pështojen,  
Xoraidha, kopile  
e bukur e me hjé  
si dorë trendafile  
një kaq e shimtuer<sup>365</sup>  
mallin tue vajuer,  
e shpjeksurez errù  
me pesëqind't kalorë<sup>366</sup>
177. nisur, pra çē gjén<sup>367</sup>  
tue shkarartur, borë<sup>368</sup>  
Aqiben pa-krie,  
si degë, kuj u shqie  
178. koka<sup>369</sup>, çē i mshonej,  
me tē ngriten erë.  
Suvila e Kadixha<sup>370</sup>  
e qelljen tē ndërruer  
me tē tiret hjé...  
Si lulja më e ré

364) Të gjithë turqit

365) i shëmtuar

366) me pesëqindët kalorës

367) gjetën

368) tē ngrirë

369) pema, fruti

370) e shogja e Muhametit (profet)

362) duke hequr zotërat

363) ta shihnin (tē luftonin)

180. mandaj zbukuronej  
e gjithë sitë rrëmbenej,  
si bukurizë qelli.  
Pesëqindet, çë qellnej,  
asish çë e dojen,  
in <sup>371</sup> e ç'e shertojen . . . .

185. Muer arkanxje Turku,  
çë papá çelet  
e prier ball lufës  
me shpatat e me helet,  
të lodhenj Arbëreshët,  
çë i cenojen veshët.

180. mandaj zbukuronej  
e gjithë sitë rrëmbenej,  
si bukurizë qelli.  
Pesëqindet, çë qellnej,  
asish çë e dojen,  
in <sup>371</sup> e ç'e shertojen . . . .

## KANGJELI I TETË

### Përbajtja e KËNGËS SE TETË

Xoraidha hyn në luftë me pesëqind kalorësit dhe lufton me shumë dëshpërim. Turqit, duke marrë guxim, kthehen në luftë. (str. 1-10). Arbëreshët gjenden në vështirësi për shkak të hijeshisë së Xoraidhës. Skënderbeu i lutet Shën Janit, që e dëgjon si herë të tjera. Arbëreshët dyfishtojnë vrullin e tyre, duke përbaluar turqit. (str. 11-30). Këtu arrin Moisi Golemi me tremijë kalorësit, që ishin fshehur në pyll; këta më parë sulmojnë turqit nga dy krahët dhe nga prapa, me hobe, pastaj me shkopinj, duke i shpërndarë e duke zënë shumë robër. Edhe Xoraidha mundet e zihet robëreshë nga Nderushi. Skënderbeu vret Qerimin, të ku shëririn e Xoraidhës; kështu shuhet vrulli i pesëqindve e mbaron lufta, me ikjen e rrëgullt të Turqve, më të shumtit e të cilëve bien robër. Në atë luftë u vranë 22.000 turq. (str. 71-73). Atëherë Vdekja me borinë e saj përbledh gjithë shpirrat e të vrarëve turq, duke e urdhëruar Erën t'i shpjerë ndër shtëpitë, që t'i lajmërojnë familjet për vdekjen e tyre në Shqipëri. Këtu shënohet bredhja, pas vdekjes, e shpirtrave në shtëpitë e lindjes dhe të rrojtjes së tyre. (str. 74-93).

1. Vrer çë maj u vrei,  
më ndonjater herë,  
u vù kufi ka gjithë  
ni çë Xoraidha-ndërë  
ndë luftë vjen e zdridhet,  
ashtuna sa dridhet

2. Kush e shë aq keq  
nxërrarturez <sup>372</sup> ka malli  
e helmi Aqibes mjerë.  
Si shtihen ka zalli  
suvalat të mbëdhá,  
ajò me sa shokë ká

371) ishin

372) kush e sheh aq shumë të zemëruar

3. si ka Arbreshët gramiset  
e keqe, e s'vë kufi  
çë bën; si një llavur  
shtihet m'egersi.  
Të vrarit të haraksen,  
ka gjum'i rëndë pataksem
4. e rrinë një çik shtuera  
me çeren e Vdekjes,  
sikuna do t'vrejen  
ni' nderen e të Keqjes,  
çë më e zezë bëhet  
te Xoraidha shtillohet
5. me kalorit' saj  
ndë luftë' shkretë, e para<sup>373</sup>.  
Kish këshetë' shpjeksur,  
te shtoku të ndara  
e prapa të lëshuera.
6. Kështu si vrundullëra  
për krej gjithë zdrith  
shpaten me atë dorë,  
e msuer të qindisnej,  
e bardhez si borë.  
Mosnjë hundim e lënej  
po keq me të luftonej<sup>374</sup>.
7. Gjithë me hjenë e burrit  
zdrdhjen ehjet e vrisjen,  
prapa e ndër anet  
e vashës, çë i grisnej  
ma mallin: E Turqit  
çë ngurshin si ulqit
8. ka zjarri të trëmbur  
këtu shtuen forë.  
Ehjavet më eger  
pruertin e dhanë dorë.  
Bijen e së rejen  
se me djallet vejen<sup>375</sup>.
9. Papà manastrofa  
të zu e hjoth gjak:  
Papà rëkime e thirma  
gjimojen nd' atë llakë:  
Papà më keq spërveshen  
buzen, tek qeshen,

373) e para në atë luftë të shkretë

374) asnjë dashnor s'e linte, por shumë me të luftonte

375) se me dësje venin

10. Vdekja, çë të zonjen  
bënëj si më doj  
mbi aqë njerez' mjerë,  
kuj djalli thartoi  
ashtu trutë të rrihen,  
si qen çë sund shihen.
15. Të rrënët e Xoraidhes  
ndërrroi lufes çerë!  
Gjithë me të mbajen...  
Ndera Arbreshë<sup>376</sup> rrë t'bjerë...  
Të gjallë e të vëdekur  
janë gjithë ka vasha helqur.
28. Te gjithë urtëmojen  
e bëjen si t'e kénë  
të vrarë o të gjallë  
Xoraidhen vashén<sup>377</sup>,  
Alliu me llajetë  
axatu me betë  
anavet Arbreshe
29. zdrith dekjen me timba,  
çë, salvuver<sup>378</sup>, i bijen  
ngrah dha si gjëmba.  
Kë zëjen vrisjen  
o cënuer gramisjen
30. ka kali. Babarshin  
Arbreshët me aqë qen  
t'egjer, çë Turqia  
kështu i ndërsen.  
E lodhur kín<sup>379</sup> qënë  
me gjakun nd'atë'zënë,
31. ndë Mosë Gollemi  
ka dushku s'kish dalë,  
Turqvet t'i bij  
ka njera e jetra shalë  
e ndër krahë me forë  
me axatrat luftorë,  
çë t'ishen trimilë.
32. Kta të paren<sup>380</sup> zunë

376) nderi arbëresh

377) vashén («vashén» — për të rimuar me «kénë»)

378) të hedhura

379) kishin

380) më parë (të parën herë)

- e luftuen me betē  
preslangu. Si u afruen,  
lēnē zdorētē, u sultin  
e t'kegen i ngultin  
33. ngrah me kaloqet.  
Puf-paf i bijen  
ndē kocēt e ndēr krahē.  
Te kēshtuna i rrih' jen,  
eshtrat trak-trak  
i bōjen: e ndopakē  
34. tē cahshin; si shkarpat  
e thata kērç-lisjen.  
Bijen edhē kuelvet  
ndēr kēmbē, se tē shkisjen,  
ndēr hundē e ndēr ballet  
se t'vejen me djallet 381.  
35. Pēr kēt atjē buhjisjen  
sē keqj kaloqatat,  
si ndēr lufat' sōsme 382  
gjimojen shkuptatat.  
Colleini me kaq forē  
axatra e kalorē  
36. Turq ndonj' cik herē  
babarti e kakarti  
me shokēzit kalorē  
t'likjen mbarraiti:  
Bēnē shumē filaqi,  
kē penguen si dhi  
37. me theritur, o si dele  
me qethur o me vrarē  
ndē qenget 383 mbi thront.  
S'i lanē ngrah ar  
e mbi buzē hjenē  
e qimevet 384 i prenē.  
38. Qajen fort Turqit  
e keqj llastimissin  
kur qimet e geres  
me zjarr i cimbarissin.  
Mallkojen' metanostē 385  
tē humbur e tē lostē 386

381) me djajtē

382) ndēr luftērat e sotme

383) nē kasaphanē

384) musteqet

385) tē penduar

386) tē tretur

39. ka helmi, se ndē luftē  
me ehjat ndēr duer  
sē vdiqtin si aq  
ka ndera zbuluruer.  
O qajen o thojen,  
ni s'kishen cē bējen  
40. nēnd' egjrit Arbreshē,  
cē i bēnē filaqi  
e lidhur kēmbē e duer  
i mbajen si dhi.  
Te qajen kēta fort,  
ka gjithē anat mortē  
41. kanē shok't e tjerē Turq  
ka Arbreshēt, c'i rrāngarjen  
jashtē lufes tērmostā,  
e ehjat i sitarjen 387  
tek keq farrējen.  
Vet mbajen o luftojen  
42. tek mesi pesēqind't,  
cē Xoraidha qellnej  
si e llavur; ka ngit  
ajō ata vejen:  
zdridhjen ashta e shpata  
e rrōngat e gjata,  
43. si burra tē brerosur,  
cē malli nxērraren  
e trutē i tharton:  
vrisjen k'i mbarraren  
axat o kalor  
me shumē lēng e forē.  
44. Nderushi i lavtē 388 si 'ta,  
c'i kish vēnē thān,  
ju stros atij zjarri  
bashkē me Kont Urān,  
cē si al s'vastasnej  
vashen, kuj firasnej  
45. trutē malli Aqibes.  
Sa asaj u pērpoq,  
pērkrei pesēqindvet,  
me shpaten i tolq  
shpates saj njē fort 389  
sa mbjatu i dha mort 390.

387) i goditln me shpatat

388) i gmendur

389) njē goditje tē forte

390) i theu shpaten

46. ja cajti di copa:  
ja reshti ka dora.  
Te shokët e tij zëhshin  
me pesëqind't, çë fora  
mallit rrumbullarnej<sup>391</sup>  
ka dreq i skriarnej,  
47. Nderushi Xoraidhes  
ju sul; e rrëmbet  
për krahu përpëra,  
e nelli ktjetej  
mbjatuna pahir  
t'ish e lidhur mirë  
e mbarë filaç<sup>392</sup>.  
Vasha limonore  
këtu më se e bjerrë  
u pá; ndrë pengore  
zdridhej e qanej  
sa një s'und e mbanej.  
49. Nderushi harë të madhe  
kish, se zú kët fatë  
të bukur e të hjeshem<sup>393</sup>  
si lule ndrë vashat<sup>394</sup>.  
Lidhur këmbë e duer  
e la t'ish ruer,  
50. prana të ja qellnej  
kriatez<sup>395</sup> Xhudhitës,  
kuj mbanë kish hjé,  
dha si drita ditës.  
Pra ndë luftë u pruer,  
ku bëjen si t'meruer  
51. pesqind't, çë dojen  
vashen marrë prierrë<sup>396</sup>;  
e thrrisjen e vrisjen  
si gjind, çë e bjerrë.  
Te gjiritë i ikjen,  
vetë atâ së shihien  
52. udhen ka kish' vejen,  
ndomos se ndë mest  
shihshin e të rrahur  
si maçet ndë thest.

391) grumbullonte

392) e mbajtur robreshë

393) të hijshme

394) ndër vashat (-vashat\* — për të rimuar me «fatë»)

395) shërbëtore

396) të kibyer prapë

- Arbreshët kur panë  
se këta trû s'kanë  
53. të lënë'luftuerit,  
zunë e i zëdhjartin<sup>397</sup>  
me axatrat betorë,  
e t'i parramartin<sup>398</sup>  
si një katund t'ish,  
çë luftorë kish  
54. shumë e s'doj'lëj  
t'ish i vënë përposh  
e shkrehnej ka muret  
vëdekjen kalosh  
atire ç'e zëdhjarjen  
e jashtë e parramarjen.  
55. Kur Skanderbeku  
Qerimin, kushërin  
e vashes, ka kali  
shtu me të shtimë,  
çë kalit tij i dhà  
Korbi, sa i tha:  
57. Hurrah! Ti Korbi im,  
kët lufë të shkurtomi:  
shtiemi të kushërin  
e vash's, se furnomi  
rranga. Qe e gjatë  
kjo lufë çë somenatë:  
58. Na lodhi e këputi  
të krahëvet fuqitë...  
Sa të bjerë ki,  
aq na sa gjiritë  
e tanë mund prëhemë  
e bashkë të gëzohemi.  
59. Mirr forë... me di këmbet  
atij kali mixor  
bjeri ndë stomahjt:  
Te kali e kalor  
kështu përposh bien,  
u t'i marr krien  
60. të dive me kët shpatë,  
e qenjet ja lë  
t'i bëjen si duen.

397) i rrëthuan

398) i zunë me gurë

- Së dua më gjë  
ka ti, Korb, sot,  
po sa të shtie at' zot  
61. të bushter e hadhjar,  
çë aq däm bën.  
Hurrah! Të më nderò,  
se dora së zgarron<sup>399</sup>  
me kët' gjerë shpatë,  
sa u jam e gjatë.
65. Sa te Qerimi errú  
Korbi me kaluer  
Zotin' Math, eger  
kalit turk i pruer  
di sitë e si qen,  
çë i zoti ndërsën
66. njinjatri të huej,  
ju stros e tek e kalli  
pérposh si pullar,  
bën e i shkoi malli  
Qerimit të thoj  
Skanderbekut: Shkoi,
67. Zot Arbresh i bushter,  
gasi'ditvet'tua:  
këtu ti së con  
Aqiben me mua,  
Të kështu doj'thoj,  
parë se ai të zëj
68. të hilqej me zotin,  
kali e zú pérposh  
barkalarta; tek  
Korbi i rrëj kalosh,  
të dive te shteku  
i râ Skanderbiku.
69. Njerit prana jetrit  
ai gjellen i ngriti  
e ndë jet't mbatanë  
me frimen ja shtifti.  
Sa râ kështu vrarë  
Qerimi, tue shkurë
70. zunë gjithë shok't e tjerë,  
e lufa furnohet.....

82. Sa Dekja rrrot asaj  
mbjoth gjithë, tue rarë,  
s'dishë fare gjë t'i gjegjnej,  
po i tha: Doni qarë  
si ka prind't e shoqet  
të mund shini lloqet<sup>400</sup>
83. çë ndë jet't time,  
sa letë<sup>401</sup> qenë shënuer?  
Vëhi kalosh eres  
e ku qetë lerë  
ecni të ju ndiejen,  
çë psuet të kudirjen<sup>402</sup>
84. gjindja juej. Vi mirr  
gjithë kalosh ti Erë,  
këto gjellë të shuera:  
qelli ku qenë lerë.  
Naten o kur fjenë  
mb'ënderr bë'ti shón<sup>403</sup>
85. gjindja' shpisë tire  
të thertur o'lavosur  
si qenë, se të tunden  
me gjakun e farmëkosur  
t'i qajen e të bëjen  
çë duhet, se t'e shkojen
86. tek jeta çë i pret.  
Era mbjatu i muer  
e tue vrundullisur  
i qelli të helmuer  
ka shpitë, çë kín lerë<sup>404</sup>,  
e bashkë ato diér
87. me vrundulla të keqa  
hapjen e mbullijen,  
si dojt'i shkallmojen.  
Te diljen e hijen  
ndër shpitë, bithëmbékrie  
çë ka'ta u lirie
88. prirjen; atij trolli  
shtijen; qelljen jashtë  
lart si fjururakat  
çë ish i lë si kashtë.

400) vendet

401) sa u lindët

402) të kuptojnë

403) bën t'i shohin

404) ku kishin lindur

- Me dritten tue frjitur      28  
 tue dalë e tue hijtut  
 89. shpivet, trëmbjen pulat  
 ca herë çë i buthtohshin.  
 Ato thirrma jipjen  
 si s'pritshin të ndodhshin  
 ahiera: trëmbësinë,  
 çë gjakun i ngrin  
 90. kurmit e ngreshtron,  
 i jipjen gjirivet,  
 çë ruhshin' babartur,  
 te si përpara sivet  
 ca herë shin ca hjé<sup>405</sup>,  
 çë shkojen njenjë  
 91. e i frijen ndë çeret.  
 Herë sikuna t'i shtijen:  
 aprapa herë i ngisjen;  
 herë veshin i tilqjen.  
 Kështu tue i mshuer      68  
 bëjen të sëmurë  
 92. gjiritë, kuj kallzojen  
 kështu çë kin<sup>406</sup> psuer  
 ndrë zbulitë e Dibres  
 e si vdekja e muer  
 Alin, çë s'djiti  
 t'i qellnej e i mbiti  
 93. ndë gjakut, çë si krua  
 bën e i frushkullonej  
 shpata'Arbreshvet,  
 . . . . .

405) shihnin disa hije  
 406) kishin

Jubave 1908  
 Ndoni u zo (10)  
 Autorenai 21 (1908)  
 Gjedda 17.03. (1908)  
 Ndoni njezni u zo (1908)

1908. 1908. 1908. 1908.  
 1908. 1908. 1908. 1908.  
 1908. 1908. 1908. 1908.  
 1908. 1908. 1908. 1908.

## KANGJELI I NENDËT

### Përbajtja e KENGES SE NENDË

Në Krujë po perëndon dielli dhe Judita, e zbukuar dhe e shoqëruar nga tri shtojzovallet, Ndriçja, Illja e Dillja, del nga kisha. Të gjithë arbëreshët në Krujë parandjejnë fitoren mbi turqit dhe para se të arrijnë lajmëtarët në qytet, këmbanat e Dibrës dhe të gjithë katundeve arbëreshë bien për festë. (str. 1-29). Ndërkaq krerët arbëreshë, mbledhur nga Skënderbeu, duan të ndjekin turqit të mundur dhe në ikje; por Skënderbeu, i biri i urtësisë, i ndalon, duke u dhënë urdhër të pregatisnin darkën e fitores, menjëherë pas mbledhjes së plaçkave turke tek sheshi luftarak, pas mjekimit të të plagosurvet dhe pas varrimit të të vdekurve arbëreshë. (str. 30-50). Në tryezë Nderushi, i pari, e pastaj të tjerët krerë arbëreshë, nderohen nga Skënderbeu. Hahet mish demash e këndezash e pihet verë nëndë vjetësh që shkrep shkëndija. Krerët ngrenë dolli për Skënderbeun e Atdheun; rrëfehet edhe sa turg e arbëreshë qenë vrarë e plagosur. (str. 51-166). Pastaj Skënderbeu urdhëron të ndizen zjarret e të vihen rrëth sheshit rojet e natës; ndërsa krerët më luftëtarët arbëreshë shijojnë prehjen e tyre të merituar të natës. (str. 167-180).

1. Dhjetë hapakrahaz lart  
 ka çuka, çë perëndonej  
 dielli<sup>407</sup>, gjella jetcs,  
 si nd'pasiqir ruenej  
 ninzen e tij kopil  
 ndë ballet vashës çë dil
2. ka qisha, si Driçja,  
 çë çeren i puthi.  
 Nd'at'ball al shihej  
 te Dillja të puthi  
 të nines saj një sperë.  
 Së ndëndej tue u ruér

407) mbi çukën ku perëndonte dielli

3. te vasha, cë me hjé.  
vej e ruer<sup>408</sup> ndë shpi  
edhë ka Fata Illje,  
c'i piksi nj'll mbë gjí  
kur di motrat e tjera  
e puthjen te çera.
4. Kështu ka tri motrat  
Fata, ruer si fatë,  
vasha ngit e bukur  
e vetë ndrë vashat.<sup>409</sup>  
Mall t'i gjëzonej  
gjellen, tek e zënej.<sup>410</sup>
5. me motrazit hjé  
gjithë vasha mes-holla,  
të bukura më se  
lulet, cë bën molla.  
Kështu vej e ruer  
vasha nd'atë herë,
6. cë ka qisha dil  
me sa gjind diljen,  
pra cë parkalestin  
për prind't e bëmilen.<sup>411</sup>  
me lloret e shëndoshët,  
vatë te Dibra poshtë.
7. Allin se të prirjen  
prapë ka t'i vinej  
me aq qen shokë,  
katundin t'i nxinej.  
Vasha, c'ish Xhudhita,  
e bukurez si drita,
8. për jatin<sup>412</sup> Kont'Urân  
e prë Nderushin mall,  
mbë qishë<sup>413</sup> parkalesi  
me buzë e me ball  
shumë-herë stisur.<sup>414</sup>  
me trutë e përmisur.

29. . . . . (Skanderbeku)  
pra cë la ca herë  
shokët të prëhshin  
— Turqit tue xhesur  
të vrarë e cë ikjen  
karrera sa s'shih' jen  
udhet si ka vejen —  
i reksi me valirat,  
kuj tha: «Vi zeni  
e çeturnoni brirat,  
krerat gjithë të hijdhen  
rrot meje të mbijdhen,  
të gjegjjen vëlimen  
time e cë më thot  
koca. Këtu i thanë:  
Bemi si do, Zot:  
ka na je shurbiér.  
E gjithë ndonjë herë  
zunë tutù brirat,  
cë ndërnarjen veshët  
e gjithve, të shprishur  
të lufes ndë shesht.<sup>415</sup>  
ku zëmrat i gjëzojen,  
se ka më rucjen  
33. vet Turq shijen' vrarë<sup>416</sup>  
e vet Turq c'ikjen,  
tue lënë thesaret  
e sa me ta kishen.  
Sa gjegjtin Arbreshët  
krera<sup>417</sup> gjithë me veshët  
34. ngirlartur e prierrë  
ka të ratit<sup>418</sup>, ndonjë herë<sup>419</sup>  
gjithë si qen rrangartin  
ka me të frushulliér<sup>420</sup>  
i zoti i ndiell. Rrotë  
ju mbjothtin e thanë: zot,  
35. njotal Kumandona,  
më t'i tha Komneni;  
do u t'i marr prapa

408) e mbrojtur

409) e vëtmja e bukur ndër vashat

410) ndërsa e nderonte duke e shoqëruar

411) bijë

412) atin

413) në kishë

414) ngjitur me trollin

415) në sheshin e luftës

416) shihnin të vrarë

417) krerët arbëreshë

418) nga të rënët

419) së shpejti

420) frushulliér, fërshëlliér

- ndë Turqit'vemi 421?  
 Të vemi njize, zo,  
 na jemi... 422 kumandò.  
 36. Kështu krerat' tjerë,  
 çë mböhundë i duelltin 423,  
 me shpatat me gjak,  
 çë aq Turq nxuertin  
 kajeta, edhe thanë:  
 shpatat tonë janë  
 37. lestu na t'i zdredhmi,  
 o zot, ka të dueç.  
 Skanderbeku i thot:  
 Shokë, gjithë më rrueç 424:  
 së herë të vemi  
 përpara: tek jemi  
 38. kem' rrimi pér sonde.  
 Menatë sa të dihet,  
 çë na kem' bëmi  
 ka gjithë bë't dihet.  
 Të prëhemë na nget  
 e t'hami me shëndetë.  
 39. Të paren sa më jini  
 llajetë rriçidhoni.  
 Mirri shëngjin taj 425  
 nganjë e dërtoni  
 këtuna të ruhemë  
 sonde, mos' shuhemi 426  
 40. me gjumin çë dënon  
 luftorit 427 të qëlluer;  
 pra një pjesë çoni 428  
 shokët të cënuer,  
 i mbjedhni ka lingojen,  
 e i qellni t'i shërojen  
 41. jatronzit e tanë;  
 lavomat i lani,  
 e mirith ja lidhni:  
 shokëzit çë rani 429

421) a do t'i ndjek duke vajtur në Turqi?

422) ne jemi gati të vemi...

423) i dolën

424) më rrofshi

425) tuaj

426) mos të vdesim

427) luftëtarët

428) gjeni

429) që ranë

- e giellen së shohen  
 i mbjedhni t'mbulohen  
 42. me diten e ré,  
 çë dihet menatë.  
 Këtu edhë pënxoni  
 se parë të bëhet natë  
 triesat kanë' shtrohen,  
 ú e etë ' na shuhën 430,  
 43. çë shumë mbjedhimi sot,  
 tue dërsijtur gjak,  
 se t'vëjem përposh  
 aq Turq nd'at'llakë.  
 Dhen e që çë suelltin  
 pér ta, e ja muërtim,  
 44. vrini shumë e shumë  
 të prëjmi këto gjellë  
 me bukë, mish e verë.  
 45. Gjegjtit?... Zot, gjegjtim —  
 gjithë krerat e parë  
 zotit u përgjegjtin.  
 Nganjë u fanar 431  
 mbjatuna të bënej  
 çë zotit i këndnej.  
 46. Llajetë rriçidhuen,  
 jatrepstin theritrat,  
 të vrarit sarua  
 mbjedhini, e kumbitrat  
 ndreqtin; pra sitë  
 e natës, filaqitë 432,  
 47. dërtuken se të ruhshin,  
 njihet, te prisjen,  
 mos kishen gjë keq  
 ka Turqit, çë ngisjen  
 të ngurtur, tue lënë  
 çë kishen, e të fjënë  
 48. naten së pënxojen,  
 me drithmen, q'i vrit,  
 e pëndet ndër këmbë  
 i vëj, atë ditë  
 të zezë mos' shijen  
 më. Te këtë ikjen,

430) të na shuhet etja dhe uria

431) u nxitua

432) rojet

49. Arbreshët gjithë harë  
me gaset e Gavnjisë,  
pra çë gjithësej  
të ndreqtin, mbë tries  
u ultin: me ú  
shqiejen çë ju vú
50. pérpara e përtipjen  
me verat nëndë vjeç.  
Mish demash e kaponjsh  
ndrë taluret vec  
gjithë hajen, të gëzuer  
Ténzon tue bekuer.
51. Ndonjë spërvier të math,  
çë ngrënëj ndë mest  
gjithë' tjervet spërvjerë,  
me më linër dheztë,  
me gjithë krerat'parë,  
ndonj' tries<sup>433</sup> çë me ar
52. e terez shkëlqenej,  
Skanderbeku haj  
e bënej nderë gjithve,  
hje-math si më maj  
qe ndë jet't njari.  
Te haj vëj kuff
53. mbanë Kont Uranit  
një trim, çë s'njih  
pér krie. Tue vatë  
të ngrënët, shih  
si Kont Urani i shtij  
pjésë të talurit tij
54. te haj ai trimi,  
çë Nderushi ish.  
Pra çë mbetë e mbetë,  
Dukagjin<sup>434</sup>, kë ljk  
mbanë, muer e piejti  
kush ish trimi. Dijtë
55. ka ai çë doj të dij,  
e vrejti me harë  
edhë Ai Nderushin,  
çë të haj me hjë.  
Pra qelqin e tij  
me veren, q'ai pij

56. mbjoi e, Kont Uranit  
tha: Kuj ti tagjisen  
si një djal të vogël,  
kët qelq mund nisenj,  
të bënë me shëndetë  
mua e jo tij vet<sup>435</sup>?
57. Kont Urani i tha:  
zot, kaq nderë  
pretëndonj të bëç  
ktij amahji vrer<sup>436</sup>,
- çë sa bëri sot,  
ndë kishe parë, zot,  
s'mundje mos' e donje,  
ashtu si m'e dua.  
Te anti im ki  
dha luftë sot mua  
të madhe. Më salvoi  
ka Dekja, çë më doj.
58. S'thom sa Turq vrau,  
ndë sa t'vigjel krera;  
soslit vet' diç<sup>437</sup>  
se bën e muer era  
Uxunin e Mehmetin,  
çë shprishjen të shkrëtin<sup>438</sup>.
59. Martri ë Dukagjini,  
çë kë mbanë, zot.  
Ja vù pérpara shokvet  
tij, te e shi' si mortë  
mbi armiqjtë e si pika  
çë bën krunde e çika.
60. E Dreqja pretëndon  
t'i bëç sot nderë;  
i ngjet e i ka hjë  
të pirë kaq verë  
sa nxën<sup>439</sup> qelqi it,  
me më ar e drithë.
61. Këtu Skanderbeku  
qelqin pjot ndëjtë  
Uranit e tha:

435) atij që ti e ushqen si një djalë të vogël, unë a mund t'ja nis këtë gotë ta pijs pér shëndetin tim e jo vetëm pér tëndin?

436) këtij (që është) një çudi lufte

437) mijafon vetëm të dish

438) shkrëtinë

439) sa mban

- jipja atij trimoti,  
t'e pirë gjithë vetë,  
poka çë t'i ngjet<sup>440</sup>.
63. E muer Kont Urani  
e trimit ja ndëjtë  
me harë të madhe  
e tha: t'e jé zoti!  
Pije me-shëndetë  
e fal kë t'e jep.
64. Tëfale<sup>441</sup>, trim i bushter;  
tëfale, trim me hjé,  
çë duke si na duemi  
të dueç ténin dhé<sup>442</sup>,  
çë pjesë ti sallovve  
me sa sot shtëllove
65. Turq si ka kuelt<sup>443</sup>.  
Nderushi tek muer  
me dërti të madhe  
qelqin e nderuer,  
pra çë triesen fali,  
me buzen miali
66. kështu fali zotin,  
çë mbi gjithë ngrënëj:  
Zot, i bushter zot,  
Katundi të donej  
ka mot, kështu si  
Qielli të dha ni,
67. të madhen e keqe<sup>444</sup>  
Katundi s'kish shkuer  
ndë të kish pasur,  
o zot, mënjëherë.  
Krahu it i forte  
kish mbjatu dhënë mortë
68. mixorvet, ndë ish  
ktej<sup>445</sup>, sa zoti it at  
si dritë na u shua,  
me helmin, se s'patë  
nderë ai të rritnej  
biltë e t'i shihnej

69. ngaditë rrëzë atij  
e zëmren t'i ngrohnej  
me mallin e Katundit,  
me çë veshët i sofnej  
e me mall e gjegjien  
se i folnej të dreqjen.
70. Ndë krahu it, o zot,  
nd' atë skollë i rritur,  
ahiera kish qënë,  
këtu s'kish hijtur  
mixori njenjë,  
ndë marrë ténin dhë;
71. edhë s'u kish vrerë  
Zonja Prinqëpeshë<sup>446</sup>,  
me gjithë tú motra,  
ka throni çë kesh<sup>447</sup>  
t'ish e nxjerrë e i dhënë  
llargu shpi e të ngrënë<sup>448</sup>.
90. Kur zotrat të faljen  
Nderushin me hjé,  
Skanderbeku thot  
sherbëtorvet njenjë:  
më sillni këtu njeter  
vucë me verë të vjeter,
91. të pinë këta shokë,  
çë bënë nderë mua,  
e sot nganjë bëri  
me Turq një sarua  
të vrarë. Je t'pinë  
asosh e Gavnjinë
92. të faljen<sup>449</sup>. Timin qelq<sup>450</sup>  
tue mbjuer e ndëni  
mua, të ja jap  
zotravet: . . .
93. Vl zà, ti, Arjanit,  
çë bëre hjé ksaj ditë.

440) mbasi i përkat

441) fale

442) dheun tonë

443) nga kuajt

444) të kegen e madhe

445) në se kishte qenë këndej

448) Vojsava

447) që kishte

448) duke i dhënë shtëpi e të ngrënë jashtë Arbërisë (në mërgim)

449) le të pinë prej asaj vere dhe të përshëndesin fitoren

450) qelqin tim

94. Te Arjaniti e muer,  
tha: tē fala, zot,  
i mirē si kjo verē,  
kuj u i ja' votē  
aposhta ka e gjera<sup>451</sup>:  
Rrofsh sa buka e vera.
95. Mbjoi e dha tē ditin.  
Dusmanit' bushter,  
e i tha: pije, zot
96. Dusmani me dërti  
e muer, e, ~si kjo verē  
baxhane jotja nderē
97. ēsht' o zot, i tha:  
Njota, shokē, si zien  
e hā burbulidhet  
rranga e si thien  
shkëndilet alarta!..  
Zot, e shokē, ju falta<sup>452</sup>.
98. Sa gjithō e rrukulloi,  
zotit qelqin pruer;  
ki mbjatu cē e mbjoi  
Gollemit ndér duer  
ja vū e tha: pi!  
Pi, shok, edhè ti,
99. cē aqē kalogata  
dhé Turqvet ndér mushqet,  
te mē s'e pandeh'jen,  
tē ki<sup>453</sup> keq ka dushqet,  
ka i dolle ndér krahë,  
mē i keqi rräh-rräh!
100. Sa foren ti i more  
kështu gjithë u ngurtin.  
Zot, i tha, Moseu,  
u ngurtin se u smurtin  
me tē madhen forë  
cē i rá jotja dorë<sup>454</sup>,
101. cē mē jep tē pi  
qelqin me kaq hjé.  
Kjo zbukuron pastru  
si gjaku, cē ti kē

- mbë gji e tē ngjallen  
e zbukuron ballen
102. me qiqet e mbëdhá  
t'urta e me këshill,  
sa gjithë gjuhët e jetës  
ngamot kanë' zënë fill.  
E pi tē më ngrohenj  
me mallin tënd e vohen.
103. Sa Gollemi e ngjulki  
e zotit qelqin pruer,  
ki pér Kont Urán<sup>455</sup>  
e mbjoi e ndér duer  
tue vënë, muer e tha:  
zà, pi, Kont Urà:
104. Pi, se krahу djathtë  
ndë lufet më qeve;  
e mbëhundë Manxurrit  
bëre ndér neve.  
Sa Kont Urani e muer,  
tē fala, burr me nderg,
105. Sund<sup>456</sup> jenë tē harruera  
qiqet e nderuera,
106. cē ti bén ndë jet't  
'sotme, cē tē vren  
tē bushter, tē vetem,  
cē Turqit së ren.  
Tē fala, zot i math,  
burrùn e hjemath.
107. Sa Kont Urani piu  
e qelqin zotit pruer,  
ki papá t'e mbjoi  
e Petës vú ndér duer,  
e tha: pi e thuej  
sa lithtim tē huej
108. e janë cē kanë' dhjesen<sup>457</sup>,  
ndë duen' rriskurohen,  
e papá dhén e tire  
me tē gjallit'shohen,  
e mos'kenë mall,  
më me derkun djall,

451) tē cilën unë e shtie poshtë në gryke

452) ju fala

453) tē kishin

454) dora jote

455) Kont Uranin

456) s'mund

457) tē jaspin tē holla

109. tē strosen mbrej nesh<sup>458</sup>?  
 Dimilē némérova<sup>459</sup>,  
 i tha Nik Peta.  
 Tē shumet pengova  
 u me kēto duer,  
 çē qelqin e nderuer
110. marren, te m'e ndēn,  
 e kēt verē shëndetē  
 ka buza mē qasjen  
 t'e pi. Oh si shket  
 aposhta pa-ndukur  
 kējo verē e bukur! ...
111. Sa Peta e rrkulloj,  
 qelqin zotit pruer;  
 ki pér Cernoviqin  
 dish<sup>460</sup> t'ish i mbjuer;  
 te ja ndēnej tha:  
 ti Cernoviq, za;
112. za ti, ursi' malevet<sup>461</sup>,  
 me nj' millet prematjötë  
 shokë, ti mē qeve  
 krahu mē i fortë.  
 Axatu ju hjudhe  
 kuelvet i shkarkove
113. kalorit<sup>462</sup> çē qelljen  
 ngrah, me kaloqatat,  
 çē i zdrodhe tē keqa:  
 mē se trucatat  
 e deshvet kërsisjen  
 e çajen e vrisjen!
114. Malësjoti, tek muer  
 qelqin, ç'i ndēnej  
 zoti Skanderbek,  
 çē ashtu e këndonej,  
 me gaz i tha: zot,  
 Turqvet jije votë<sup>463</sup>
115. ti vetë, kur errura  
 ndë luftë u axatu  
 me një millet shokë.

- Doj'kisha qënë mbjatu  
 sa erhttit ndér duér  
 tē kisha bënë nderë.  
 116. Ftestin këmbet' mia,  
 çë kuelësh së qenë.  
 Ndonjater herë pres  
 'bë't'shihni si venë  
 Turqit bithëmbëkrie,  
 ndë qofsha t'i bie.
117. Tē fala, Zot i math,  
 baxhan si kjo verë,  
 çë gjellë e shëndë  
 jep kuj do tē jerë<sup>464</sup>.  
 Ju fala, tek e pi,  
 Zot e shokë gjiri.
118. Sa tha e rrkulloj,  
 qelqin Zotit pruer.  
 Ja mbjoi ki Muzaqit  
 e ja vú ndér duer,  
 tue thënë: Ti Muzaq,  
 thua se kemi paqë
119. ngamot na me Turqit,  
 çë sot shumë ranë?  
 Thuej sa dirguem  
 ndë gjellet mbatanë.  
 Muzaqi tek muer  
 qelqin e nderuer,
120. ç'i jí<sup>465</sup> Skanderbeku,  
 tha: zot, némruem  
 NJEZETEDIMILË  
 Turq, çë qëlluem  
 me gjumin e rëndë,  
 çë qëllon një gjëmbë.
121. Pér sa vura kuffi  
 u, çë bashkë qeva  
 me tij e luftova,  
 një katërqind vreva  
 shtënë ka jotja dorë,  
 çë bij me aq forë!
122. Ndë Turqit u priershin  
 më tē na nxifosjen,  
 më lik 'e t'presen<sup>466</sup>.

458) drejt nesh

459) numërova

460) deshi

461) ariu i malevet

462) kalorësit

463) jipje votë, deboje (reshtje)

464) atij që do tē japë («jerë» — pér tē rimuar më «verë»)

465) që i jepte

466) le tē presin

- Mos' presen' na ngosjen  
neve, çë s'i remi,  
pér sa tij kemi
123. tē fortë, si kjo verë  
nëndë vjeçë, çë ngjallen  
k'ë shpejt tē vëdesë  
me tē ngritë ballen.  
Kjo verë, çë celen,  
bënej ulk deleni!
124. Ju fala<sup>467</sup>. Zot e shokë,  
gjiri prematjotë,  
çë kemi hjé tē shomi  
mbi né një kaq zot,  
ka gjithë gjuhët reksen<sup>468</sup>  
tē tunden t'i pjeksjen
125. një dhafënie kurorë<sup>469</sup>,  
çë ngamot hjenë  
mbanë i gjelbëron,
- Te la më tē thoj,  
veren rrukulloi.
126. Qelqin zotit math  
gjithë harë t'i pruer.  
Zoti prë Topin  
e mbjoi sa e muer,  
e i tha: pi, Ndré,  
çë u qelle me hjé
127. gjithë sot mbanë meje.  
Diu sa tē lavosur  
qenë ka ana jonë?  
Na, zot, mbë tē serposur  
furnuemi tē mbjidhjem,  
t'i lajem, t'i lidhjem,
128. lavornazit me gjak  
tē piksur: némruem  
kësish katerqind:  
Jatronjvet ja shkuem  
t'i kenë nënd sitë,  
t'i japon jatritë.
129. Llaka è pjot Turq  
tē shuer e lavosur.  
Më se gjind krera

<sup>467)</sup> ju falem

<sup>468)</sup> i cili shtyn tē gjithë popujt

<sup>469)</sup> kurorë dasine

- janë shumë tē mirosur<sup>470</sup>.  
Me gjuhen pérjashta,  
ndër dhëmbet shgirrnasta  
e sitë hapët tē shumet  
rrinë barkalarta  
o si dirq<sup>471</sup> mustisur  
me hundet te balta  
'ronxevet me gjak  
me<sup>472</sup> 'nguqen kjo llakë.
146. Sa qelqin rrukulloi<sup>473</sup>  
zotit math ja pruer.  
Ki dishë prë Spanon<sup>474</sup>  
nani t'ish mbjuer.  
Te ja ndëjtë, i tha:  
Ti, zoti Pjeter, za:
147. Ti gjak i Teodhosit,  
çë ktej ka del dielli  
qe zot i math heret,  
e, sa një burr qelli<sup>475</sup>  
qiqe mund bënje,  
bëri e sund e shkonjë
148. mosnjë ndër sa lehen  
tejeta çë tē vinjë.  
Masimit ndë Panoniet  
shkeli kriet me tijnë<sup>476</sup>,  
e Akuillejë ja preu  
te tē gjallë e rrëmbeu
154. Pije, Pjeter, Pije  
e bëna meshëndetë.  
Vëlén se kujton  
ngrah po nëndë vjet.  
Pjetri tek e muer,
155. tha: Zot, më me nderë,  
së ngit aq të ngrëje  
Teodhosin tatëmath<sup>477</sup>,  
çë qiqe aq bëri,

<sup>470)</sup> krerët e vrarë janë më shumë se ushtarët

<sup>471)</sup> si derra

<sup>472)</sup> me kë, me të cilat

<sup>473)</sup> është fjala pér Topinë

<sup>474)</sup> ky deshi pér Spanon

<sup>475)</sup> burrë hyjnor

<sup>476)</sup> me gerre

<sup>477)</sup> gjysh

- se ish keq i math!  
Tij së vëj nënë  
nd'ahiera kishe qënë.  
156. Kush t'e shkonë tij <sup>478</sup>,  
çë qelle mbi Turkun  
me pakë, si një qen,  
çë vë përposh ulkun?  
Ndë dhjetën pjesë kishe  
të gjindjes tij, ishe  
157. njera dej <sup>479</sup> i zoti  
'gjithë gjuhëvet, çë ifjet,  
(ka del e hin dielli  
e përposh,) kjo jetë... <sup>480</sup>  
U pâ sot çë jé  
te mortë 'keqe' dhé  
158. atire, çë na shkojen  
pér tre ndë ktë llakë <sup>481</sup>.  
Ndë s'ikjen gjithë kishe  
vënë sot ndonjë gjak.  
Shkeljen ka do vëmi  
këmbet të shkomi <sup>482</sup>.  
159. Të fala, zot; na rrofsh  
sa rron buka e vera,  
e sa ndë jetë lulëzon  
Besa jonë e ndera.  
Të falenj, tek e pi,  
dhe Prematjotë gjirë.  
160. Sa tha zoti Pjeter,  
qelqin rrukulloi,  
e zotit te ja pruer,  
ki Xakarisë e mbjoi  
e tha; pije, o 'bushter,  
çë vjen sa një ushter  
161. kalorë. Më sallvove  
sot, me tënden forë,  
ka <sup>483</sup> Komneni hilqeji  
me Adhraman <sup>484</sup> kalor...  
Zot, ndë mënjjëherë  
u kisha dalë, ndërë

162. të madhe kisha bënë.  
Zoti Xakari  
Zotit u përgjegj,  
tue marrë me dërti  
qelqin, çë i ndënej  
të pijë e t'e nderonej  
si gjithë tjeret shokë:  
Komneni i kish grisur  
llajtë, kur errura,  
gjeta të skotisur  
atjë një sarua,  
çë mbjonej një përrua.  
164. Nd'a'therë çë errura  
sosi si m'i ré.  
Të fala, zot, u pi  
qelqin çë më jé,  
me kët mocem verë,  
çë më bën nderë.  
165. Te veren rrukulloi  
Leka Xakari,  
e qelqin zotit pruer,  
me hjezë e dërti,  
e mbjoi Dukagjinit,  
e tha: Zot i Drinit,  
166. pi, se pas tij,  
pinë shokët e tjerë,  
Amesa e it vëllâ,  
sa zotra e bulerë  
ndë ktë tries hanë,  
e të nderuer janë.  
167. Sherbëtorë, një rrogjë  
sillni! Kolloqisen  
vuca <sup>485</sup>! Vate posht!  
Së sosen pér triesen,  
gjithve të ja mbjonj  
si i ngjet, t'ja shkonj  
qelqin e shkëlqier.  
Pije, Dukagjin,  
çë qeve dora' djathë,  
sot, e krahut tim.  
Gjithë mixorit qen  
na ngurtim si dhen,

<sup>478</sup> shkon («shkonë» — një rrokje më shumë pér vargun)

<sup>479</sup> pasnesër

<sup>480</sup> që fal kjo jetë nga lindja, nga perëndimi dhe nga jugu

<sup>481</sup> turqit ishin më se 40.000, arbëreshët 15.000

<sup>482</sup> këmbët tona shkelin turq të vrarë ngado që shkojmë

<sup>483</sup> në vendin ku

<sup>484</sup> me Adhramanin

<sup>485</sup> tundet vera në bucë

169. sa nënga ti m'errure,  
si ka Kont Urani,  
e ndonj' anë rrëmbeve  
kalorit, çë Asani  
si pika na shtinej  
e shokzit na vrinej <sup>486</sup>,  
170. si zotit Vlladislá  
nd' Ungerit, kur  
e zú te një katund  
fort e bën e u ngür.  
Ti vrave at' Turk,  
çë, si kavshes ulk,  
171. bënej ndrë llajetë  
tona dëme e vrit.  
Mos xure, Dukagjin,  
sa qenë të vrarit,  
anes tënë'bushter?  
Jo më se nj' ushter  
172. njëqindenjézetsh,  
tha zoti driniöt.
173. Qelqi çë më ndën,  
tha Dukagjini, zot,  
ndë doret së më nxën,  
se bëri koq pak <sup>487</sup>  
ndë ktë' Dibres llakë,  
174. se s'm'i ngau njize  
me Turqit' luftonej.  
Ajò së shpatalisi  
sot si dishéronej  
me ta, çë tharti  
më bëjen ndër si,  
175. si kamnoi list.  
Qige Kont Urani  
bëri me Nderushin,  
trimi më baxhani.  
S'shkon mot e vjen  
papá Turku qen...  
176. Ahiera dua të prënj  
këto duer!... U sot,  
te kët verë pi,  
të falenj timin Zot <sup>487</sup>.

486) na vriste

487) Zotin tim (Skënderbeum)

177. Sa ki e rrukulloi  
e të tjervet ja shkoi,  
tha; Shokë prematjotë,  
e zotra, ju truenj  
kët natë: Zgjonérinë <sup>488</sup>  
vëni, të na ruenj,  
shprishtë rroqe-rroqe <sup>489</sup>  
ndë kta' ngushtë lloqe.  
178. Zjarret bë't'çelen:  
me shumë shkarpa e drú,  
të mbajen thimonetë <sup>490</sup>  
ku nga zjarr u vú,  
me kucare <sup>491</sup> e kulata  
frashérina të thata;  
të bëjen dritë zjarret.  
Gjegjtit? Mirë natë!...  
Fjëni gjimës zguer.  
Xëni pra menatë  
çë ë çë ka t'bëhet <sup>492</sup>,  
parë dielli të ngrëhet.  
180. Zotrat puthitin triesen,  
Mirë natë, gjithë tue thënë.
- 3.VI.1890
- 
- 488) rojtjen  
489) grup, grumbull  
490) grumbujt e druve  
491) kucér  
492) nesér pastaj do të dini atë që duhet bës

## KANGJELI I DHJETËT

### Përbajtja e KENGES SË DHJETË

Qetësia mbretëron ndër sheshet e Dibrës së poshtme, nën qellin me yje, pas buçimave të luftës. (str. 1-9). Xoraidha, robëreshë, psherëlin e qân Aqibën e dashur. Nderushi i zgjidh vargonjtë nga duart e nga këmbët, e shpie te shatorja e tij dhe e ngushëllon. Pastaj duke e lënë vetën, kthehet te shokët e tij dhe me kitarë i thur një këngë Juditës, që gjëndet në Krujë. (str. 16-19, 1-7). Shokët e Nderushit rrëmbehen nga ajo këngë e bukur. (str. 20-23, 1-5). Edhe Xoraidhës, duke e dëgjuar, i duket sikur sheh te Nderushi Aqibën e saj, zemra sikur i lehtësohet dhe, duke dalë nga shatorja, i lyp pak ujë Nderushit, i cili, pasi ja jep dhe e ngushëllon, merr prapë në dorë kitarën dhe vazhdon këngën, drejtuar Juditës. (str. 24-36, 1-5). Po Xoraidha s'gjen prehje, se mendon për Aqibën, prandaj Nderushi vazhdon të kënduarit. (str. 37-41, 1-5, 42-48, 1-5). Pas këtyre vjershave edhe Xoraidhën e zë gjumi; ajo sheh èndërr Nderushin e të tjera ngjarje të jetës së saj. (str. 49-55). Atëhere edhe zjarret zënë e shuhën e të gjithë bien në gjumë, po me shpatat në ijë e duke fjetur përgjysém.

Nga mëngjezi Nderushi sheh èndërr sikur gjendet në Krujë, afér shtëpisë së Juditës; asaj i dukej se hidhte valle me tri shtozvallet që përmendëm: Ndriçja, Ilja dhe Dilja e se ai i rrinte pranë shumë i gëzuar. (str. 59-81).

Por përfytyrimi i rremë i èndrrës i trishton zemrën kur bie boria pér zgjimin e ushtrisë. (str. 82-89). Skënderbeu, që ishte zgjuar, rrinte në atë kohë duke menduar qfarë kishte pér të bérë. Dhe kur pastaj krerët e rrethojnë, u thotë se atë ditë duhej të shkonin kundër turqve pér t'i zhveshur e shkretuar me dhjetë ushtri arbëreshe. Të tjerët do të qëndronin ndër sheshet e Dibrës, nën Kont Uranin, pér të mbuluar të vdekurit arbëreshë. Po meqënëse të gjithë donin të shkonin me Skënderbeun, ky që të mos mbante anë ndërmjet krerëve arbëreshë, u thoië të hedhin short.

1. Nënd qellin e Dibres,  
ka ilzit zbukuruer,  
zjarret barunarjen  
ndër vendet e ruer:  
Llaken drisojen  
me gjuhat, që ngrëjen
2. ndër ré me kamnuan.  
Kështuna me dritë  
ndëjen hjé të larta,  
çë pehmes' Martit<sup>493</sup>  
gjisjen; e, të parë  
llargu, si të vrarë  
çë dalen, i dukshin  
Turqvet, çë ikjen.
3. Qentë tire i prirshin  
ngaçik<sup>494</sup> e i leh' jan,  
si kuq natën shkon,  
ç'i ndjet se kallon
4. shpinë turke ruejtur.  
Pehma, çë bëjen  
kështu keq zjarret,  
me gjuha, çë luejen  
me ajrezit përkrei,  
sikuna t'i thej<sup>495</sup>,
5. gjithë Turqvet i ndit:  
Mos qasi më këtena  
ju, se varrin çoni:  
mbë paqë neve lena...  
Ju këtej mos eni,  
o Turq, bil qeni...
10. Së ndiejen èmbëlsitë  
e këndimes' bukur,  
çë nisnej Nderushi  
Xhudhitës, lutur  
si shëndeta e gjëlla,  
çë priten ka qjëlla<sup>496</sup>.
11. Sa zjarrin ai çeli  
e ngrëjti spërvierin,  
një shtrat mbërenda shkrifi  
e dhozi hilnarin,

493) përfytyrimi të Marsit (Hyjnisi së luftës)

494) herëpashere

495) t'i thoshtë

496) nga qelli

- se t'e dritësonej.  
 Vashen, çë shertonej  
 12. e qanej Aqiben  
 e mjerë, muer e kalli  
 atjen e t'i folen,  
 si ajò t'i ish malli,  
 te i zgjidhen pengoret  
 ka këmbet e lloret:  
 13. «Vashë, fare u helmë,  
 shkon gjellen fanëmirë  
 shoqe një vashje  
 të urtë e zëmer-mirë.  
 Sa me në paqësohe,  
 tek na pra martohe.  
 14. Vete mirë nuse  
 me një çë të do.  
 Harepsu, hjemadhe,  
 e fare u helmë.  
 Çë të thom mirr vesh  
 për Besen Arbreshë<sup>497</sup>,  
 15. Çë do të haç? Lip.  
 Këtu ë bukë e verë<sup>498</sup>,  
 mish e çë të dueç...  
 Iti ë ki spërvier...  
 Zà çeruzi... çë do  
 ti lip e m'u gëzò.»  
 16. Vasha Turke<sup>499</sup> gjegjnej,  
 shtij lotë e ksinej  
 me helmez<sup>500</sup> të madhe  
 për mallin, çë s'shinej<sup>501</sup>  
 më ndë jetë' saj,  
 me mallin çë e haj.  
 17. Mos një çerë njariu  
 me të folë me hjé  
 gjithë helmin e saj  
 mund bënej të lë.  
 Mandaj, pra c'i tha  
 Nderushi aq, e là  
 18. të vetmez e duell;  
 e me shokët përparrë  
 spërvierit t'u ul

497) arbëreshe («Arbreshë» — përtë rimuar me «vesh»)

498) këtu ka bukë e verë

499) turke

500) me lemjë, gulçimë

501) nuk shihet

- e këndoi te qitara  
 kështu vashes' tij,  
 çë llargu ka ai rrrij<sup>502</sup>  
 19. me shoqet kopile,  
 e ndonjë valle të gjatë  
 luenej e këndonej  
 me gjithë nd'atë natë  
 harësh nd' Arbrit  
 e helmesh ndë Turqit:  
 1. «E kuqez e e bardhë  
 si molla ti jë,  
 të mirit e èmbel  
 e molles ti kë,  
 hjemadhe e mes-hollë,  
 o e bukurez mollë.  
 2. Zëmren më more,  
 çë kur u të po  
 si mallith e bukur,  
 si molla me hjé,  
 o mallith e mollë  
 e e bukur mes-hollë.  
 3. Zëmren m'e mban  
 me mallin, çë donja:  
 Jé malli hjemath  
 si malli c'kirkonja,  
 o mall e mes-hollë  
 si e èmbolza mollë.  
 6. Për zëmërje i zënë  
 ka t'mirat e tua,  
 tzë fill si do fjas,  
 se áshta të dua  
 si mall e mollë  
 e e hjeshme mes-hollë.  
 7. Ti molla më e mirë,  
 çë rritet me hjé,  
 gjithë mallin e zëmres  
 time vo kë,  
 o mall e mes-hollë  
 si e bënura mollë.»  
 24. Xoraidhes, te këndonej  
 Nderushi aq me hjé,  
 Aqiba ju fjandas

502) rrivate

- e ndienej leth-leth  
helmi'doj t'i papsej  
e zémra t'i vapzej.
25. Te ndienej etë, ka lotë  
gënë e skerdénirtur<sup>503</sup>,  
ka dera spérvierit  
u ndëj gjimës e mbijtur  
e tha: Trim me hjé  
jé dreq, nd' ujë me jé,  
një pakez të pi<sup>504</sup>.  
Nderushi, vashë, i tha,  
ujë e çë të dueç  
të jap. Pi e ha.  
Do mish, bukë e djathë?  
Lip, çë do të jap.
27. Çë të haç të kënda?  
Të jap çë të dueç.  
Ndë hëngersh e piç,  
të thom u mërrueç.  
Xoraidha kopile  
si një trendafile.
28. ka rrëmbthi i këputur:  
-ka herë, trim-, i tha,  
-çë dishe të m'zënje  
të gjallë? Ni më vrà<sup>505</sup>,  
se s'më vlen të rronj,  
ndë mallin do të ndërronj,
29. çë më vret me tëndin,  
çë gjegjenj të kënduer  
nini. Trim, pénxò  
se zémra e ndërruer  
së fjet maj dreq  
e siell vet keq!
30. Nderushi, çë hunduer  
vashen Turkë<sup>506</sup> ruenej,  
te ashtu t'i folnej,  
e nga fjalë shertonej  
mallin e saj të shqerrë  
ka zémra e tō bjerrë
31. me spresen t'e shih  
më gjakún mbi dhé,

503) e shteruar

504) je vërtet djalë lisanik në se më jep tō pi pakëz ujë

505) më vrit

506) turke

- pra çë uli sitë  
e i pruer mbë vetëhë  
e pénxoi cahérë,  
kët folë vashes pruer:  
32. Vashë, leva u të dua  
mallin tek e gjenj:  
s'ë force, s'ë të thënë  
çë munden' më llargonjë.  
Po, vashë, gjegj mua,  
çë, si vëlla, të dua,  
33. edhe ti të vapsesh  
ha çë kë përpara.  
Ha çë do, te dal  
e kendonj, te qitara,  
çë malli më fjet  
e s'bën e zë rëgët.  
34. Vashë, ti mbahmu fort,  
u si moter të ruenj;  
te dal ka shokët, jasht  
e këndonj e luenj,  
ha e mirr mua vesh  
të Besses arbëreshë<sup>507</sup>.
35. Duell Nderushi e shokvet  
tha: shokë, më këndonj  
kënkazit, çë lenj  
Runi' më nderoni  
te qitares bie  
e vjershezit më shtie.
36. Shok, tha Qinigoi,  
kangjelin ze si do.  
Nderushi guallarti  
qitaren, e këndo,  
tha, Qinigò, te shtie  
vjershin e zë e bie:  
1. -M'u hap zémra sa të pé,  
vashë e bukur si së janë:  
Ti më zure me tutë hjé<sup>508</sup>  
e pér zémërje më mbaj.  
Si më zure ti më mbaj  
se s'më kënda t'ikenj maj.  
2. E m'u ndëve<sup>509</sup> sivet' mi  
të m'i prenje kët gjellë!  
Rimë e ëmu sinodhi,

507) arbëreshë

508) me hijeshinë tënde

509) m'u çfage

- se më ndjet çë ndér qjell<sup>510</sup>  
të mund ngas me hjetë e tua,  
çë ngamot lipsshin mua.
3. Kur e shkonja tue të streksur,  
se të t'conja s'lënja jirë  
qielli e dheu, pa ruer e ecur,  
kështu t'bëhsha i fanmirë,  
si pér hjetë e tua më jam  
ni çë tgjeta e më të kam.
4. Jam i jetës e jam i qjellit...  
xura s'miri ç'ë me bënë:  
mbanë tij sperë e diellit  
ndères' larte mund j'arrënj.  
Ti më lipsshe t'isha i mirë,  
trim i shpejtë e i fanmirë.
5. Qolsha truer u Tënzoti  
kështu gjellen bë'tshkonj  
gjatë e njera asi moti,  
çë më thërret, u t'e bekonj  
më presafri ndér qjell<sup>511</sup>,  
ka t'më nisi<sup>512</sup> si një diell.»
37. Ca shokë të Nderushit,  
çë pak din<sup>513</sup> të këndojen,  
vanë e vunë veshin  
të gjegjjen çë thonç  
vasha nënd spörvierit  
kur zëhej të kënduerit.
38. Gjegjtin çë sa qanej  
e thoj: Aqiba im,  
si 'vrarit më këndon  
me kët'bushter trim,  
çë duket' më thetë,  
se do si ti' më detë?
39. Nderushit këtu i thanë:  
bjer, shok, edhe këndo;  
vasha s'rri ulet;  
ngrëhet si kush do  
të bënje së di çë,  
e s'rri më mbë te<sup>514</sup>.

510) deri në qjell

511) në qjell (idiomë e Frasnites)

512) oga të më nisi

513) dinin

514) më vëhte

40. Nderushi, çë donej  
vashen të gëzonej,  
Xhudhites' ja qellnej  
shoqe, ç'i bënej  
nderë e hjé mbanë,  
si kush të mira janë,  
papá qitarelen  
ndrishe guallarti  
e zu kët kangjel,  
çë gjithë rrrikriarti  
e vashen më se gjithë:  
1. «Zémra ime jötja ë,  
Vashë e mirë, sa shoqe s'kë,  
mallin tënd e jo më gjë  
u më dua se c mirë já  
më se rrëmbthi i llumeres,  
çë ka lluret hjea e veres.
2. Të dua mallin, çë fanmira  
njësh di zëmrat tona rrëmbën  
e na i mbanë të hjeshma e t'mira  
si di rrëmbla çë ngatërrën  
fitra' gjatë e llumeres  
çë ka gjerdhet hjea e veres.
3. Kët mall ëmë<sup>515</sup>, çë zémra ime  
si më t'miren jetë sherton  
ëme, vasha zëmres time<sup>516</sup>,  
se lavomat këshiu m'l shkon,  
si shëron fjcta' lumeres,  
çë ka shtogjet hjea e veres.
4. Eme, e bukur, éme, e mirë,  
ndér gjithë vashat me më hjé:  
ëmë kët mall, o e fanmirë,  
më se luleza e ré,  
çë nxier rrëmbi' llumeres,  
çë ka lluret hjea e veres.»
49. Ki vjersh prëharepsi  
zëmren e vashës' mjerë,  
e prana çë ju lohtin,  
sitë'rrijen të zgjuer,  
me gjumsin lë-lé  
e zu zoti Morfë<sup>517</sup>.

515) më jep

516) zëmras sime

517) Hyjnja e gjumit

56. Kështu vej nata,  
tue ratë qet-qet.  
Zjarret zënë<sup>518</sup> e shuhshin,  
e gjumi i këllët  
sëmundën ndër si  
luftorvet, fuqë
57. mos'kenë më t'ruejen  
'tiren vetëhënë<sup>519</sup>,  
me shpaten ndër balqet  
vjerrë. Të mund kenë  
ngrah Turkun së presen  
e gjithë të vëdesen,
58. si krunxhra e shkëlepra<sup>520</sup>.  
Eh e jo gjithë fjënë:  
krijet i bij e ngrëhej  
si degë ka era' zënë,  
çë ulet e ngrëhet.  
Te kështu gjimës fjëhet
59. ka trimat luftorë...  
e shón me t'ëndërrit<sup>521</sup>.  
Gjumi edhë Nderushin,  
çë bëri nderë ëmbrit  
Arbresh gjithë djë,  
vú përposh atjë
60. kur dil e zbukuronej  
qiellin illi i ditës:  
ëndërrnej të gjëndej  
Krojë ka shpia Xhudhitës,  
e kët atjë vrenëj  
te sheshi të luenej
61. ndonjë vallë vashash  
hadhjarë e hjembëdhá,  
çë bashkë gjithë këndojen  
me sa hje ká  
gola më e ëmbel.  
Nd'atë valle, si engjel...
77. Nderushi pënxonej  
si fort rrëmbenej  
Xhudhitën t'e mbanej,

518) zinin

519) veten («vetëhënë» — për të rimuar me «kenë»)

520) me krah a me kembë të shtrëmbëra

521) dhe shohin pamje në ëndërr

- sa mbanith<sup>522</sup> t'i shkonej.  
Te me këto mendë e prij<sup>523</sup>  
njo qaset manë atij  
vallja e dritësuer  
ka vasha ç'ai doj;  
këtu mbë si i bëjen  
vashat hjé, të zëj  
shoqezën, çë lunej  
si kur fjeturobej  
me to tue kënduer.  
Nderushi sa vreu  
heren çë kish' sulej,  
si qift u stros: e rrëmbeu  
për krahu; e mban fort,  
i thot: Ti, çë mortë  
më jé, rri; s'më iken...  
Të zura!... Te thërrit  
vasha, e mbarë fort<sup>524</sup>  
ka duert' Nderushit,  
e zdridhej t'i pështonej  
llargu prir<sup>525</sup> të lunej,  
gjithë vashazit shoqe,  
çë dishtin t'e zënej,  
tue qeshur e tilqjen  
trimit' ja lëshojen.  
Te kë se ja lëj  
e rrij po t'e zëj  
për mesi, t'e mbanej  
më fort me di krahët  
t'e puthnej, Valiu  
duell ndë kocarajt,  
se ndrijej, e të zú  
brin e râ tu-tú,  
luftorit të zgjohshin  
çë kërkat të vejen  
ka Zoti të gjegjjen  
çë diten kish' bëjen.  
Nd'atëratë hapi sitë  
Nderushi.....

522) pranë

523) e priste

524) e mbajtur fort

525) përsëri

## KANGJELI I NJEMBËDHJETË

### Përbajtja e KËNGËS SË NJEMBËDHJETË

Pas mbledhjes së gjithë ushtrisë arbëreshe, hidhet shorti për kërët që do të shkonin me Skënderbeun të plaçkitnin vendet ballkanase, të cilat ishin nën pushtimin turk. Radha e tyre që kjo: Golemi, Komneni, Cernoviqi, Dushmani, Topia, Spanoi, Muzaqi, Peta, Stratigoi dhe Skënderbeu, i fundit. (str. 1-21). Këta u nisen me ushtarët e tyre kalorës dhe ata, që qëndruan bashkë me Kont Uranin, zunë e rrënuan gropat, ndër të cilat do të varroshin trupat e ushtarëve arbëreshë që kishin vdekur në atë luftë të madhe. Kur këta mbaruan, erdhën disa priftërinj nga Dibra që ja truan Perëndisë shpirrat e të vdekurve arbëreshë. Kufomat e turqve, përkundrazi, u zvarrisën për këmbësh e u hodhën në lumë me nëma e mallkime. Ndërkaq, pas disa ditëve, Skënderbeu me shokët e tij kthehet plot me të mira (str. 54-64) dhe urdhëron, pasi shkon për t'i parë të varrosurit, të thirren gjithë priftërinjtë e Dibrës që të psallnin të vdekurit arbëreshë ditën tjetër, që ishte e njënta pas luftës. Pas darkës e tërë ushtria bie të flerë. Nga mëngjezi Kont Urani sheh një ndërr të keqe, prandaj zgjohet shpejt dhe vete te shatorrja e Skënderbeut. Kont Urani i rrëfen ndërrën dhe Skënderbeu i shpjeton se fytyra e cjadit simbolizonte Muratin dhe ajo e kecit — Mehmetin e dytë. (str. 83-93). Pastaj, ndërsa ushtarët zgjohen, Skënderbeu vishet. (str. 94-102). Ndërkaq nga Dibra arrinë priftërinjtë, të cilët psallin të vdekurit; ushtarët vajtojnë shokët e tyre, që ranë në luftë (str. 103-116). Pasi priftërinjtë u shpërndajnë ushtarëve grurë për shpirtin e të vdekurve, Skënderbeu urdhëron të fillohen lodrat, sipas zakonit të pellazgëve, ashtu siç rrëfen Homeri në poemën e tij. Ato ishin: vrapimet me kuaj a më këmbë, dyluftimet, lodra e diskut, kërcimet, etj. Ai që do të fitonte kishte pjesë të veçantë ndër plaçkat e marruna prej turqve; ndër to ishte edhe Xoraidha. (str. 117-191). Xoraidha bashkë me kalin arab që i ishte marrë Abuxhafarrit, i përket Nderushit. (str. 142-166). Shpërblim tjetër është shtimi

i gradave në radhën ushtarake. Në kërcime fitojnë malazezët. «Shokë të Cernoviqit — që gjisjin kaciqit — për këmbët e lefta — çë kinë të mësuer-timbat të këcejen — dhizit tue ruerndër brinjat e Malitzi»... (str. 167-172).

Në mundje fiton Ndre Kollogreu, katariot, që u mat me pesë vetë. (str. 172-215). Pasi mbarojnë lodrat Skënderbeu urdhëron të preqatiten të gjithë se do të niseshin drejt Krujës për të bërë atje hyrjen triumfale. (str. 216-220).

42. Këta zunë pra Turqit,  
si kavshë e spavisur,  
për këmbje ndë lumt  
i qelljen t'xarrisur:  
cingërrjen e livisjen  
si edhe t'kish' vdisjen,
43. me shpirrat e huej,  
c'edhë s'i kishen dalë  
me shpirrat e tire,  
kur me kocë o shalë  
të prerë o të çarë  
ka kuelt kin rarë<sup>526</sup>.
44. Arbreshët tue qeshur  
i tilqjen e i thojen:  
kini shtatë shpirtra  
si maçet: ju shkojen  
ëndat të ngjalli  
ndë lumt, bil djalli!...
45. Shokë, rù si cingrrën  
ki!... Si nogësimë  
ki bën!.. Pa! si friq  
ki!... Sa shertime  
shtie ki çë telq<sup>527</sup>!...  
Më kalli një shqelb!...
46. Bir djalli!... Kriengula  
ndë lumt kam'e shtie...  
Ki si do t'fjasë  
ruen e bën me krie!...  
Çë do? S'do xarrisur  
ndë lumt, t'jeç nisur  
ndë dét? Ki paqë...  
Ke të vec, se të presen  
pishqit grikë-hapët.
47. kjo shortë sa vëdesen  
mbë gjimës o të tërë,

526) kishin rënë

527) që vuani

48. ndér ju, ka tē zérä. 528) duke vajtur  
Kështuna Arbreshët foljen Turqvet'vrarë,  
çë dukshin'livisjen,  
te i tilqjen, tue ngarë 528) 529)  
ka lumi, tue qeshur  
mbi ta si dirq xheshur.
68. ... Gjithë ju, shokë 529),  
me mall e hjé puthni  
boten e ktij llok' 530  
shëjtë, çë bushtrit tanë  
mbjeth, e ndera qan,
69. se i buer e më s'i ka;  
puthni bashkë me mua  
kët llok, çë gjithë'bushtrit  
tanë mbjeth sarua...  
Pra çë me dërti
70. gjithë me lotë ndér si  
llokun shëjtë puthtin,  
i tha Skanderbeku,
- 117 ... Skanderbeku  
mbjatu jushtrinë  
dishë'zejen rrerrot  
varrit, si një mot
118. bëjen Pelashtjotë,  
çë Omeri këndoi.  
E parë e më parë  
zu petkun e shënoi,  
çë mirr nga jushter 531,  
çë qellej i bushter,
119. tha: Kalin Aráb,  
ç'Abuxhafarri buer  
nënd meje me gjellen,  
ja' 532 kuj mbë karrerë  
nji kali ja shkon.  
Pra, kuj kapton
120. mbi vithet nji kali  
ka trolli, t'i ja

- një mushkë pesë vjec,  
çë si ajë s'u pá  
njater më e mirë  
t'kullotnej kto jirë  
dherash e mbatanë.
121. Kuj ndë luftë shtie  
pesë vetë një e një,  
mbi pesëdhjetë krie 533  
e bënë më tutjë.  
Kuj me dhjetë e she' 534
122. e gjithë vë përposh,  
nënd të tijen dore,  
'vë të kumandonjë  
katërzet kalorë,  
sanënga na thërrët  
briu, se na ngët
123. papá të luftomi  
me qenzit mixorë.  
Pra kuj më rroles  
jep lëng e forë,  
já kavshë sa një djathë,  
si një shosh të math,
124. ngamenatë të piksenj.  
Pra kush do të shorë  
mbë gjak me kta Turq  
këtu ndrë pengorë,  
pesë po të shtjerë  
mahjere me mahjerë,
125. u marr e t'i jap  
pesë lopë e pesë pendë  
qësh të mësuer  
aq qerre sa parmendë  
të helqen, ka nj'vit 535.
126. Kush pra ndë kt'ditë  
e popen t'gavnjenjë  
gjithë jushtrat, çë u thanë,  
merr jo çë u tha,  
po vashen çë qan
127. trimin, çë i shtura,  
kur me të u zura  
tek të mbanë fort,  
me' pakzit luftorë  
të aksem e axatu.

528) duke vajtur  
529) Mbasí janë varrosur trimat arbëreshë të rënë në luftë, Skënderbeu  
530) vendi (\*llok\*) — për të rimuar me «shokë»  
531) që do të merrte qdo ushtar  
532) jap

533) në krye të 50 ushtarëve

534) e sheh

535) për një vit

128. Kush veshla e llorë  
 ká lutat' gavnjenjë,  
 'e t'jipet'rrëmbenjë,  
 me vashen, thesaret,  
 çë me të të suell<sup>536</sup>.  
 Trima shokë, të dhënet  
 ë këta. Kë ju puell  
 dilni e nderoni,  
 ndë se ju e doni!  
 129. Pra, prierrë Kont Uranit,  
 tha: këtu bë't'nxjeren  
 kavshen e vashen,  
 çë jipen për nderen,  
 trimat, se t'i shohen,  
 t'i kenë, të shtëlohen.  
 130. Bën njize të marrmi  
 pru ka e madhja horë<sup>537</sup>,  
 çë me mall na pret,  
 të gjallë të na shorë,  
 e gjithë të nderuer  
 me petik e të gézuer.  
 131. Sa tha Skanderbeku,  
 Urani u triqini's  
 e bëri ç'i qe thënë.  
 Afroi ka një lis  
 kavshat çë t'i jipshin,  
 e vashen të shihshin.  
 132. Vasha, çë Xoraidha  
 ish, vasha me parë,  
 e mirez mbë gas,  
 e bukur mbë t'qarë,  
 Urani bën e u ul  
 mbi të lartë bazul,  
 mbrënda rrotës lëmit,  
 se t'ish ka gjithë vrerë  
 sa e bukura ish  
 e sa e shkilqéré<sup>538</sup>  
 ka mall; të strosshin  
 sa për të losshin  
 134. t'e kishen ndér ndrishet  
 luta, çë kish' bëhshin.  
 Te qan vetçhenë

536) le t'i lejohet të marrë Xoraidhën me visarët që ajo solli me vehte  
 537) Kruja  
 538) e shkëlqyer

vasha, sitë i vrëhshin.  
 Kaq helm s'e dënon,  
 po më e zbukuron.

216. Këtu Zoti math  
 bën e duell valiu  
 llajevet rrot'honej  
 me të ratë briu,  
 të lëjen lutë'tjera,  
 se t'nisshin ish hera.  
 217. Ato me gjithë mot  
 mbrënda Krojë i bëjen;  
 po gjithë të dirtohshin,  
 të nisshin të zëjen<sup>539</sup>.  
 Pra Nderushit tha:  
 mirr vashen, çë t'dha  
 Gavnjia çë të do,  
 se këtu të nderoi  
 si dishe. Qeshi vashës  
 ktu trimi si t'i thoj;  
 harepsmu, vashë hjé,  
 nani çë imja jé.  
 218. Bë't'shkoç gjellen  
 ngadita ndré gézime.  
 Të dua tha si sitë,  
 o jatra muzë ime<sup>540</sup>.  
 Te kështuna t'i thoj  
 me gasin, muer e shkol  
 si ka Skanderbeku,  
 t'i puthenj atë dorë,  
 çë nd'atë mot shkonej  
 gjithë me t'madhen forë,  
 çë jip shpatës tij  
 kur mixorëvet bij.

539) të fillonin të ndreqeshin dhe të niseshin  
 540) Zana ime

...  
...  
...  
...  
...

...  
...  
...  
...  
...

## KANGJELI I DIMBËDHJETË

### Përbajtja e KËNGËS SË DÝMBEDHJETË

Para nisjes për në Krujë del një rob turk shumë i fortë, i cili don të luftojë me më të fortin ushtar arbëresh, me kusht që të ketë lirinë, nëqoftëse do të fitojë. Nderushi matet me të në një dyluftim. Më parë shahen e secili ngrë lart shpatën e tij. Nderushi lufton me shpatën e Skënderbeut, turku me një shpatë që e mban për të magjepsur. (str. 1-32). Nderushi, duke ju lutur Shën Mërisë, i premtion qirinj, ndërsa turku një vizitë në Mekë. Dyluftimi përfundon me mundjen e turkut. Krerët e tjerë e kanë zili Nderushin dhe duan të rrëfejnë edhe ata zotësinë e tyre, por Skënderbeu i ndalon, duke u premtuar atyre se në Krujë do të nisin grapë lodrat. (str. 42-51). Pastaj urdhëron të ndahen plaçkat e tjera drejtësisht: Të qindtën pjesë e mban për vehte, një pjesë ja dérgon kishës së Shën Kollit në Bar e një pjesë kishës së Shën Mërisë në Shkodër. Dy pjesë i morën të plagosurit e nëndë pjesë familjet e të vdekurve në luftën e Dibrës së Poshtme. (str. 52-63). U mban pastaj edhe një fjalim ushtarëve, në të cilin i këshillon të mos pinë shumë verë se mos bien nga kuajt. (str. 64-74). Gjatë të ngrënët Nderushi ngushëllon Xoraidhën, duke i kënduar Juditës. (str. 75-105). Kur mbaron drëka, Skënderbeu u jep këshillat e fundit krerëve e ushtarëve arbëreshë, të cilët i urdhëron të vihen në udhë për të vajtur me radhë në Krujë, ku do të bëhet hyrja triumfale. (str. 105-142). Pas tri ditësh udhëtimi ata arritën në Krujë, ku u priten me hare të madhe nga gjithë populli i Krujës e i katundeve fqinj. Judita gëzohet shumë, duke parë se i ati dhe Nderushi u ktheyen me lavdinë e fitores. (str. 142-154).

Edhe priftërinjtë e Krujës u dalin përpëra me kryqin, pastaj shkojnë të gjithë në kishë për të falënderuar Ferëndinë. (str. 155-170). Skënderbeu i këshillon ushtarët të mbajnë shpatën në mill, se turku shpejt do të kthehet kundër Arbërisë. (str. 170-172). Bëhen tri ditë kremitme me të ngrëna, lodra e valle. Ndërkëq Skënderbeut i vinë nga të gjitha anët e Europës dhu-

rata e nderime mbretërore; turqit përkundrazi venin e vinin nga Arbëria të ngarkuar me ar e dhurata të tjera, që të shpërbulenin e të lironin bijtë e tyre nga burgjet e Arbërisë së ftotë.

1. Skanderbeku doren te<sup>541</sup> Nderushit ndën t'ja puthenj, valiu vjen me kët'hënë: Ndër Turqit ë një çë t'e shorë do
2. me kët, po t'i jaç gjithë libertaten, ci lëpset, ndë shortja i ndihtit<sup>542</sup> me shpaten, anqill e qimjér i veshur t'e shijerë
3. tek lëmi nderes. Sa Totaqirku gjegj, Nderushit i tha: ndë të vjen dreq të vëhesh ë herë këtu tënden ndërë
4. më të madhësoç. Thuej ëh o jo. Zoi, tha i bushiri, thom ëh dha si do ndera shpatës tënë, çë Turqit vú nënë.
5. Këtu Skanderbeku tha: Ec, vi, vali, e Turkut i thuej se çon leftheri me shpaten sa do, ndë s'i thëltë jo
6. shortja. Sa valiu te Turku t'erru e shpengoi. Mbjatu ki u vesh e vú mbë krie qimjerin, shpaten e anqillin
7. rrëmbei e të duell te lëmi të prit trimin e ndreruer:

541) ndërsa

542) e ndihmoftë

- Al dreq nd'at' ditē  
mbanej t'e shtij  
e libértatē<sup>543</sup> tē kij.
8. Tē paren<sup>544</sup>, çē Zoti  
Turkun vrei dale  
te lēmi, Nderushit  
i tha kēto fjalē:  
~Ka t'qellet baxhān  
ai Turk Ndragumān!<sup>545</sup>
9. Pa rū sa i lartē!  
Ti stene t'e shoç  
edhè me kēt vrer,  
zēmrat' na gēzoç?  
Kēshu njē villjatē  
njē tartar i lartē
10. m'u ndei frimē-math  
kur Feten shurbeja  
mbrēnda Adhrianopull<sup>546</sup>.  
Ahiera trim eja<sup>547</sup>  
si ti. Fare gerē  
i bēra, e me nderē
11. dolla te s'dishē  
ndonj'Turk tē vēhej  
me tē. Gjithë shehur<sup>548</sup>  
duelltin kur zēhej  
me mua e gustuén<sup>549</sup>  
si bēn e puthi dhén.
12. Ti ashtu mos e ré...  
Ruej se jemi Arbreshë,  
e Turqit fare nderē  
kanē mbēhundē nesh.  
Nderushi i tha, Zot,  
bēnj sa mundenj sot.
13. Pa<sup>550</sup> mē nget' veshem  
me shpatē e me anqill  
e kriet tē mbulonj  
me shapken si mill  
hekuri shkilqier,

543) liri

544) pasi

545) do tē jetē i fortē ai turk vigan

546) krahaso me kēngēn e veitme

547) isha

548) Ishehurazi

549) gustuén, gēzuan («gustuén» — pēr tē rimuar me «dhén»)

550) po

- çē thomi qimier.  
Po nji! Skanderbeku  
trimit bushter tha:  
edhè shpaten time  
tē luftoç zā.  
O s'e do, se dorē  
s'i kē t'l' jaç forē?  
15. Emē, Zot, se sho  
dha me kēt t'e shtie,  
se tē verē ka do  
me kurmin pa krie.  
Zoti qeshi e i dha  
shpán e tha; nga  
veshe e bēni nderē.  
Turku Ndragumān  
njo ka herē tē pret  
si i eger Titān,  
e pret tē nderohet  
te me tij zēhet.
16. Si vrēret prier sitē  
me cinura' dushquer  
si sitē e lliunit!...  
Ec, trim, i nderuer.  
Trimi dha si gjel  
i ngreshtuer del  
ka Turku tue ngarē  
ndē lēmēt, i gēzuer  
ka vasha çē e ruen  
me mallin e zgjuer,  
te dij'kish t'vej  
me tē çē e dej<sup>551</sup>;
17. 18. 19. 20. me tē çē ndér shokēt  
vēlen mē me duer,  
me graxje tē folesh<sup>552</sup>,  
me'bukur kēnduer,  
e me hjé gadhjari  
trimi e bulari.  
Prē gēzimin e vashēs  
me zbrahem tē nget  
ka Turku Titān,  
si-eger<sup>553</sup> e pret  
shtuera, me ndér duér  
anqill e mahjerē.

551) ndērsa dinte se do tē vente me atē, qē e donte

552) i kēndshēm nē tē folur

553) me sy tē egēr

21. Te ka ai tē vete  
 tērvitu, t'i tundet  
 fjamuri qimjerit;  
 si bishit kali shkundet,  
 i shpjeksej me hjé  
 e kriet i bén'lé.  
 22. Sa mbé hundē i erth,  
 e fali: Ti, burrun,  
 pér libertán tēnde  
 leftō, tek unē  
 pér nderen leftonj.  
 Nderomë... tē nderonj!...  
 23. Turku ju përgjegj:  
 Te 554 pér libertaten  
 u sot me tij luenj  
 gjellen, ktu me shpaten,  
 pres nderë tē mbjeth  
 me liq, te s'e vjetë 555  
 tij si një fjalës 556.  
 Ke liq, trimi i tha:  
 sillme o t'e siell.  
 Turku i tha: t'e ja' 557  
 më parë u: u ruej  
 ka kjo shpatë e huej,  
 25. çë pret keq fort  
 e hin me etë gjaku  
 kërshterish, si gjëmbi  
 te gjiza o te mumbaku 558.  
 U ruej, trim, u ruej  
 ka kjo shpatë e huej,  
 26. çë prind't e mi thonë  
 tē jetë e fatostë,  
 përsë nëngu pika,  
 e bëri tē lostë  
 tek e keg'i rá  
 me zjarrin çë há.  
 27. Nderushi ju përgjegj:  
 E mirë edhë ti  
 tē diç se kjo shpatë

554) ndërsa

555) se nuk ta vjetë

556) fjalëmadh

557) ta jep, ekip e IP. Alla ova vjetë që shi i shpëtuar

558) te pambuku

- vreje mirë e shije — 559  
 ësht e Skanderbekut,  
 çë antit Buxekut  
 28. rá keq më se pika.  
 Me shpaten e fatostë  
 tënde kjö e she' 560,  
 çë, si e djallarostë,  
 u zdroth shpates turkë 561,  
 si shtjerravet një ulk.  
 . . . . .  
 30. Mos vandomi më  
 shpatat; tē nderomi  
 ruemi vetëhenë,  
 tē kë i nderes lëmi.  
 Me al'shpatë e sheh  
 kjo, çë gjithë rrch. 562  
 31. 'Nxilostë kështu, zunë  
 tē zënët mbë gjak  
 di'bushtrit luftorë,  
 me nderë e mustak.  
 Bënë vute tē di.... 562  
 . . . . .  
 42. Arbreshi ka Turku  
 si'dhjester u rua 563:  
 Prëmëndaj vérzila  
 tij u shkarpalua,  
 te trimi tē ngrën  
 anqillin, çë ndën  
 43. e mbjatu përgjegjet  
 me të tijen shpatë  
 mixorit, çë ruhet  
 me zëmer burri e artë 564  
 ka trimi, t'i kërsët  
 tē tijen e i pret  
 44. lart e posht anqillin  
 e keq i cënon  
 krahun, çë e luenej 565  
 e sisen e thelon.  
 S'dish turku'luftonej  
 më, se i mëshonej

559) shije

560) e sheh

561) turke

562) u kushtuan

563) si i lehiç u pa

564) art, mjeshtëri

565) që e tundte

45. shpata më t'e mbanej  
pa anqill, i cënuer<sup>566</sup>.  
Këtu çë Arbreshët  
thërrisjen: «me nderë  
u qell shoku inë».
46. Ndër gjithë Qinigoi  
vetë s'e zilisnej;  
'tjeret shkati grisnej,
47. e thón; kem lipni  
të hapet pér né  
jushtra e mbë pjesë  
s'duem këmbinlé<sup>567</sup>,  
kuj forë jé' malli<sup>568</sup>  
o ndonjë shpirt djalli.
48. Ru'! si zoti math  
i merr me haré  
shpaten çë i prier,  
e t'veshurit i jé  
me k'ka t'kumandonjë,  
e si zot t'e shkonjë!
49. Si Urani prëçmoi  
se ca trima rrijen  
skutjendë, pér se shtiënë<sup>569</sup>,  
dón papá t'e shijen<sup>570</sup>  
me'bushtrit e tjerë,  
nderen e cënuer
50. ndë jushtret'shérojen;  
vate' ja rrëfiejti  
zotit Skanderbek.  
Ki, sa kët dijti,  
i tha: liq kanë  
se të bushter janë.
51. Po na, si këm' vemi,  
jushtren sund ngatmi  
nani, Mbrënda Krojë  
sa vlejen i matmi  
ndër jushtrat çë bëmi,  
gavnjine të nderomi.

566) pse al ishte i plagosur te krahu  
567) Nderushin këmbëlehtë  
568) i jep dashuria  
569) të mundur  
570) donin përsëri të mateshin.

566) doba 0800  
doba u 0800  
0800/01 1100  
0800/02 1100  
0800/03 1100  
0800/04 1100  
0800/05 1100

52. Thuej kështù, Kont Uran  
Tundu... Sund ngatmi...  
Bë't nxjeren thesaret,  
çë mbjothtim, t'i japmi  
pjesen çë i nget  
nganji<sup>571</sup>, çë e pret.
53. Nxirni qe e lopë,  
dhi, dhen, sënduje  
me trëmbet mëndasht<sup>572</sup>  
të gjelbra e të kuqe;  
mushka, kuël, turresë,  
gjindjen ndrishje besë,  
çë kemi të lidhur,  
nxirni... kuj ngasen  
t'i marren, t'i shesen  
o si t'i fjandasen  
t'i bëjen. Penguer  
i mbami këmbë e duer.
54. Më nxirni gjithësej  
e vëni veç e veç;  
nxirni se t'i ndami,  
dhe kufët me kuleçë;  
çëdo ë ndëni  
ndë mes t'atij lëmi.
55. U vinj<sup>573</sup> kur' spëndohen...  
Turkut ndragumän,  
çë nderë neve bëri,  
te me kët titän  
trimi, çë na kemi  
u tolq, e t'e vremi
56. shurra t'i pështonej,  
sa pa anqill u pá,  
e me ndakë ndë sisët;  
i thuej se i já  
libertatë të verë  
si burri me nderë
57. ka do. Sa gjegj Konti,  
me Nderushin bashkë,  
vate e nzuer ndë lëmët  
gjindë, petk e kavshë,  
pjesë paru të bëhshin,  
prana të spëndohshin.

571) cilidzo

572) me copat prej mëndafshi

573) unë do të vij

59. Bëna pjesët, erth zoti 58  
e bën e u spënduen  
kështu: . . . . .
- ..... Di pjesë  
pán<sup>574</sup> kush u cënuen,  
tri kush lanë gjëllen 58  
nënd té Dibres qìllen.
63. Një pjesë të salvuerit  
pat'in<sup>575</sup>, çë vlen  
prë një shpi e vreshtë  
e prë nj'rroqe dhen.  
Krerat prë di pjesë  
pán petk e turcesë<sup>576</sup>.
- ..... «Ju, shokë, bëtë ndéré<sup>577</sup>  
sa s'ë me rrëfjër<sup>578</sup>
66. sot gjirivet tanë,  
çë na u përenduen,  
si ilez té ratë  
ndë dhét ku u shkuën<sup>579</sup>.  
E na çë gustuemi  
sa vleni xumi.
67. Me një paru tru<sup>580</sup>  
juve judhikomi  
té bushter, e kini<sup>581</sup>,  
pér se meritoni  
më se gjithë, një pendë,  
çë qerre e parmandë
68. telqen e një mushkë.  
Si ka veç i vura<sup>582</sup>  
këlire té jipen  
i sillni' shpenguera...  
Mirë e me shëndetë  
prë një milë vjet,

574) patën

575) patën

576) patën dy pjesë nga plaçkat e nga té hollat

577) E merr fjalën Skënderbeu

578) rrëfyer, sa s'rrelehet

579) ku patën shkuar

580) me gjykim té paanshëm

581) e do té kini

582) prej vendit ku unë i vura veç

69. Shokë, i trashigoshi...  
Mirri, tajet janë<sup>583</sup>,  
prëharepsni shpitë  
e prind't, çë ju kanë.  
Me shokët ju kujtomi,  
té bushter ju këndomi.
70. Mbrënda Krojë dini,  
se jushtrat papà<sup>584</sup>  
pri'rë bëmi: gjithë,  
kuj më çëndë i ká  
ndër ju, té spërvohen  
mundjen té nderohen...»
71. Sa kështu i kutndoi,  
kreravet tha: «vëni<sup>585</sup>  
triesat rranga shokëvet,  
fuqitë té vapzonë,  
e pra té liremi
72. kët llakë e té vemi,  
te Hora na presen.  
Vratë viçra e desh?  
Triesen këndoni  
me zakón arbresh.  
Pak verë pini  
ka kuelt'mos'bini,
73. e mos gjë zgarrune  
pra udhes té bëni.  
Rueni gjithë té qelli  
si më té nderoni  
gjakun<sup>585</sup> e vetëhenë  
tëj, mos'na thenë
74. jo burra po kavshë.  
Gjegjtit?» Sa zoti  
gjithë kështu përsiti,  
ku spërvierin ngrëti<sup>586</sup>  
u mbjoth e mbitoi  
gjithë krerat, kuj shkoi  
mbë trisë mish e bukë,  
me veren nëndë vjeç.
75. Dhe krerat e vigjet  
ndré spërvjeret veg  
hajen e këndojen

583) janë tuajat

584) përsëri

585) té sillni si jo më mirë që té nderoni gjakun...

586) ku kishie ngritur tendën

- triesen<sup>587</sup> e prējen  
 76. gjellen. E Nderushi  
 te spērvieri tij  
 haj<sup>588</sup> me Xoraidhen,  
 çē turpē mē s'i kij<sup>589</sup>  
 mbanē, poka çē  
 Fani e dishē me tē.  
 77. Gjellen skutēndaqe  
 trimit, çē e pienej  
 me mallith tē butē,  
 ajo t'i rrēfienej  
 e thoj: U pa mēmē  
 u rrita, si me nēmē  
 78. e lerē, murga u<sup>590</sup>!  
 Tata im mē qe  
 njerk, sa kopile  
 u bēra, si mē she'<sup>591</sup>,  
 Gjithē trimat gadhjarē  
 me petk e me ar,  
 çē mē dojen nuse,  
 e mua pēlqejen,  
 prir' e s'do' t'i gjegnej<sup>592</sup>.  
 Ndér aq çē mē dejen<sup>593</sup>  
 ndonjē edhē vdiq,  
 pēr mallin çē e diq.  
 80. Losi Alladhin  
 malli çē e diq.  
 Aj trim! Sa i bukur  
 ish, e mē vdiq  
 pēr mallin! Aj mall!  
 ndē jetē jé djall,  
 81. çē gjithē dhistanon,  
 ture vjedhur paqen  
 'gelles, çē lulēzon  
 e ndēhet me faqen,  
 bukur tē dritēsuer!  
 Tue mē dhistanuer,

587) Edhe sot ka mbetur kēnga e tryezēs nē Frasniti: «Kush m'e jēndi tryezēn? buka e vera e bekuar».

588) hante.

589) s'i kishte

590) e mjerä unē!

591) si mē sheh

592) pēsēri nuk donte t'i dēgionte

593) qē mē donin

82. ti qeve çē mē solle  
 si ka u gramisa!...  
 Popo! taten tim  
 sē shō<sup>594</sup>, se si ka u nisa  
 s'prirem mē; aj!  
 Taten sē sho' maj!...  
 83. Sē sho' mē aq trima,  
 çē pas meje lanē  
 me tē ritē gjellen,  
 e prind't mē s'i kanē!  
 Sē sho' mē kushērin  
 Qerim e Alladhin<sup>595</sup>  
 84. e Aqiben e mjerē,  
 çē si mē kēndoi  
 bēri, oh harrijati!...  
 U stros se tē lēj  
 kētu tē ritē e tij!...  
 Trim sa i mirē ij<sup>596</sup>!...  
 85. Kētu çē Xoraidha,  
 si paadunartur<sup>597</sup>, zēj  
 papā tē qarit' parē,  
 Nderushi, çē e doj  
 si moter, s'e la  
 tē ngjalnej... i tha:  
 86. Moter, tē kujtoç  
 me kaq helm mua  
 hundimrat e tú,  
 çē gjithē ndonj' pērrua  
 tē karrumbullasi  
 vdekja, armike gasi,  
 87. duket tē m'thueç  
 se u mē se vēlla  
 s'tē dua, e mē se gjithē  
 ata, çē dhethi há.  
 Moter, u sē pres  
 'mos' mē keç besē  
 88. çē thom. Je me mua,  
 çē tē dua me mall,  
 si nderen time dua.  
 Tē nxier u mbē zall...

594) nuk shoh

595) Qerimin e Alladhinin

596) ishte

597) pa e vēnā re

- Gjithë-hëreshi 598 së kë 598  
çë qan, vashë me hjé.  
 89. Kimë besë e m'u gëzo...  
u mirë bë'te shkoç...  
Dua çë ni të taksenj  
nga ditë më kujtoç,  
mos maj të harronj,  
çë taksenj ni, të bënj 599.
94. Te këndon Nderushi  
kështuna me hjé,  
vasha, t'e skalljonej,  
pënroi ndë i jë 600  
zëmren, dha si thonej  
kur bukur e këndonej,  
95. i tha: ~Me vashë Arbreshë 601  
gjithë sonde, çë shkoi,  
ëndërtatë puthsha  
picikila, e thoj 602  
se për nde'ttij 602  
si motrez më kij.  
 96. Hjemadhe e e mirë  
ajò vashë më ish;  
të kuqe si gjërshti  
buzen t'ëmbel kish:  
e gjak e gjizë ceren 603,  
çë me gjithë nderën  
97. e mallit shkilqenej  
e dukej mall me hjé.  
Balla saj e sitë  
nënd' hjeshtimet këshë 604  
zbukuroni e fjisjen 605  
si malli, kuj gjisjen.  
 98. Te kjo më puthnej,  
si Parrajs më prënej  
me t'fojet e butë,  
çë zënë më gjëzonej... 606

598) kurdoherë

599) dua të ma kujtosh qdo ditë atë që po të premtoj tan

600) mendol në se duhet t'ja jipë

601) arbëreshë

602) për nderin tënd

603) ose: e kuqe e e bardhë

604) gërshta

605) e zbukuronin dhe fllsnin

- U fare bën e renja  
se kriatez m'i enja 606.  
 99. Kësaj ka të gjasë  
vasha, çë ti do,  
e më taksen shoqe.  
 100. Trim ti m'e këndë,  
se t'i meriton  
vjershi çë nederon.  
 101. Këtuna Nderushi,  
çë me meravilë 607  
ëndërtën e vashës  
gjegj, me suvillë  
u çel e së ligoi 608  
çë vasha doj thoj  
102. me kët' rrëmë rrësiemi:  
po mbjatu guallarti  
ndrishe qitarelen  
ëmbel si mialti,  
vashen të këndoi,  
çë prit mbrënda Krojë.  
 103. Ai fare s'u dhë  
se vasha, çë s'i njij 609  
zëmren, me rrësiemën  
e ëndrrerres doj t'dij  
nd'atë ashtu doj,  
si bukur i këndoi:  
 1. Po mbjatu dreq-dreq,  
si malli të ja sill  
zjarrin e nderuer 610,  
sa gjegj zënë sill  
vashen c'ai doj,  
zu kështu e këndoi:  
 2. ~Trima e vasha ndër qìell vënë:  
